

ALEKSANDËR XHUVANI

## PARAFJALËT

## I. KUPTIMI I PARË I PARAFJALËS DHE PËRKUFIZIMI I SAJ

Pikë së pari në kohët e lashta të gjuhës greke parafjala ka qenë kuptuar si një term që **vihet përpara**, kuptim që del nga vetë koncepti i fjalës greqishte **Πρόθεσις** (= e venë përpara), e përdorur së pari prej gramatikanit grek Dionis Trakasit (170-90 para epokës së re). Pas këtij përkufizimi të parë konceptual, që mbajti për një kohë të gjatë, në kohë të Helenistikës e paskëtaj, u-bënë orvatje më vonë prej dijetarësh, për të përkufizuar konceptin e parafjalës nëpër raporte të ndryshme logjike. Kësò-dore pas disa karakteristikave që i u-dhanë parafjalës në kohë të Skolastikës (**causarum modi, de modis significandi**, etj.) gramatika e Porte-Royal-it i dha parafjalës, për të parën herë, kuptimin e përgjithshëm të **marrëdhënievet a të lidhjevet** (të raportevet a të relacionevevet) të ndryshme, që tregon kjo ndër gjymtyrët e një fjalie. Këtij përkufizimi të ri **sintaktik** i u-shtua mbasandaj përkufizimi **morfologjik**, i të **pa-ndërrueshmit** a i të **palakueshmit**. E kështu, **parafjalë** quhet sot ajo pjesë e palakueshme e ligjëratës, që tregon marrëdhënie të ndryshme në mes dy gjymtyrëve të fjalisë.

Termi greqisht **Προθεσις** i parafjalës u-përkthye ad litteram latinisht me fjalën **praepositio**, term që u-ruajt me ndryshimet e tij fonetike në gjithë gjuhët romane, si edhe në gjuhët e tjera evropiane, përveç disave, si në disa gjuhë sllave, ku përdoret termi **predlog**, e në gjermanishtet, që përdor termin **Verhältniswort**; por edhe në këto gjuhë përdoret herë-herë termi latin **praepositio**. Në gjuhë shqipe ky term u-përkthye së pari prej Sami Frashërit në gramatikë të tij me fjalën **parje**. Gramatika a **Folmarmja** e Shkodrës ka përdorur termin **parapris-a**. Gramatika e Xanonit e quajti **paraprisë-a**. Termi i sotëm **parafjalë** u-caktua më 1920 në një mbledhje arsimtarësh, që u-bë në Lushnjë e ku kam qenë edhe unë, pas Kongresit së ditur n'atë qytet.

## II. ORIGJINA E PARAFJALËS DHE ZHVILLIMI HISTORIK I SAJ

Sa për origjinën e parafjalëvevet, sikundër i gjejmë në tekstet e vjetra të gjuhëvevet indoeuropiane, këto do të kenë dalë, më të shumën, prej fjalësh me kuptim ndajfoljor; kështu parafjalët greke **έν, ἀμφι, επί, μετά, παρά** etj. i gjejmë tek Homeri të përdorura edhe si ndajfolje, e duket se ky ka qenë kuptimi i tyre i pari. Gjithashtu edhe parafjalët latine **contra, foras, secus**, etj. kanë qenë përdorur më parë si ndajfolje. Po kështu edhe në shqipet tonë parafjalët **afër, lark, pranë, sipër** etj. janë zhvilluar si të tilla prej një përdorimi të parë ndajfoljor. Edhe ndajfolja

**krahas** në gjuhë të sotme të shkrimit po përdoret si parafjalë e ndër-tuar me dhanore ose si lokucion ndajfoljor me formën **krahas me**.

Përveç ndajfoljevet disa parafjalë të gjuhëve të vjetra indoeuro-piane, si të hindishtes së vjetër, kanë dalë prej rrënjësh së përemrave a të foljeve (H. Grassman, Ursprung der Präpositionen im Indogermanischen, KZ XXVIII. 506; Witney-Hatzidakis. Mbi parimet e përgji-thëshme të linguistikës krahasimtare. 420).

Në kohët e lashta të gjuhëve indoeuropiane parafjala ka qenë përdorur për të përcaktuar drejtimin e një veprimi të foljes dhe mund të vihej përpara ose prapa kësaj. Një të tillë përdorim të parafjalës e gjejmë ndër tekste të hindishtes së vjetër, të greqishtes së Homerit dhe të poetëve të vjetër pas këtij (B. Delbrück, Vergleichende Syntax, II. 647).

Në kohët e pastajme të këtyre gjuhëve, sidomos në prozë, parafjala i u-ngjit krejt foljes, u bashkua me te duke formuar një njësi kupti-more, elementi i parë i së cilës ishte parafjala, e quajtur pastaj **preverb**. Të tilla folje të përngjitura gjejmë- plot në gjuhën greke, si **ἐπιπτόω, εμβαλλω**, në gjuhë latine, si **convenire, amittere** etj. Shembëlla tipike te këtij përdorimi të parafjalëve gjejmë në shqipet në disa folje të vjetra popullore, si **mbledh** (\*mbë+lieth, krhs. greq. **λέγω, συλλέγω**), **prek** (\*per-eh, krhs. **ehënj, ehur**), **prënj** (\*për-ënj, krhs. **âj, âjur**, nga \***an-io**, greq. **ἀνεμ-οσ**). (K. Brugmann, Grundriss I<sup>a</sup> 157,172).

Pas funksionit adverbial të parafjalës doli funksioni i saj adnomi-nal, që i përket një periode të vonë të gjuhës e që ka dalë nga një e çvendosur e gjymtyrës sintaktike (H. Grassman, ibid. 560). Si shembëllë tipike për fthillëzimin e këtij fenomeni sjellin frazën homerike **ἀπό νηώς βαίνει** (= zbret prej anijes), ku gjindorja-dhanorja **νηώς** lidhej që në krye të herës me foljen **βαίνει** dhe tregonte pikënisjen e të zbri-turit. Po, me qenë se ndajfolja ose parafjala **ἀπό** kishte po ate dome-thënie lokale të gjindores-dhanores **νηώς**, kjo mund të formonte me emrin **νηώς** një njësi sintaktike, e kështu duke u larguar nga folja u-lidh me emrin **νηώς**. Prapó, parafjalët prej funksionit adverbial në poezi së pari hynë pastaj, me kohë, edhe në një funksion adnominal në poezi e në prozë të gjuhëve të vjetra. Por ky farë funksioni i para-fjalëve muar një të hapur të gjërë më vonë, në zhvillim e sipër të gju-hëve, kur me ato mbaresat e emrave (p.sh. greq. **λόγ-ου, λόγ-ω, λόγ-ον, λόγ-ους, λόγ-οις**, lat. **domin-i, domin-o, domin-is**, ros-ae, ros-am, ros-a; arbor-is, arbor-em, arbor-ibus, etj.; shqip **lis-i, lis-a-ve, lis-a-sh** etj.), nuk ishte e mundur që të tregoheshin marrëdhëniet e rap-ortet e ndryshme logjike, që çfaqeshin me anë të të folurit; do me thë-në: rasët e emrave ose më mirë mbaresat e tyre kallëzonin p.sh. në gre-qishtet të vjetër e në latinishtet vendin ku gjindet kush, vendin prej ku miret a prej nga vjen dikush, kohën kur ndodhet gjékafshë a ndonjë tjetër marrëdhënie a relacion, por nuk kishte mbaresa që të tregonin relacione të tjera logjike, p.sh. «me» (të bashkuar), «ndaj» (afër a pranë), «ndër» a «nëpër» (në mes a përmes), etj. Këto raporte të ndryshme zuri t'i çfaqë gjuha, në zhvillim e sipër të saj, duke krijuar pak nga pak e kohë pas kohe, prej ndajfoljesh e prej rrënjësh së përemrave e të foljevet një numër pak a shumë të gjerë parafjalësh. Kështu në greqish-tet u-krijuan 18 e në latinishtet 24 parafjalë. Në gjuhët e tjera, në ru-sishtet qenëkan krijuar 19, në gjermanishtet 14, në frëngjishtet 18, n'ita-liishtet 11, në rumanishtet 16 parafjalë etj. Shqipja ka 18 parafjalë.

Përveç kësaj, kjo nevojë për të çfaqur marrëdhënie të ndryshme scilli edhe krijimin e parafjalëve të reja prej klasësh tjera, si prej emrash, mbiemrash, pjesorësh, ndajfoljesh etj.; p.sh. gjerm. *betreffend*, *abgerechnet*, *mangels*, etj.; fr. *cepedant*, *durant*, *excepté*, etj.; ital. *durante*, *lungo*, *eccetto*, etj.; shqip **buzë** (liqenit), **rrotull** (pazarit), **gjatë** (dimrit), etj. Gjithashtu u krijuan edhe **lokucione prepozicionale** ose **shprehje parafjalore**, psh. fr. *à l'aide de*, *au milieu de*, etj.; it. *a cagione di*, *per mezzo di*, etj.; shqip **me anë të**, **në vend të**, etj.

Këndej rrodhi edhe klasifikimi trifish i parafjalëve: 1. në parafjalë të mirëfillta a të thjeshta si **në**, **mbi**, **për**, etj.; 2. në parafjalë të dala prej ndonjë klase të fjalëve (prej ndajfoljesh, emrash, etj.), si **afër**, **pranë**, **buzë**, **rreth** etj.; 3. në shprehje parafjalore, si **në mes të**, **me ndihmën e**, **në pajtim me**, etj.

### III. KUPTIMI LEKSIKOR I PARAFJALËS

Sipas përkufizimit të sipërm, që parafjala tregon lidhjet sintaktike në mes dy gjymtyrëve të fjalisë, del se parafjala nuk është një pjesë e mirëfilltë e të folurit, që qëndron e pavarur dhe më vehte, sikundër është p.sh. emri, mbiemri, ndajfolja, etj., por është një element i përdorur për të treguar marrëdhënie e për të lidhur dy terma të një fjalie. Prandaj parafjalët i kanë quajtur edhe fjalë ndihmëse, a mjete a përdorse gramatikore ose fjalë të mbrazëta (J. Vendryes, *Le langage* 195, 196; I. Iordan, *Limba romina contemporana* 490, 491), që i shtiem në punë për të treguar raporte sintaktike në mes dy elementeve të fjalisë. Mund të thuhet, sipas këtyre, se parafjalët nuk kanë kuptim leksikor më vehte, sikurse pjesët e tjera të të folurit. Me gjith'ate jo të gjitha parafjalëve u mungon vlera leksikore; në qoftë se parafjalët e mirëfillta, si **në**, **mbi**, **për** etj. nuk e kanë këtë kuptim leksikor por disa syresh (që më parë janë ndajfolje, ose të formuara prej tjetër klase), si **pranë**, **afër**, etj. e kanë kuptimin e tyre leksikor. Porse, përgjithësisht, vlera e parafjalëve caktohet nga mbrendia kuptimore e fjalëve të një konteksti të dhënë, ku gjenden këto; kështu te shëmbëllat **kishte rënë në pus**, **po vuan në pleqëri** vlera vendore e kohore e parafjalës në varet nga kuptimi i fjalëve të këtyre fjalive. Këte vlerë të parafjalëve do ta shohim çkoqur më poshtë, gjatë funksionit të çdo parafjale. Gjithashtu gjatë këtij funksioni do të shtihet se çdo parafjalë kallëzon marrëdhënie a relacion në mes dy termave të fjalisë, nga të cilët i dyti është një caktonjës i të parit. Termin e dytë e kanë quajtur **përcaktonjës** dhe të parin të **përcaktuar**.

### IV. PARAFJALËT E PARASHTESAT

Parafjalët e parme mund të paraqiten shumë herë si parashtesa, ose më mirë si preverbe, d.m.th. si terma të parë kompozitash, termi i dytë i të cilavet është folja, si ato që pamë më lart: greq. **ἐπιστώ**, lat. **emittere**, shqip **mbleth**, etj. Nga këto duket se parafjalët dhe parashtesat kanë po ate origjinë: po ai term është përdorur herë si parashtesë herë si parafjalë; veçse roli i parafjalës është më i parë se i parashtesës, d.m.th. vlerës së parafjalës i është shtuar pastaj vlera e parashtesës (W. Brondal, *Théorie des prépositions*, 12; I. Iordan *ibid.* 491).

## V. NDARJA DHE FUNKCIONI I PARAFJALËVET

Lidhur me sa u tha më sipër parafjalët e shqipes po i ndaimë në këto tri kategori: A) **Parafjalë të mirëfillta a të parme**, të thjeshta ose të përngjitura; B) **Parafjalë të prejardhura**: prej ndajfoljesh a prej ndonjë tjetër klase të fjalëve; C) **Lokucione a shprehje parafjalore**. Pas kësaj të ndari shqipja ka 18 parafjalë të parme, disa parafjalë të prejardhura dhe disa shprehje parafjalore.

Për renditjen e parafjalëve gjatë funksionit të tyre është marrë parasysh afëria semantike dhe vlera e tyre e ndryshme p.sh. parafjalët homosemantike në a ndë dhe më a mbë, nga dhe prej janë vënë radhazi njëra pas tjetrës; parafjalët me vlerë vendore të theksuar, si në a ndë, më mbë, te tek, mbi, ndën, etj. janë renditur më parë se të tjerat, si për, deri a gjer, pas etj. që nuk çquhen për një vlerë të theksuar vendi.

## A. Parafjalë të parme, të thjeshta a të përngjitura.

## 1. ën

Një nga karakteristikat e gjuhës së Buzukut është edhe fjalëza **ën**, që ai e përdor nëpër konstrukte të ndryshme në vend të parafjalëve të tjera të gjuhës së sotme: 1) në vend të parafjalës **prej a nga** p.sh. e ju ata t'i njihni **ën punësh** së tyne (Mate VII. 20) = **nga punët** e ture (Argjir. ibid.), **prej punësh** atyne (Kristof. ibid.); një re ëngriti **ën syshit** së tynesh (Punët I. 9-10) = një mjergullë e mori **nga sit'** e ture (Argjir. ibid.), një re e muer **prej sysh** atyneve (Kristof. ibid.); dan dritënë **ën s'errëtit** (Gjeneza I. 4) = dan dritënë **prej errësinësë** (Kristof. ibid.); me u larguom disa **ën dheut** (Luka V. 3) = të largonej pakëzë **nga dheu**. (Argjir. ibid.), me u larguem pak **prej toket** (Kristof. ibid.); etj.; 2) në vend të parafjalës **në, me, për** a të ndonjë tjetre ose të ndonjë shprehje parafjalore, p.sh. flasënë **en gjuhësish** sonësh (Punët II. 11) = kuvëndojnë **ndë gjuhëra** tona (Argjir. ibid.), flasinë **ndë gjuhëra** tona (Kristof. ibid.); të jetë pjekunë **ën zjarmit** (Exodi XII, 8) = të jetë pjekunë **në zjarr**; ishnjim ginë **ën buke** e **ën mishi** (fol. 63/16) = ishin ngirë **me bukë** e **me mish**; vepëratë dëshmonjënë **ën meje** (Gjoni X 25) = punëtë flasënë **për mua** (Argjir. ibid.), punëtë dëshmojnë **për mue** (Kristof. ibid.); jo bam **ën dore**, as **ën gjakut** së sjepet, por **ën gjakut** së ti (Ebrejvet IX, 12) = jo bërë **me duar**, as **me anë të gjakut** cjepet, po **me anë të gjakut** së tij (Argjir. ibid.), jo bamë **me dorë**, as **me anë gjaku** sqepësh, po **me anë të gjakut** vet (Kristof. ibid.).

Përveç këtij konstrukti, Buzuku përdor edhe një tjetër konstrukt, ku parafjalën **ën** e shoqëron me gjindoren a rrjedhoren e një emri, që përcakton një emër të paçquar. Ky konstrukt sot formohet me një gjindore a rrjedhore të emrit përcaktonjës, kur emri i përcaktuar është i paçquar, p.sh. erdh (pëllumb) me një **glenb ën ullini** (Gjen. VIII. 10) = kthei (pëllumi) me një grim **filiz ullinit** (Babi 17); kthei (pëllumi) tuj i prum një **gem ullinit** (T'Nnollunat 6); kishte (pëllumbi) një **gjethe ullini** (Kristof. ibid.); i banë kunorë **ën drizash** (Mate XXVII 29) = gërshetuenë **kunorë gjembash** (Kristof. ibid.); muorë **glenba ën ullinjsh** (Gjoni XII, 13) = muarnë **dega hurmash** (Kristof. ibid.).

Po këtë konstrukt përdor Buzuku edhe atje ku në gjuhë të sotme e kemi në rasë gjindore emrin përcaktonjës dhe në trajtë të çuar emrin e përcaktuar, p.sh. ka me klenë sokollimë **ën dhambësh** (Mate VIII 13) = atje është të dredhurit e dhëmbëvet (Argjir. ibid.), do të jetë të kërcëlliturit e dhëmbëvet, ose ka me qenë të dridhunit e dhambëvet (Kristof. ibid.).

Po të krahasojmë, te shembëllat e sipërme, konstruktin e tekstevet të Buzukut me parafjalën **ën** me konstruktin e teksteve përgjegjëse në gjuhë latine e italiane, do të shohim se kjo parafjalë **ën**, nga funksioni e kuptimi, u përgjigjet parafjalëvet latine **ab**, **de**, **ex** ose parafjalëvet italiane **in**, **di**.

**Ën** Buzuku e përdor edhe ngjitur me disa folje, si protezë pa funksion kuptimor, p.sh. me u **ënveshunë** e i **ëngjeroi**, e **ëntherni**, e u **ëngjall**, t'u **ënfalshi** = (Gjoni XXVII 43, 46, 55, 60 98); janë klenë **ënvratë** (Korint. B. XI. 25); të jetë **ënderunë** (Mate VI. 2); etj. Këso foljesh me një **n** protetike të aglutinuar, veç te shkrimtarët e mëvonshëm, si te Budi e te Bogdani, kemi edhe në gjuhë të sotme popullore, si **ndryj**, **ngërdheshem**, **nguqem**, **ngjeronem**, etj.

Sa për grafjin' e kësaj parafjale të Buzukut, kjo do paraqitur si një rrokje e plotë: **ën**. Dua të them, se kjo nuk do marrë, sikundër që mendon N. Jokli («Hylli i Dritës» viti IV (1930), f. 150), si një **n** sillabike, por si një partiklë me vlerë fonetike, sepse ndryshe, po të mos kishte një këso vlere, nuk do që shkruar me atë trajtë. Ka pra një farë tingulli, dhe zanorja do të ketë pasur shqiptimin e një **e**-je të pazëshme, shqiptim që i ngjan atij të partiklës romune **in** = (ën).

Te Budi parafjala **ën** nuk është e plotë, si te Buzuku, por e cun-guar, se nga dobës'mi i tonit, a nga patonësia, erdhi duke iu-zhdukur zëthi i **ë**-s, e prandaj e gjejmë, më të shumën të ngiitur a të aglutinuar, pa **ë**-n nisore, p.sh. Buzuku: u dorgj **ën qiellshit** (Gjoni XI, 59), Budi: kaa sdripunë **nqiellshit** (Pasq. 124); Buzuku: e ata qish **ën teje** ka me u lem (ad completorium, b). Budi: e me u larguom **nteeje** me të madh dhunë (Pasq. 164). Por edhe **ë**-n nisore të Buzukut përdor Budi: tue trajtuom e tue parëquom **ëngjithë** duorshi cë gjellëvet (Pasq. 78); krhs. Buzukun: e Zotynë juve ënbushtë **ën gjithë** gazimendi (Dominica III. Maduenti 38).

Gjithë ky fenomen fonetik duket edhe te Bogdani, se nuk e gjejmë të plotë **ën-in**, por të aglutinuar, p.sh. muer **ngurësh** që ishinë mb'dhe (shk. I. Ligj. III, 12); qish ashtë zanë **nteje** (Shk. I. Ligj. III, 18); ose, në kundërshtim me trajtën e plotë të Buzukut, e gjejmë të apostrofuar p.sh. dan dritënë **n'territ** (shk. I, Ligj. VII, 5), kurse Buzuku: dan dritënë **ën s'errëtit** (Gjen. I, 4); ai kishte për t'u nxjerrë vena **n'rrushit** (shk. I, Ligj. III, 12); u zu luleja **n'ferrash** e pa ferrë (Pj. II, Shk. I, Ligj. I, 10). Elementi **n'** këtu është ajo **ën** e Buzukut, por apostrofi duket se është një shenjë grafike, pa kuptim të caktuar, e vetëm për të treguar ndarjen e fjalëvet.

Për t'u vërejtur është se po ky fenomen fonetik i **ën-it** ka ndodhur edhe me parafjalën romune **in**; edhe këtu nga patonësia u dobësua a u zhduk i-ja nisore, e kështu e gjejmë në disa vise me trajtë të apostrofuar **'n poale** (=në prehër), pina **'n virful** unui munte (=gjer në majë të një mali; Tiktin, Rumän — Deutsch. Wörterb. 772, 1711); ose e gjejmë të aglutinuar, si në aromanishten: nvitat (=invatat = i mësuar, i diçëm; Jahresb. des Instit. für rumän. Spr. X. 430).

Kjo parafjalë e jona **ën**, e plotë te Buzuku dhe e shndërruar a e shtonësuar te Budi e te Bogdani, është e vjetër në shqipet dhe lidhet etimologjikisht me parafjalët: **év**, **iv** të greqishtes, **en** të ombrishtes, të latinishtes e të prusishtes së vjetër dhe **in** të latinishtes të pastajme (Brugmann, Gr. I, 366; Boisacq, 249).

## 2. ëndë, ndë, në

A. **Përdorimi.** Nga këto trajta, të parën e përdor Buzuku, kurse të dytën e përdorin shkrimtarët e tjerë të lashtë, si Matranga, Budi, Bardhi, Bogdani, De Rada dhe Argjirokastriti. Nga shkrimtarët e Rilindjes, Kristoforidhi e përdor **ndë-n** në gjithë veprat e tij; gjithashtu e përdor Mitkua e Vretua. Naimi përdor herë **ndë-n** e herë **në-n**, kurse Samiu thua se gjithmonë **në-n**. Në përrallat e Dozonit dhe të Pedersenit përdoret më tepër **në-ja**. Që nga mbarimi i shekullit 19 zotëron përdorimi i parafjalës **në**, dhe në ditët tona përdorimi i saj është përgjithësuar në gjuhë të të shkruarit.

B. **Funksioni e ndërtimi.** Kjo parafjalë tregon:

I. Vendin ku qëndron a ndodhet një njeri a një send, lidhur me folje që kallëzojnë të qenë, të qëndruar a të ndodhur. Atëhere ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar: a) emrash të përgjithshëm, p.sh. shërbëtori em dergjetë **ndë shtëpi teme** (Buz. Mate VIII, 7); e mba **ndë shtëpi** (Budi, Pasq. 2); këjo grue e unë gjëllinjëmë **ndë një shtëpi** (Bogd. Shk. III, Ligj. IV, 3); dergjetë **ndë shtëpi** (Argjir. Mate VIII, 6); nënk ishin **ndë katunt** (De Rada, Milosao II, 5); ish **ndë bark** të peshkut me yll **ndë ballë** (M. M. 270); pa nxjerrë gurin që ka **në bark**; nuk ish **në shtëpi** (Ped. 29, 30); brënda **në pus** ish një kuçedërë (Doz. 33); të vihetë **ndë burk** (Kristof. Hist. 32); ca rrojnë **nd'ujë**, ca **nd'erë** (Naimi, K. I. 29); **në shtëpi** të mësuesit (Shuteriqi, Çlir. I. 12) — b) mbiemrash asnjanes të substantivuar ose pjesorësh të substantivuar, p.sh. mbetetë **në t'errëtë** (N. Mës. 4); kishin vënë roje **në të ngushtat** e malevet; **në të hyrë** të lokalitetit kishin vënë një tabellë të madhe (Sako, Bereq. 13); **në të dalë** të qytetit ishin radhitur me mijëra punonjës, për ta përcjellur.

2. Me tëjore parafjalore<sup>1)</sup> p.sh. ishte **ndë bukët**, **ndë verët** (Mate. Kat. 45); **ndë shpiit** tëën (De Rada, Antol. 48); tri kafshë janë **ndë diellit** (Bogd. Shk. I. Ligj. II, 12) **ndë ajrit** (Bogd. Shk. I. Ligj. V. 13); ishinë **ndë fushët**; **ndë hardhit** ishinë tri dega (Kristof. Hist. 26, 28); e mbante fshehurë **ndë gjit** (M. M. 58); ca kafshë rrojnë **në dhet**, ca brënda **nd'ujët** (Na. Mës. 4); edhe në atë **Evropët** të ndrituarë ngajjnë grinda; Italia ka treqind mijë shqipëtarë **në vëndit** të saj (Sam. Shqipëria, 34, 43); gjaku i hipi **në kokët** (Atan. 38).

II. **Vendin, ku ndodh një të lëvizur** a të vepruar, ose një të drejtuar për një vend a për një gjësend, lidhur me folje, që tregojnë një lëvizje a një drejtim. Atëhere ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar: a) emrash të përgjithshëm, p.sh. tue him Jezu **ëndë një barkë** (Buz. Luka, C. 3); me hijm kund **ndë një munështijr**

(1) Në vend të termit rasë **vendore**, që nuk shkon aspak me sintagma që nuk tregojnë vend, por miet a rrethanë (si, i ra **me shkopt**, **për shpëtimt** të atdheut, etj.), po përdor këtë term këtej e tutje që më duket më i përshtatshëm për të shprehur edhe relacione të tjera veç të vëndit.

(Budi, Pasq. 29); si erdhi ai **ndë shtëpi** të Petrosë; e kur hiri ai **ndë barkë** (Argjir. Mate 14, 30); unis të kthehet **ndë shtëpi** të tyre (M. M. 57); e kish hedhur **në pus** (Ped. 34); trokëlliti **në derë** (N. K. II. 30); sot po hyjmë **në shtëpi** tënde (Kas. 107); trokëllon **në derë** (Kurti I. 36) — b) mbiemrash asnjans të substantivuar ose pjesorësh së substantivuar, p.sh. kur i kthen dheu faqenë tjetërë diellit, na jesëmë **në t'errëtë** (N. K. II, 37); shkeli **në të butë**; hyri **në të fellë**; vete **në të pamë** (edhe: vete **në pasi**).

2. Me tëjore parafjalore, p.sh. kujtuomë se ajo duoj me votë **ëndë vorrt** (Buz. Gjoni XI 32); tue ecunë **ndë shekullit** (Budi, Pasq. 147); usdorq **ndë pisët** (Matr. Kat. 22); e shpunë **ndë Jerusalem**; kanë me ja shpum **ndë kishët** (Bogd. Pj. II, Ligj. I Shk. II, 4, 5); pastaj vajti prapë **ndë vendit** dhe fjetei (M. M. 61, 65); të trokëllijmë **ndë derët** (Nr. 143); e hodhnë **ndë gropët** (Kristof. Hist. 27), yjtë vinë rreth në **hapësirët**; s'ecën **nd'udhët** të ligësisë (N. Mës. 3, 4).

III. **Vend në kuptim metaforik.** Si u pa te shembëllat e sipërme, me parafjalën **në a ndë** tregohet një kuptim **hapësinor** (spacial) dmth. një kuptim vendi konkret, teku gjindet a drejtohet një njeri a një gjë send. Por shumë herë me parafjalën **në a ndë** në vend të një vendi a caku konkret tregohet një vend i marrë me mend, një vend abstrakt ideal. Kemi pra një kuptim **hapësinor metaforik** ose një **kuptim të figurtë vendi**. Edhe në këtë rasë kjo ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. me i forcuem **ndë besë** (Kristof. Hist. 26); u nisën **në punë të tyre** (Doz. 79); kur e sheh ajo mbyturë **në flori** (Ped. 84); mos i lini të sëmurëtë **ndë nevojë** (N. Mës. 22); njeriu ka zbuturë kafshëtë e i ka vënë **në punë** (N. K. II. 24); ata mbajtën **ndë dre** edhe Romanët (Kënk. e spr. 52); ecëni **ndë punë** tuaj tashti (M. M. 66); kanuni të çon **në he** (Kan. 52); tani jeni **në zjarr** të punës (Bereq. 15); kish rënë **në gjumë** të thellë (Stuhi 32); ishte zhytur në mejtime të thella; tashti bujku është **në valë** të punëvet të tij; i rri **në krye a në kokë** punës.

Verejtje. 1. Një kuptim hapësinor metaforik kemi me parafjalën **në a ndë**, kur bashkohet kjo me një përemër a me një emër personi, që vihet në kallëzore të çquar a të paçquar; p.sh. ai që qëndron **ëndë muo** e ju jes **ëndë te** (Buz. Gjoni XV 5); **në ju** ma kroje mos banojshin, zogjt e malit **në ju** mos këndojshin (Vis. e Kombit); u knaqte i ati tuj pa gjithë këtë zemër **në djal** të vet (Mjed. III, 174); me që janë të lodhur dhe **në ta** zotëron ana shtazore (Doni i qetë I 13); jam idhnue **në ty**; a nuk ke **besim në mua**; pështetu **në mue**; kanë besim se **në popullin** shqiptar do të gjejnë përkrahje të madhe. Do shtuar këtu se përdorimi i **në-s** me këtë funksion metaforik personi nuk është i përgjithshëm, se haset vetëm në disa vise të Shqipërisë veriore e jugore, po ka zënë të hyjë edhe në gjuhë të sotme të shkrimit. Më dendur ky funksion çfaqet me parafjalët **më e te**, si do të shohim më tutje.

2. Një kuptim të figurtë vendi kemi me parafjalën **në** edhe në shumë rasa të gjuhës popullore, kur formohen me të grupe fjalësh, që mund t'i quajmë **shprehje foljore** a lokucione verbale. Këto grupe të fjalëvevet, me gjithë se elementet e tyre përbërëse e ruajnë vlerën e tyre leksikore, por të bashkuar me një frazeologji formojnë idiotizme në shqipet, që herë-herë i përgjigjen një foljeje më vehte, dhe në një gjuhë të huaj një shprehjeje tjetër foljore, ose një foljeje më vehte. Të tilla shprehje foljore janë: **bie në gjak** = shkakëtoj armiqësi për një vrasje të bërë; **asht në gjak** me akëcilin = ka vrrarë dikë nga familje e tij; **bie në ga-**

**bim** = bëj gabim, gabo; **bie në lëngim** = lëngo, sëmurem: m'at ças **ra në lëngim** (M. M. 278); **bie në zi a shtihem në zi** = mba zi, ose vesh shenjat e zisë për ndonjë vdekje; **bie në bisedë** me ndokend = bisedoj me të; **bie në faj, ose jes në faj** = bëj faj, dal fajtor; **bie në godi** me ndonjë = ndreqem, mirrem vesh me të; **më bie në sy një gjë a një ngjarje** = më cudit a më bën përshtypje; **më hyn në sy një gjë** = më pëlqen, pasi e vërej mirë; **më hyn në zemër dikush** = më bën që ta dua; **më leu në zemër** (që t'i bëj ndonjërit një të mirë a një dhuratë) = m'erdhi dëshirë, më dëshëroi zemra; **bie në fije** = e ndiej, e kuptoj: këto e shtynë me **ra disi në fije** (Kurti, I. 21); e **ve në fije**, ose e **ve në vijë një punë** = e ndreq, e rregulloj; e **ve në be** = e bëj që të betohet; e **ve në gjumë** = e bëj që të flerë; e **ve në sisë** = i jap gji; e **ve në lojë a në shoshë** = tallem me ndonjë, e qesendis; nuk e ve a **nuk e shtie në numur** = nuk e za për gja, nuk e kam fare para sysh, nuk e përfill; e **mba në frë ndokend** = e ruaj, e shtrëngo, që të mos bëjë ndonjë dëm a të keq; e **ka në thuet** (një gjë a një punë) = e ka në natyrë të vet, i është bërë zakon, është mësuar me të; e **la në baltët** = nuk i ndihmoj, nuk kujdesem fare për të; e **shtie në harresë** = e harroj një gjë me qëllim ose pa të; e **shtie në punë a e qes në punë** = e përdor: drunin e lisit e **qesin në punë** me goditë barka (Mjed. III 124); e **shtie në punë një njeri** = e bëj, e ve që të punojë; **më hyn në punë një gjë** = më duhet që ta përdor; **hyj në gojë** të akecilit a në **mallëkim** të ndonjërit = e heq (në gojë), e ngarkoj (me faj), e mallëkoj; **i ka ra në vesh** (ajo gja e ajo fjalë) = u lajmue për të, ja thanë; **tashti i ra në brijë** (ajo punë e ajo gjë) = tashti e kuptoi, e ndjeu; **i dal në krye** (një punë) = e kryej, e mbaroj; **dal në fytyrë** = fotografohem; **me dalë në faqe një punë** = me dalë e mbarë, e mirë; **me e shqepë në dru** = me e rrahë mir' e mirë; **bërtas në kupë të qiellës** = bërtas fort; **rri në frikë** të ndokujt = i ruhëm atij, që të mos më flasë a të mos më qërtojë. Kemi tri këso shprehjesh: e **zë në gojë**, e **zë ngoje**, e **za me gojë**.

Me foljen **ve** gjuha e shkrimit ka krijuar të tjera këso shprehjesh me kuptim hapësinor metaforik, p.sh. e **ve në dukje**, e **ve në dyshim**, në **lëvizje**, në **përdorim**, në **jetë**, në **praktikë**, në **rregullë**, në **shitje**, në **shërbim**, në **zbatim**, në **veprim**.

Përveç këtyre, në gjuhë të të shkruarit janë formuar një varg shprehjesh me kuptim të figurtë vendi, të ndërtuara sipas gjuhëvet të huaja me kallëzore të çquar, p.sh. Shqipëria është sot në **lulëzim** e forcavat **të reja**; kjo e metë e ka burimin në **pakujdesinë** e punonjësvet; kjo vepër ka rëndësi të madhe në **lëmin** e studimevet gjuhësore; disa kooperativa janë në **përqindjen** e fundit të realizimit të planit. Këtu hyjnë edhe disa shprehje të gjuhës së shkruar të ndërtuara me foljen **jam** e me një emër derivat foljor, pas konstruktit të gjuhëvet të huaja, p.sh. tani **jemi në përfundim** të mbjelljevet të prandverës; vjelja e duhanit **është në përfundim**; **jemi në ndjekje** të këtij problemi; forcat e punës **janë në rritje**; ai **rrinte gati në pritje** të gjahut, etj. Këto shprehje janë farkuar, si thamë, pas një gjedhje të huaj, e prandaj në shqipet duhet të thuhën me një folje të plotë: tani **po përfundojmë** a **po mbarojmë** mbjelljet e prandverës; vjelja e duhanit **po përfundon** apo **mbaron**; **jemi duke e ndjekur**, ose **po e ndjekim** këtë problem; forcat e punës **po rriten** ose janë **duke u rritur**; ai **rrinte gati e po priste gjahun**, ose ai **rrinte gati duke pritur gjahun**.

IV. Mënyrën me të cilën çfaqet një veprim konkret a një gjendje e



2. Me tëjore parafjalore; p.sh. ëngjënoj dy herë **ëndë javët** (Buz. Luka XXVIII, 12); a mos kishnje bleem gjaanë e gjallë **ndë vjeshtët; ndjerë ndë prendverët** (Budi, Pasq. 64.); një herë ndë javët (Nr. 136); **në vogëlit** mësohet njeriu me të rremet (N. Mës. 18); po ecte **në shit pa çadër**.

**Verejtje.** Në gjuhë të sotme të të shkruarit, prej influencës së gjuhëve të huaja, me parafjalën **në** koha shpesh kallëzohet me anë të një emri abstrakt foljor në kallëzore të çuar a të paçuar, p.sh. **në kryerjen** e detyrës së tyre gjykatat tona janë të pavarura dhe i shtrohen ligjës, **në marrëveshtje** me ta, i hynë punës pa vonesë; **në takimin** kombëtar të rinisë ajo brigadë litoi çmimin e parë; **në fillim** të punës patën disa pengesa e vështirësi; **në mbarim** të seminarit u-organizua një mbremje artistike. Shumë herë në vend të një emri abstrakt foljor duhet përdorë gjinia asnjënjë e mbiemrit foljor, për t'u çfaqur shqip më drejtë kuptimi i kohës, p.sh. u-tregua shumë i përpiktë **në kërkimin** e llogarisë = në të kërkuarit e llogarisë; në këtë rreth ka një përparim të dukshëm **në zhvillimin** e kritikës e të autokritikës = **në të zhvilluarit** e kritikës e të autokritikës; pati formalizëm **në ndjekjen** dhe **zbatimin** e detyrave të planit = **në të ndjekur** dhe **në të zbatuar** detyrat e planit; në këtë vit janë arritur suksese të reja në zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese të vendit = **në të zhvilluarit** më tej të forcave prodhuese të vendit; bie në sy një kujdes i pamjaftueshëm **në trajtimin** e çështjeve = **në të trajtuarit** e çështjeve.

VIII. Tregon idenë e kalimit të një gjëje, të një frymori a të një veprimi prej një gjendje a forme të dhënë në një tjetër gjendje a formë, p.sh. e kthe zinë tanë **ëndë gazëmend** (Buz. 47 b); ma udob ndërrohetë ajri **ndë zjarm** (Bogd. Shk. I. Ligj. IV. 1); lotët e hidhërimit u-kthyen **në lotë gazi**; ato vende djerr po kthehen **në toka** të buta; un tash po shndërrohem **në kalë shalet**; kau kthehet **në nieri** (Kurti, I. 40); kodrat më të mira të fshatit po kthehen **në vreshta** të bukura; fjalët e vrazhda u-kthyen **në zihje** e **përleshje**.

C. **Mungesë e parafjalës «në».** Disa emra, që me parafjalën **në** tregojnë rregullisht një vend, për lehtësi a shpejtësi shprehje nuk e marrin këtë parafjalë dhe duke u thënë pa të marrin funksionin e parafjalës dhe plotësi i shprehur kështu me një rasë oblike bën funksionin e një plotësi vendi a kohe; p.sh. në vend që të themi: shqiptonja po qëndronte **në** majë të shkëmbit themi: shqiptonja po qëndronte **majë shkëmbit**; ajo shtëpi është **faqe dielli** në vend të: ajo shtëpi është **në faqe të diellit**; **hipnë** majë shtepisë (Buz. Luka V. 19) = në majë të shtepisë; gjithë gjendja rrinte buzë detit (Kristof. Mate XIII 2); po rrinte **rrëzë murit** (Doni II 29); kur qante ashtu, u duk Coli **majë shkallëvevet** (Çlirim, 127); ethef i vijnë **krye tri ditsh** = në krye të tri ditëve.

Një analogji me këtë shprehje popullore janë edhe disa shprehje të gjuhës së shkrimit, ku kemi një elipsë të parafjalës **në**, por pa marrë emri funksionin e parafjalës, si në shembëllat e sipërme. Këto shprehje nuk tregojnë, si ato të sipërmet, vend a kohë, por karakteristikat e një personi a të një gjëje; p.sh. me sytë **ngjyrë gështenjë** të hapët; me mustaqe **ngjyrë gruri** të pjekur (Doni II, 73, 74); qielli u mbulua me re **ngjyrë plumbi** (Stuhi 35); me dy sy **bojë hiri**, karrige e shkruar me **kadife bojë kafe** të errët (Çlir. 24, 31); pantallona të shkurtëra prej **stofe të trashë ngjyrë gështenje** (Ballz. 22).

X. **Përdorim pa vend i parafjalës «në».** A. Shumë herë në gjuhë të të shkruarit, nga influenca e gjuhëve të huaja, përdoret parafjala **në**, në



gjuhët klasike e romane në rasi të tilla përdorin një gjindore fthillzuese.

Ky ndërtim i parafjalës **në** me kallëzore të çquar ka ardhur si thamë, vonë në gjuhë të të shkruarit, rrjedhur nga influenca e greqishtes së vjetër e të resë, që parafjalët **εἰς** e **οἱ** i ndërtojmë me kallëzore të çquar. Por edhe influenca e gjuhëve romane, sidomos e italishtes, nuk do përjashtuar, se edhe këto gjuhë parafjalët e tyre, që i përgjigjen parafjalës sonë, i ndërtojnë me kallëzore të çquar. E kështu gjejmë të «Kënka e sprasme e Balës»: gjindja e moçeme s'ish më **në jetën** (f. 30); ajo vëdiq **në vitin** 1837 (f. 38). Si e pamë, shkrimtarët e moçëm të Veriut e të Jugut, si edhe të Rilindjes, e kanë ndërtuar parafjalën **ndër** a **në** me kallëzore të paçquar në njëjës. Këta duke bërë një përdorim të drejtë të kësaj parafjale kanë shkruar sipas natyrës e frymës së shqipes. Ky përdorim është një karakteristikë e gjallë e të folmes së gjuhës së sotme popullore; po të vërejë njeriu të folët e moshës së shkuar dhe jo të së resë (se të rihtë, të mësuar me përdorimin e kallëzores së çquar në shtyp e në letërsi, pandehin se ky përdorim është i natyrshëm dhe i rregullshëm në gjuhë) do të bindet se në gjuhë popullore përdoret gjithmonë ndërtimi i **në-s** me kallëzore të paçquar a me tëjore parafjalore dhe jo kallëzore të çquar; p.sh. thuhet: ra **në pus** ose ra **në pust** dhe jo ra **në pusin**; ra **në pus** të shtëpisë dhe jo ra **në pusin** e shtëpisë; vajti gjer **në fushë** të aeroplanëve dhe jo gjer **në fushën** e aeroplanëve; **në strehe** të shtëpisë, a **në strehet** të shtëpisë e jo **në strehën** e shtëpisë. etj. Kujtoj se shkrimtarët tanë do të bënin një punë të dobishme për gjuhën sikur të shtinin në përdorim, në veprat e tyre, ndërtimin e parafjalës **në** me kallëzore të paçquar njëjës, a me tëjore parafjalore, që është një karakteristikë e rregullshme dhe e natyrshme e gjuhës sonë.

**Verejtje.** Prej parafjalës **n(ë)**, duke i u ngjitur kjo disa klasëve të fjalëve si parashesë, formohen emra, mbiemra, folje e ndajfolje me kuptime të ndryshme; p.sh. emra: **ngjak, ndore, ngishte, ngrackë**, etj.; mbiemra: **i ndiçëm, i ndylltë, i ndritëm, i ngurtë**, etj.; folje: **ndal, ndreq, ndris, ngjall** etj.; ndajfolje: **ndashti, ndiku, ngoje, ngrykë**, etj. (Shih Bulet. Sh. Shoq. (1956) Nr. 4 f. 82 e 83).

**C. Etimologjia.** Sipas Fr. Bopp-it (ibid. 498) te parafjala **ndë** kemi tingullin e parë **n**, një element eufonik. Rrokja **dë** lidhet me sanskrishten **yadi** (= në, aty), se cilës i ka rënë rrokja e parë **ya** (sikundër **gisht**, krhs. sanskr. **angushta** e persishten e re **angusht** = gisht i madh, mik, krhs. **amicus**; i-ja e kësaj rrokje të dytë u-kthye në **ë**. E kështu prej një **n-s** eufonike dhe të shëndrrimit të sanskr. **yadi** u-zhvillua në shqipet parafjala **ndë**.

G. Meyer-i (EW. 299) e lidh parafjalën **ndë** me shllavishten e vjetër **do**, me lituanishten **sa**, ose e nxjerr nga lat. **intus**.

M. La Piana (Catechismo di Matranga, 17) parafjalën **në** e nxjerr nga një metatezë e trajtës **ën** (të Buzukut). Tingulli nisor **n**, në të shqipëtarit e sipër të tij, përfordhet me një shtesë të çfaqur në grupin **nd**, a **nn**, ose **ënd** (ë).

### 3. ënbë, ëm, mbë, më

**A. Përdorimi.** Prej këtyre varianteve, dy të parat janë përdorur prej Buzukut. Trajta **mbë, më** e vjetër se **më-ja**, është përdorur prej shkrimtarëve të tjerë të moçëm, si prej Budit, Bogdanit, Matrangës, De Radës dhe Argjirokastritit. Do shtuar se Buzuku përdor edhe trajtat **më** e **ëm**.

Nga shkrimtarët e Rilindjes, trajtën **mbë** e ka përdorur Kristoforidhi e Vretua, kurse Naimi e Mitkua përdorin herë njerën, herë tjetrën. Samiu përdor trajtën e dytë më tepër. Te përrallat e Pedersenit përdoret trajta **më**, tek të Dozonit më tepër trajta **më**. Ndër shkrimet e veprat që pas Rilindjes gjer më sot është përgjithësuar përdorimi i trajtës **më**.

**B. Funksioni e ndërtimi.** Kjo parafjalë kallëzon: **I. Vendin, tek u qëndron** a ndodhet dikush a një gjësend, lidhur me folje që kallëzojnë të qenë, të qëndruar a të ndodhur. Atëhere ndërtohet:

1) Me kallëzore të paçquar, p.sh. dergjetë **mbë** shtëpi (Argjir. Mate VIII, 6); qëndroi **më një vënd** të lartë (Doz. 56); ate njeri e gjemë **më një nisi** të shkretë (Ped. 28); qëndroj **më një brek** (N.,K. II, 52); dëften se është **mbë rrezik** (M.M. 62); i ati mvrehej **më shtëpi** (Kas. 84); ai qëndroi drejt më këmbë (Lufta 27); qilimi me rrota i arnuar **më dy vende**.

2. Më tëjore parafjalore, p.sh. aj që ruon të drejtënë **ënbë shekullit** (Buz. Ps. 145, 7); jan klenë **ënbë pellgut** të detit (Buz. Korint B. XI, 26); ishte maj madhi **mbë shekullit**; aty e mbë gju-një **mbë truollit** tue e lutunë atë Zot (Bud. Pasq. 120, 182); nukë gjindet nieri **mbë shekullit** që të thoetë s'ashtë Hyj (Bogd. Shk. I, Ligj. 1, 2).

**II. Vendin, ku ndodh një të lëvizur** a të vepruar, ose një të drejtuar për një vend a për një gjësend, lidhur me folje, që tregojnë një lëvizje a një drejtim. Atëhere ndërtonet:

1. Me kallëzore të paçquar, p.sh. vate **ënbë vend** të shkretë (Buz. Luka IV 42); të vobegjitë shpjeri **më shtëpi** tande (Buz. Isaia 58, 7), e doli jashhtë **mbë rrugë** (Argjir. Marku XIV, 68); nukë munt të bjerë **mbë dhe** (Argjir. Rom. IV. 6); kur vate jati **mbë shtrat**; ecë **mbë** shpii (De Rada Antol. 11, 33); dielli kurraj nukë ungetë **mbë dhe** (Bogd. Shk. 1, Ligj. IV. 57); hyri brënda **më një shtëpi** (Doz. 20); vate e ra **më një vënt** t'egër (Ped. 31); në **dasmë** vete kushdo (N. Mës. 24); trokëlliti **më derë** (N. K. II, 44); toksi kcej prej lisit **mbë strugë** e prej struget **mbë qafë** (Kurti I, 23).

2. Me tëjore parafjalore, p.sh. erth **ënbë detit** të Galilesë (Buz. Mate 63, 31); vee roe **mbë qiellit** e **mbë dheet** (Budi, Doktr. 13); tue thanë se vete **mbë qiellit** (Bogd. Shk. I, Ligj. I, 13); t'e qellënjën **mbë shpiit** (De Rada, Antol. 24); sa ma shtoheshinë njerëzitë **mbë dhet** (Kristof. Hist. 8); shtriti **më grazhdit** kalit (Doz. 66); **ënbë derët** trokëllinjëmë (Buz. fol. 24); trokiti **mbë derët** (M.M. 269); trokëlliti **më derët** (N.,K.I,14).

**III. Sikundër me parafjalën ndë** a **në**, që pamë më lart (f. 12), kështu edhe me parafjalën **mbë** a **më**, veç kuptim hapësinor (spacial), sipas shembëllavet të sipërme, kemi edhe një **kuptim abstrakt, metaforik** a të figurte. Në këtë rasë kjo ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. qysh kuur erdhshë **mbë mend** e **mbë shqipe**; qishdo kundrështij e nevojë të të vinjë **mbë krye** (Budi, Pasq. 16, 186); më ka raam dëshirë me sjellë gjë-kafshë **mbë dritë** (Bogd. XXXVI); ata që kanë **mbë dorë** këtë jetë të errurë (Argjir. Efes. VI. 12); vellezërit e tjerë i vuri **më bukë**. (Doz. 31); e vuri **mbë punë** (M. M. 66); i prunë një grua që kishinë zënë **më turp** (N. K. II, 19); çdo yll rrotullohet **më vetëhe** (N. Mës. 53).

**Verejtje 1.** Sikur me parafjalën **ndë** a **në**, kështu edhe me parafjalën **mbë** a **më** kemi një kuptim hapësinor metaforik, kur bashkohet kjo me një përemër a me një emër personi, që vihet në kallëzore të çquar a të paçquar, p.sh. **ëm ty** therresmë, **ëm ty** fshanjëmë (Buz. XIII. 2); përse gjithkush të besonjë **ënbë të**; aj qi ka besë **ënbë muo** (Buz. Gjoni III, 17, VI. 48); përsëri ka qenë nkthjem **mbë ta** (Budi, Pasq. 14); dhuratë qoftë

**mbë ju** (Argjir. Rom. I. 7); kuvëndoç si **mbë njerëz** të mënçurë (Argjir. Korint. A. 15); të njohëmë dashurinë e tyre **mbë na** (Vr. 92); nuk mund të hasi **mbë të** kërkund (Mjed. II, 23); lëshohet **mbë të** (Mjed. III, 123); pas zëmëratës që kishte marrë **më të** (Nov. 31); tuke parë këta turpe **mbë ata** (M. M. 62); ju tha se nesër dua të vinj **mbë ju** (Anon., Bulet. Inst. Shkenc. 1951, Nr. 3-4, 71).

2. Sikundër me parafjalën **ndë a në**, kështu edhe me parafjalën **mbë a më** kemi një kuptim të figurtë vendi në disa rasa të gjuhës popullore, kur formchen me të grupe fjalësh, dmth. **shprehje foljore a lokucione verbale** me vlerë të një idiotizmi të gjuhës; p.sh. e marr **më qafë**; i bie **më qafë**; e ve **më sy** = ja kam kohën, jam mirë nga gjendja; ve gojë **më ndokend** = flas keq, e shprralloj; e zë **mbë gojë**: reforma agrare që e zëni mbë gojë partizanët (Nov. 61); mbahem **më të madh** = lëvdohem, mburrem: nukë është mirë të mbajturitë tuaj **mbë të madh** (Argjir. Korint. A. VI. 6); mbahem **më të lartë a më të larta** = krenohem madhësh-tohem; e ve **më be**: i vuni **mbë be** (Kristof. Hist. 36); vij **më vetëhe**: kur arçë **më vetëhe** (N. K. II. 31); bie m'ëre: qeni ra **mb'ëre** (Kristof. Fjalor 96).

IV. **Mënyrën** me të cilën çfaqet një veprim konkret a një gjëndje e jashtme. Atëhere ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar: a) emrash të përgjithshëm, p.sh. u qit **ënbë gjunjë** përpara Tinëzot (Buz. Luka, V, 8); nxihej moti **mbë shi**; u vesh **mbë këllogjër** (De Rada. Antol. 45, 56); kje gjykuem **mbë mort** (Bogd. Shk. III, Ligj. IX, 9); që të hajë **mbë shijë** (Vr. 72); pinin duhan duke ndërjur **më bisht**; e përqafoi **më nge** të shoqen (Doni II, 11, 80); donte që t'i binja **më gjunjë** (Tokat, 377); ai qëndroi drejt **më këmbë** (Lufta, 27) — b) mbiemrash asnjans të substantivuar, p.sh. mos marrish emënin e Perëndisë **mbë të kotë** (Kristof. Abet. 15); (vinte) **mbë të rrallë** (Vr. 133); mbahenë **më të larta**; u hoq **më të larta** (N. Mës. 47, 54); era frynte **më të lehtë** (Nov. 79); një karrocë kalonte **më të rrallë** nga kjo rrugë (Stuhi, 67).

2. Me shprehje ndajfoljore, p.sh. **më nesëret** ay kish vatur e shikonte kopështin' e zgjeruarë (N. K. I. 37); bie **më gjunjazi** (Don Kish. 18); u munduan **më kot** t'i ndajnë (Çlir. 44).

V. **Mënyrën** me të cilën shprehet një gjëndje e mbrendëshme shpirtërore, ose një tendencë me anë fjalësh afektive. Atëhere ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. iku ajo **mbë ditë të keqe** (M. M. 62); të liqtë kanë zemrën e shpirtinë **në brengë** (N. Mës. 8); kish ardhur **më qejf** pas të larit (Doni II, 84);

VI. **Kufizimin** e kuptimit të fjalës së përcaktuar. Ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar: a) emrash të përgjithshëm, p.sh. me angjënuom veçse **mbë bukë** e **mbë ujë** (Budi, Pasq. 26); të bijtë i ngjajnë t'et **mbë punë** (Kristof. Hist. 10); kualtë dahanë shumë farësh **mbë shtat** e **mbë qime** (Kristof. Abet. 10); e kapërcej **mbë dituni** (Kristof. Fjalor) — b) gjinisë asnjansë të mbiemravet participorë, p.sh. drunja ishte e mirë **mbë të ngratët**; i pari ishte i egër **mbë të pamët** (Kristof. Hist. 3, 26); gjuha shqipe është e lehtë **më të shkruarë** e **më të kënduarë** (N. K. I, 3).

2. Më tëjore parafjalore, p.sh. ndonëse jam i trashë **mbë fjalët**, por jo edhe **mbë mend** (Kristof. Korint. B. XI, 6); dëshira e lidhja që kanë mbajturë bres pas brezi **më kombërit** të tyre (Sami, shqip, 29).

VII. **Kohën** kur bëhet a ndodh gjëkafshë a mbarohet një punë, lidhur me fjalë që kanë kuptim kohe, ose me numërorë. Atëhere ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar: a) emrash të përgjithshëm, p.sh. të mos bënë të t'ikuritë tuaj **mbë dimër** (Argjir. Marku XIII. 15); ai kishte lemë **mbë të dhetëtin** bres prej Semit (Kristof. Hist. 12); të vinj **mbë tre vjet**; mundet t'i godisnjë **mbë një natë** (M. M. 60, 66); të më godiç një palë pallate **më dyzet ditë** (Doz. 44); me të shkelur **më të njëzetatë** (Sami, Shqip. 74); **më vapë herë** i zbriti kalit (N. K. II. 19); kur dilnin ato **më drekë** (Kas. 60); hymë në fshat **më drekëherë** (Tokat 79); **më një shtator** hapen shkollat — b) gjinisë asnjane të mbiemrit, p.sh. kur hyri **mbë t'errët** mbrenta (De Rada, Antol. 60); mblihdeshin **mbë t'errëtit** (De Rada, Milosao XII, 11); që **mbë të vogëlë** (Nr. 81) — c) gjinisë asnjane të mbiemrave participorë, p.sh. e tue votë dielli **ënbë të ndenjunë** (Buz. Luka. IX, 40); **mbë të mbaruemit** thotë (Bogd. Shk. I, Ligj. II, 15); **mbë të nisurit** e ruan (De Rada, Milosao VII, 34); **mbë të dihtur** e djela (De Rada, Antol. 51); trëmbem mos nuk u gjej juvet **mbë t'ardhurë** (Argjir. Kor. B. XII, 24); **më të nkthyerë** një natë, u ndoth me pesë a gjashtë shokët (M. M. 57); shkonte në çiflik **më të ngrysur**; kur ishin **më të ndarë** i tha (Kas. 67, 68); tërë udhës **më të kthyer** qëndroi me turi lëshuar (Doni II. 70); dielli ish **më të perënduar** (Stuhi 114); **më t'errur** nëna i shtroi sofrën (Nov. 18).

2. Me tëjore parafjalore, p.sh. dërgoi shërbëtorëtë e ti **ënbë herët** të darkësë (Buz. Luka XIV. 17); edhe qëlloi **mbë të tretët** ditë, kur po festonte (Kristof. Hist.).

VIII. **Qëllimin** e një të vepruari. Ndërtohet me kallëzore të paçquar p.sh. a mos kishje dhanë denaar **mbë drithë** a **mbë venë** (Budi, Pasq. 64); mëma i dërgoi djemtë **më fitim** (N. K. II, 4).

IX. **Vazhdimin a përsëritjen** e një pune, kur shtihet parafjala në mes të përsëritjes të së njëjtës fjalë ose në mes të dy fjalëve të së njëjtës kategori, me kuptim vendi, kohe a mënyre. Ndërtohet me kallëzore të paçquar: a) me kuptim vendi, p.sh. **shkëmp më shkëmp e lis më lis** (Doz. 107); një njeri i varfërë, që lipënte **derë më derë** (N. K. II; 30); ballistët **shtëpi më shtëpi** po bënin plaçkë (Bereq. 12); b) me kuptim kohe, p.sh. të mos përcjellë **ditë mbë ditë** e sod **mbë nesër** (Budi Pasq. 114); kreaturëtë përcillenë **ditë mbë ditë** tue u ruejtunë (Bogd. Shk. I, Ligj. I, 6); c) me kuptim mënyre, p.sh. aty t'u kapë **rrok më rrok** (Kurti I, 55); **fyty më fyty** (trimat) konkan kap (Raps. Mujës, Nr. 20, 180).

Verejtje — Herë herë kjo farë shprehje tregon të bashkuarit a të puqurit e të njëjtave gjëra, p.sh. u puthnë **buzë më buzë**; ishnë qafosurë **qafë më qafë** (Ped. 159); kuvëndonin **kokë më kokë**.

X. **Pjesëtimin** e një gjëje a të një të tërë. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, a me rrjedhore, p.sh. atëhere njerëzit ishinë damë **mbë shumë kombe** (Kristof. Hist. 12); edhe uça **më katër**; e preu **më dy** (Doz. 60, 66); të ndarë me **Gegë e Toskë**; kjo udhë të ndahet **më dy dega** (Sami, Shqip. 28, 79); gjuha i ndan njerëzit **më kombe**; njerëzit ndahen **më fara** (N., K. I. 2, 5); e ndante jetën e saj **më dy pjesë** (Kas. 64); rruga ndahet **më dysh** (Doni II. 5); do ta thyente **më dysh** (Stuhi, 10).

C. **Paralelizme midis parafjalëve** ndë a në e mbë a më dhe parafjalëve të tjera. Si u-pa me gjithë shembëllat mbi parafjalët ndë a në, mbë a më, këto dy parafjalë, si e thotë edhe Pedersen (Alban. Texte 158), janë sinonime duke u-përdorur thujasë kudo, sa njëra tjetra. Ja disa shembëlla të tilla: **ëndë kafshë** të mëdha nuk eca (Buz. Ps. 130, 1) = nuk ecej **mbë punë** të mëdha (Kristof. ibid.); të jetë mbajtonë urdhënimeshit qi kaa **mbë vetëhe**; për diekeqe qi kaa **ndë vetëhe** (Budi, Pasq. 11,12);

përveçë shpirti i njeriut që rri **mbë të** (Argjir. Korint. A. 2, 11) = qi është **nd'atë** (Kristof. ibid.); **ndë gjithë dhe**; që më ka mua **mbë shtëpi** (Argjir. Rom. 9, 18; 16, 23) = **mbë gjithë dhenë**; **ndë shtëpi** (Kristof. ibid.); **ndë çdo vënt** (Argjir. Korint. A. I. 2) = **mbë çdo vent** (Kristof. ibid.); vetëm asllanëtë rrinë **në derë**; ata që janë **më derë** të mbrëmësve (Doz 58); na Toskëtë e këthyemë **në Arbërë**; Romanëtë e kanë këthyerë **më Alban** (Sam. Shqip. 3) i ati pa që karafilja s'hapte dot lule **m'atë vënt**, e nxori andej dhe e vu **ndë një vënt** të plehëruarë (N., K. II. 26); nxori djemtë **më fitim**; djemtë vanë **në fitim** (N., K. I. 4); trokëlliti **më derët** (N., K. I. 14); trokëlliti **në derë** (N., K. II. 30).

Lidhur me këto janë për t'u-përmendur disa fjalë të gjuhës, që përdoren herë me parafjalën **ndë a në**, herë me **mbë-n** a me **më-n** disa të tjera përdoren më tepër me njerën se me tjetrën. Ja disa nga këto fjalë:

**anë:** 1) me parafjalën **mbë a më**; p.sh. rri **ënb anë** të djathtë teme (Buz. Ps. 112, 1); sikur daam e qitunë **mb'anë** (Budi, Pasq. 247); vate **më një anë** të lumit; mori dialënë **më n'anë** (Ped. 36. 41); **m'anë** të tejme që një mulli (Doz. 22); e do të heqë **m'anët**; **më n'anë** tjetërë (Sam. Shqip. 38. 42); e mori për dore **më n'anë** (N. K. I. 7); pyes **mbë të gjithë anëtë** (Vr. 31); **mbë të dy anët**; i dal **mb'anë** një pune (Mjeda III, 151. 160) — 2) me parafjalën **ndë a në**, p.sh. një kaike ish **n'anë** të detit (Ped. 24); ndënji **nd'anët** të një kopshti (N. K. II. 23); djali ndënj **nd'anë** të lumit (Athena, 45, 78).

**udhë:** 1) me parafjalën **mbë**, p.sh. **ënb udhë** të paqës (Buz. IX/a); **ënb udhë** piu ën torentit (Buz Ps. 109. 7); kishite me shëfryem shumë të vështira **mb'udhë** (Kristof. Hist. 23); **mb'udhë** po mendohesh (Doz. 68); dështojti pela **mb'udhë** (M. M. 61); për me mos mbeturë **mb'udhë** (N. Mës. 3); do ta humbiste **mb'udhë** (Don Kish. 193); s'dolli **mb'udhë** (Don. II 84); — 2) me parafjalën **në**, p.sh. **në udhë** që vij gjeti një ulk përpara; **në udhë** u-pojnë të di (Ped. 29, 37); çdo njeri që piqte **në udhë** (Doz. 40); kur dëgjoji zën e saj **në udhë** (Bereq. 10).

Sikundër duket, fjalët **anë** e **udhë** duan më tepër parafjalët **mbë a më** si në gjuhë të popullit, ashtu edhe në të shkrimt.

Foljet **besoj** e **shpresoj** a **shpërej** dhe shprehjet **kam besë**, **kam shpresë** përdoren, më të shumën, me parafjalët **mbë a më**, p.sh. shpirti em **pat shpënesë ënbë Tënëzonë** (Buz. Ps. 129, 5); **kam besë mbë Tënëzonë** (Budi, Pasq. 157); **kij shpëresënë mbë të madhet** mëshërier të Tinëzot (Budi, Pasq. 157); e ata do të shpërejné **mbë të** — (Argjir. Rom. XX, 12); s'kish **besim më trup** të tij (Nov. 58); por edhe: aj qi **ëndë muo** beson (Buz. Gjoni. XI, 25) = kush beson **mbë mua** (Argjir. ibid.). Folja **gjykoj** merr parafjalën **për** ose **mbë a më** në gjuhë të vjetër, p.sh. e ata ta gjykonjë për **mort** (Buz. Mate XX. 19); do ta gjykonjë për **vdekëjë** (Argjir. ibid.); qenë gjykuom të dy **mbë mort** të shëmtueme (Budi, Pasq. 98, 220); kurse në gjuhë të sotme merr parafjalën **me**: e gjykuan **me vdekje**, **me varje**. Folja **daj** a **ndaj** merr parafjalën **mbë a më**, si e pamë më lart, por edhe parafjalën **ndë a në**, p.sh. ndaheshin **më shumë fara**; duke ndarë **në shumë dega**; kur u nda mbretëri e Romanëvet **më dy** (Sami, Shqip. 5, 6, 8); pallanga ndahetë **në gasëra**; moti ndahetë **më katër kohë** (N., K. I. 13. 18); duket sikur revolucioni na ndan **në dhen** e **në dhi** (Doni II, 93).

**Verejtje.** 1. Në disa shprehje të gjuhës së vjetër parafjala **mbë** zë vendin e një parafjale tjetër në gjuhë të pastajme e në të sotmen. p.sh. ranë të vdekurë **mbë një ditë** (Argjir. Korint. A. X. 8) = **për një ditë** (Kristof. ibid.); nd'u thirrte juvet **mbë gosti** (Argjir. Korint. A. X. 27) =

për gosti (Kristof. ibid); udhës piqetë mbë të birë të mbretit (M. M. 57) = me të birë; mbë të djathtë e mbë të mëngjër = nga e djathta e nga e mëngjëra.

2. Për eufoni, nga ndonjë herë, përpara fjalëvet që nisin me **n** a **nj**, përdoret parafjala **mbë** a **më** në vend të parafjalës **ndë** a **në**, p.sh. **mbë ndonjë** vend, **mbë ndonjë** ditë (Budi, Pasq. 14), ryri brënda **më një** shtëpi; ta hedhim jashtë **më nonjë** vënt, e vunë **më një** lis, e hodhi kuçedrën **më një** hendek (Doz. 20, 21, 36, 79).

3. Me parafjalën **m(ë)**, duke i u-ngjitur kjo disa klasëve të fjalëve si parashtesë, janë formuar emra, mbiemra, folje e ndajfolje me kuptime të ndryshme: p.sh. emra: **mëndore**, **mëngojë**, **mkrejcë**; mbiemra: **mujak** a **mbujak**, **i rrrudhët**, **i mvrojtur**; folje: **mballoj**, **mbëltoj**, **mbërshel**, **mbukurqj**; ndajfolje: **mpari**, **mbrëma**, **mbas**, **mbasandaj**, **mbërdhe**. etj. (Shih Bulet. Shk. Shoq. 1956, Nr. 4. f. 82 e 83).

4. **Etimologjia**. Parafjala **mbë** sipas Fr. Bopp-it (ibid.499,500) lidhet me sanskrishten **abi**, me greqishten **ἀμφί** e me latinishten **amb-**

5. Si duket, parafjala **mbë** a **më** është duke u-zhdukur në gjuhë të sotme të shkrimit duke ia lëshuar vendin parafjalës **në** ose një tjetre. Vetëm në të shënuarit e datës përdoret sot parafjala **më**: **më gjashtë** të muajit, **më dy** të gushtit, etj. Duke ndjekur shembëllën e shkrimtarëve të moçëm, të Rilindjes dhe të gjuhës së folur, që e përdor edhe sot, shkrimtarët tanë do të bënin punë të dobishme, sikur ta shtinin prapë në përdorim, sipas rasës e nevojës.

#### 4. te, tek, nde, ndek, ne, nek, tu, tuk, ke

A. **Përdorimi**. Ndër gjithë këto trajta të ndryshme, te Buzuku, Budi, Bogdani, Argjirokastriti, De Rada, Dozoni, Mitkua, Vretua e Kristoforidhi gjejmë përdorimin e trajtave **te**, **tek**, **nde**, **ndek**, Pedersenit përdor **ne-n** e **nek-un**. Te Kristoforidhi gjejmë **te** e **tek**. Naimi e Samiu përdorin parafjalët **te**, **tek** e **ne**. Parafjalët **tu** e **tuk** përdoren në Veri prej disa shkrimtarëve të vjetër, si prej Pashko Babit e prej disa të rijve, si prej D.Kurtit. Parafjala **ke** përdoret më tepër në të folët e Shqipërisë së mesme dhe në të shkruar, prej Anonimit t'Elbasanit. Në gjuhë të sotme të shkrimit, ndër vepra letrare e në shtyp ka marrë sipërinë përdorimi i trajtave **te** e **tek**.

B. **Funksioni e përdorimi**. Kjo parafjalë kallëzon:

I. **Vendin**: a) **ku gjindet** e **ndodhet** a bëhet dishka. Ndërtohet me emërore zakonisht të çquar, p.sh. porsi klë **nde** e **zanët** ënfill (Buz. Ps. 127, 6); qëndroi pakëz **te kroj** (M. P. 277); atje **nek ajo kasaba** ish një mbret (Ped. 25); dikush trokiti **te dera** (Stuhi 40), ishte ndëjë një ditë të **rranza** e lisit (Mjed. III. 14); e lidhi gomarin të **hekurat** e derës (Atan. 7); s'kem kurrnji të mirë tu shpija (Kurti I. 13) — b) **ku gjindet** a **ndodhet** një person. Ndërtohet me rasën emërore, p.sh. po faji që rri **tek unë** (Argjir. Rom. VII. 17); e di se nukë rri **tek unë** një gja e mirë (Kristof. Rom. XV. 29); jam detuer **te grekët** e **te barbarët** (Kristof. Rom. I. 14); gjithë ç'ka gjithësija është **te njeriu** (N. Mës. 6); mendimin e kam **tek ti** (N. K. I. 21).

II. **Vendin**: a) **për ku drejtohet një të lëvizur**. Ndërtohet me emërore zakonisht të çquar, p.sh. vete prapë **nek ajo shkallë** (Ped. 28); vente nga dalëzë **nde der'** e dhomësë (M. M. 67); ban dru në mal e kthen **tu shpija** — (Kurti I. 13) b) **për ku drejtohet e lëvis një person**. Ndërtohet me emërore, p.sh. tue u kthvem shërbëtori **te i zoti** (Buz. Luka XIV. 21); tue fluturuem vote **te ajo** (Bogd. Shk. III. Ligj. I, 2); do të apëmë llogari

nde **Perëndia** (Argjir. Rom. XIV. 11); e zunë dhe e shpunë **ne mbreti** (Ped. 25); hiq **nde e motra ime e** mesme, usosnë **tek mbreti** (Doz. 23, 75); mbë të parë vemi **nde miq** dhe **nde të njohurë** (Vr. 142); ardhni dita qi ta shpiem **tek i dhënderi**, vajti **ndek ay** (M. M. 58, 66); mbasandaj ata votnë **te mbëreti** (Kristof. Hist. 48); e dërguanë **te gurëçmonjësi** (N., K. II. 48); t'viin **tuk une** (P. Babi. Bak. 172); shkon **tu ndjerka** (Kurti I. 62) erdha **ke ju**; vote **ke Petri**; ungre shpejt e vote **ke ai** (Anonimi, 71, 81. 96); shihete **tek ai** një njeri të madh (Lufta, 23).

**Verejtje.** 1. Sikundër shihet te shembëllat e sipërme, parafjala **te** përdoret me emra gjërash e frymorësh pikërisht si parafjala **mbë a më**, e cila, si e pamë më lart, ka të njëjtin përdorim. Prandaj në një funksion me emra gjërash e frymorësh kemi një paralelizëm midis këtyre dy parafjalëve duke u-përdorur sa njera-tjetra: p.sh. dikush trokiti **te dera** (Stuhi, 40) = trokëlliti **më derët** (N., K. I. 18); është shpërfaqunë **tek ata** (Kristof. Rom. I. 19) = është e çfaqurë **mbë ta** (Argjir. ibid): të luturatë që bëj **te Perëndia** (Argjir. Rom. X. 2) = lutëja qi bāj **mbë Perëndinë** (Kristof. ibid); kur të vete ndë Spani. kam me ardhunë **te ju** (Kristof. Rom. XV. 24) = kur të shkonj për Spanjë, do të vij **mbë ju** (Argjir. ibid.); edhe unë erdha **te ju** (Kristof. Korint. A. II. 3) = e unë ndenja **mbë juvet** (Argjir.) Rrallë herë kemi një paralelizëm të parafjalës **te** me parafjalën **ndë a në**, e cila, si e pamë më sipër, ka një kuptim hapësinor të theksuar duke u-përdorur më tepër me emra gjërash; p.sh. të padëgjueshim **te përint** (Kristof. Rom. I. 30) = të pabindurë **ndë përint** (Argjir. ibid.)

2. Si e pamë, parafjala **te** ndërtohet gjithmonë me emërore zakonisht të çqar, punë, që tregon origjinën e saj ndajfoljore; por për të venë re është se këte parafjalë e gjejmë tek Argjirokastriti të ndërtuar me rrjedhore të përemërit dëftor, p.sh. mos i mbani ata të vinjënë **tek meje**; mos uzëmëro **tek meje** (Mate. XIX. 14 dhe XVIII. 26); prura djalin tim **tek teje** (Marku IX. 17). Mbase kemi këtu një influencë të greqishtes së re.

3. Parafjala **te** ka një përdorim të gjerë në arbërishten e Italisë duke zëvendësuar në shumë rase parafjalët **në a më** të gjuhës sonë; p.sh. gjëmbat që vireshin **tek udha** (De Rada, Milosao II. 32); pra që dielli i ra **te shtrati**; u-pruar **te shpiu** e saj (De Rada, Milosao XIV I. 15); kle shtur **te zjarri** (Fjala Nr. 1, 2); vuri Adhamin **te një kopësht** (Fjala, Nr. 2, 3); na ruan **të gjithë gjella jonë** (Fjala, Nr. 3, 3) = na vështrojnë në gjithë jetën tonë. Aty edhe kuptimi i kohës çfaqet me parafjalën **te**, kurse ndër ne me parafjalën **më a në**; p.sh. **tek e pastajmja heer** e ditës (De Rada, Milosao XII, 21) = n'orë të prapësme a të mbrapëme të ditës; **te dita e nesërme** gjinde e shumë kish ardhur (Fjala, Nr. 6,2); arrenjëm **te ditët** e prindëvet t'an, **tek i dimbëdhjetëmi vit**; **tek ai mot** (Kënk. e spr. 52, 60); këto bëri ai **tek e para ditë** (Fjala, Nr. 1, 2).

4. Si dihet, parafjalët **te, tek, ndek**, etj. përdoren edhe si lidhëza duke formuar fjali vendore, kohore e shkakjore. a) Fjali vendore: **tek s'ke vënë**, mos merr (N., K. II. 5); Shqipëri i thonë ati vendi **tek rrinë**. Shqipëtarët (Sami, Shqip., 3); vate atje **nek ish djali**; vate **nek kish punënë** (Ped. 27, 29); një ushtuer kur pa atë **tek ishte vjerrë** mbë drut (Kristof. Hist. 89); si erth **ke ishte** Isusi (Anonimi, 97) — b) Fjali kohore: një mëngies **ndek mësonte** njerëzinë në hietoret; kali **tek ecënte**, cëndroj përnjëherë (N.K. II, 18. 31); **ndek shpëren** që të fitojë. humo (Vr. 45); **tek mbanin** me të mirë çupëzën, oeshi ajo një ditë (M.M. 58); i hipën kalit, dhe **tek ecënte** na del përpara një kuçedrë (Doz, 23); e kini me gje-

tun një njeri **ke bar** një shtambë me ujë (Anonimi, 72); — c) Fjali shkaj-kore: mendoheshin të venë e të blenë gjë për të ngrënë, **tek s'kishin asgjë** (M.M. 58).

5. Herë-herë parafjalët **te, tek, ndek**, etj., kur ndërtohen me një përemër a emër personi, tregojnë shtëpinë a banesën e tij, dhe atëhere i përgjigjen parafjalës frengjishte **chez**; p.sh. i ulut që të rrinj' atë natë **tek ai** (Kristof. Hist. 15); eja të shkojmë **tek ne** të pimë çaj (Stuhi. 27); sonte do të jemi për darkë **te shoku** Hekuran; sot do të vini **te ne** për drekë.

5. **Etimologjia.** Parafjala **te** del nga rrënja përemrore indoevropiane\* **to** dhe lidhet me asnjansin e vjetër \* **tod**, greq. **τό**; mbase mund të jetë një rrjedhore e këtij asnjansesi (G. M. E. W. 425. Alban. Stud. III, 23; N. Jokl, Untersuch. 26).

### 5. ëndaj, ndaj, ndej, nnej

A. **Përdorimi.** Trajta e parë është përdorur prej Buzukut dhe e dyta prej shkrimtarëve të tierë të moçëm e të Rilindjes të Veriut e të Jugut. Trajtat **ndej** e **nnej** kanë një përdorim të kufizuar ndër disa shkrime të mëvonëshme të Veriut. Sot, në gjuhë të të shkruarit, ka marrë një përdorim të përgjithshëm trajta **ndaj**.

B. **Funksioni e ndërtimi.** Kjo parafjalë tregon:

I. Me kuptim të mirëfilltë iden' e të afërit te një vend a te një person. Ndërtohet:

a) me kallëzore, të çquar tek emrat p.sh. e ata qi klenë **ëndaj muo** u larguonë ën meje (Buz. Ps. 129, 4); të jeesh gjithëherë **ndaj engjijt e ndaj shintënit** (Bud. Pasq. 126); avitëniu **ndaj mue** (Bogd. Shk. I. Ligj. III, 16); ngrefi qytetin e Nivevisë **ndaj lumin'** e Tigrin (Krist. Hist. 106); **ndaj shtratit, ndaj detin** e zi (De Rada, Antol. 49, 64); i uli kamilletë **ndaj një pus uji** (Kristof. Hist. 20).

b) me vendore a rrjedhore, p.sh. gjet Anën, gruen e vet, **ndaj deret** të kishës (Bogd. Pj. II. Shk. I, Ligj. 10); si të jenë vuum njani **ndaj tjetërit** (Bogd. Shk. I, Ligj. III. 12); **ndaj drittësores** (DK. II, 48); ndënj në hijet të një ahu **ndaj burimit**; kish rënë **ndaj trastësë** (N. K. II. 15, 16); të sëmurëtë mos i lini vetëmë, po hiqni gjithënjë **ndaj syresh** (N. Mës. 24).

**Verejtje** — Ideja e të afërit çfaqet me këtë parafjalë edhe në kohë, e atëhere ndërtohet me kallëzore, me dhanore-rrjedhore, me ndajfolje: **ndaj mesditës** vinej Orku (De Rada, Antol. 9); **ndaj natë** e **ndaj nate**; **ndaj natëherë**; **ndaj mbrëma** u muar vesh kjo (Tokat, 25); dielli ish **ndaj të perënduar** (Doni, 86); **ndaj të gdhirë**; **ndaj të errur**; **ndaj të dalë** të vjeshtës.

II. Me kuptim të figuratë përdoret me emërin e vetës lidhur me qëndrimin e tij për një gjë a një të vepruar. Ndërtohet: 1. Me kallëzore të çquar, p.sh. **ëndaj Tënëzonë** gjithë fjalë mundë jetë (Buz. XIV b); **nnej Zotin** gjaa nuk ásht qi s'munn i delet (P. Babi, 171); **ndaj burrat** e urtë s'ka fjalë të pahieshme. 2. Me rrjedhore, p.sh. **ndaj Bektashinjet** gjithësija është vetë Perëndija (N. Flet. Bekt. 4); të liqtë **ndaj njerëzisë** s'kanë nder e dashuri (N. Mës. 8); **ndaj meje** kjo punë s'është e drejtë.

**Verejtje.** 1. Si duket nga gjithë këto shembëlla, parafjala **ndaj** në gegërishtet ndërtohet, më të shumën, me kallëzore, në toskërishtet me rrjedhore, veç De Radës, që e ndërton me të dyja këto rasë. Ndërtimi me kallëzore i gegërishtes i përgjigjet, ndërtimit me këtë rasë të parafjalëve latine **ad e apud**; **ad urbem, apud fontem**; i toskërishtes me rrje-

dhore i përgjigjet ndërtimit me dhanore të parafjalës greqishte: **Παρά: παρά: τῆ πηγῆ, παρά τῆς ἀρχαίας.**

2. De Rada parafjalën **ndaj** e përdor edhe si ndajfolje, duke e vënë pas foljes, p.sh. Orku kish tri kriatte që flejin **ndaj**; Cicili, ç'ish **ndaj**, u vu e thërritnej; kur arrënej dhendërrri e hora **ndaj** (Antol. 10, 36, 52). Mbase kemi këtu një influencë t'italishtes, si duket nga përkthimi që i bën ai kësaj parafjale me parafjalët italishte **appresso, d'intorno, al fiance** të vëna pas foljes.

3. Sipas shembëllavet të mësipërme të shkrimtarëve të moçëm dhe të Rilindasvet, që pasqyrojnë edhe gjuhën popullore, parafjala **ndaj** tregon këto dy relacione: 1) me kuptim të mirëfilltë iden' e të afërit për vend, për person a për kohë; 2) ate të qëndrimit të dikujt për një gjë a për një të vepruar. Përkundër këtyre relacioneve themelore, në gjuhë të sotme të të shkruarit kjo parafjalë po përdoret me relacione drejtimi a tendence a të ndonjë tjetër fare, relacione që shqipja i çfaq me parafjalë të tjera e me konstrukt tjetër. Ja disa këso shembëllash që nuk tingëllojnë mirë shqip: dashuria e fshatarësisë **ndaj tokës**; ata nuk e ndjejnë fellë përgjegjësinë **ndaj detyrës**. Në këto dy shembëlla duhet përdorë parafjala **më**, si e pamë më lart, f.24 V, dhe parafjala **për**, si do të shohim më tutje, prapo: dashuria e fshatarësisë **më tokën**, a **për tokën**; ata nuk e ndjejnë fellë përgjegjësinë **më detyrën**, ose **përgjegjësin' e detyrës**. Gjithashtu janë për t'u ndrequr: ata i kanë shlyer detyrët **ndaj shtetit** = ata i kanë shlyer detyrët **më shtetin** a **kundrejt shtetit**; shkolla duhet t'i edukojë nxënësit me qëndrimin socialist **ndaj punës** = shkolla duhet t'i edukojë nxënësit me qëndrim socialist **më punën**; ata nuk i plotësojnë detyrët **ndaj fëmijëve të tyre** = më fëmijët e tyre; sot janë rritur kërkesat **ndaj nxënësve** = sot janë shtuar kërkesat **më nxënësit**, ose **sot kërkohet shumë prej nxënësve**. Paralelisht me këto shtrembërime ndërtimesh me parafjalën **ndaj** janë për t'u-përmendur disa shembëlla konstruktsh të drejta me parafjalë të tjera: të kemi të gjithë dashuri e dhëmbje **mbë njeri-tjetrin**; duhet të kemi të gjithë dashuri të madhe **për mëmëdhenë** (N. Mës. 17, 38); këtë dashuri që kanë Shqipëtarët **për kombësin' e tyre**; ajo do të tregojë një dashuri të çquarë **për Shqipëtarët** (Sam. Shqip. 36, 43). Herë-herë në vend të parafjalës përdoret rrasa gjindore, p.sh. pabesërija e **memëdheut** dhe e **kombit** është mëkat' e madhe; aju njeri që s'ka dashurinë e **mëmëdheut** është një farë kafshe (N. Mës. 28 e 38).

Nga gjithë këto del se si përdorim i shtrembër i parafjalës **ndaj**, që po ndodh në shtyp e ndër prodhimet letrare nuk është sipas frymës e natyrës së shqipes, ka rrjedhur nga një influencë prej gjuhësh së huaja, e prandaj është e udhës që të ndreqet sipas shembëllave të mësipërme.

4. Me këtë parafjalë janë krijuar në gjuhë të shkrimit, si parashtesë, pak neologjizma, p.sh. **ndajfolje, ndajshim**, të përdorura si terma gramatike.

#### 6. ënbii a përenbii, mbi, mi, përmbi, përmi

A. **Përdorimi**. Trajtën e parë e ka përdorur Buzuku. Trajtat e paasimiluara **mbi** e **përmbi**, janë përdorur rëndom prej shkrimtarëve të lashtë të Veriut e të Jugut. Nga Rilindasit Kristoforidhi e Vretua përdorin trajtën e paasimiluar, kurse Naimi e Samiu përdorin herë një-rën herë tjetrën trajtë. Pedersenit e Mitkua përdorin të paasimiluarën, dhe Dozonit më tepër këtë të fundit. Në mes trajtavet të thjeshta e të përngjitura nuk ka ndryshim kuptimi. Në gjuhë të sotme të shkrimit, në

shtyp e në prodhime letrare, përdoret trajta e thjeshtë, porse kemi një fluktuacion në mes dy trajtave të thjeshta, me asimilim ose pa të, dhe koha do ta kallëzoje se kujt do t'i mbetet sipëria e përdorimit.

B. **Funksioni e ndërtimi.** Kjo parafjalë tregon: I. Një të qenë në sipërfaqe ose më lart se dishka: 1. Me kuptim vendi të mirëfilltë. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar, p.sh. vuri binan' e shtëpisë **mbi një gur** (Argjir. Mate XII, 24); të mos flemë as **mbi gur**, as **mbi baltë** (Vr. 68); atje **mbi qiparis** pa një fole zogu (Ped. 27); pikoi një pikë gjak **mbi dëborë** (Doz. 49); zuri vënt **mbi një lis** (M. M. 62); era bëhetë ujë dhe bije **mbi dhe** (N., K. I. 32); i prunë një ulok djergunë **mbi shtrat** (Kristof. Mate IX. 2); ndë raftë vesa **mbi lamsh të leshit** (Kristof. Hist. 73); bletët fluturojnë **mbi mollë**; kena **mbi kulm** të shtëpisë rrëfeprojsin (Mjed. II. 6. 15); Stefani qe zgjuar me tingëllimën e ziles **mbi krye** (Çlir. I, 10); loste **mbi dëborë** si i dehur; i lëshoi **mi gjunjë** një picetë të qëndisur (Tokat 6, 52); Qamili hodhi **mbi kurris** barrën e misrishtave (Ujë. 7); topuzi ulet **mbi shpinë** të tij (Kurti I, 21).

b) Me vendore, p.sh. të jetë **përënbii** shtëpit të Jakobit (Buz. Isaia VII. 3); **përënbii qiellit** është të madht e ti (Buz. Ps. 112, 5); çë feksën qielli **mbi rehevet t'aan!** (De Rada, Antol. 39); të ciatë kafshë dërgoi **përmbi shekullit** (Bud. Pasq. 133); **mbi ajrit** krijoi Zotynë zjarrë (Bogd. Shk. I, Ligj. V 19); mos e çtrij dorënë tande **përmbi djalit** (Bogd. Shk. II, Ligj. II, 18); një njeri i cili koditi shtëpin' e vet **mbi ranët** (Kristof. Mate VII 27); dotë të ngjijtjnjë **mbi dhet** (M. M. 65); lëmsh' i dheut këthehetë **mbi boshtit të ti**; nga të këthyerit' e dheut **mbi boshtit të ti** (N. Mës. 16, 33); ajo i u-qas djalit, i vuri dorën **mbi supt** dhe i foli me të mirë.

c) Me kallëzore të çquar, p.sh. lëshoi **mbi qerën** e qerozit një lot (M. M. 63); a nukë të ka vojuem Zoti për të parë **mbi trashigimin e vet'** (Kristof. Hist. 78); e shihja se më fluturonej **mbi shpiin** (De Rada, Antol. 84); lozi me gishta **mbi bravën e çantës** (Tokat 11); i pështetur **mbi bish-tin e sëpatës** (Atan. 94).

**Verejtje.** Si shihet te shembëllat e sipërme, parafjala **mbi** prej shkrimtarëve të moçëm e të Rilindjes ndërtohet me kallëzore të paçquar a me vendore, dhe jo me kallëzore të çquar, ose ndërtohet fort rrallë me të, si duket tek ato dy shembëllat e Mitkos e të Kristoforidhit. Ndërtimi i kësaj parafjale me kallëzore të çquar është përdorur prej shkrimtarëve të kohës pas Rilindjes, ka hyrë pra në gjuhë të shkrimit dhe ka rrjedhur prej influencës së gjuhëve greqishte e italishte, që parafjalët e tyre, përgjigjëse të shqipes, **ἐπί, su, in** e ndërtojnë me kallëzore të çquar. Ja disa shembëlla të tjera të këtij ndërtimi në gjuhë të sotme, të shkrimit: hodhi një sy **mbi kalin** (Doni II. 22) në vend të: hodhi një sy **mbi kalë**; lozi me gishta **mi bravën e çantës** (Tokat, 11) = lozi me gishta **mi bravë** të çantës: kishte fluturuar e po qëndronte **mbi kulmin** e shtëpisë = po qëndronte **mbi kulm** të shtëpisë: do të ndërtohen dy hidrocentrale **mbi lumin e Bistricës** = **mbi lum** të Bistricës. Ja edhe dy shembëlla të gjuhës arbreshe sipas sintaksës italiane: shëndetja e tire ndodhej **mbi majën e kordhavet** (Kënk. e Spr. 64) = **mbi majë** të kordhavet; të lehen **mbi dheun** gjithë kafshat (Fjala, 1913, Nr. 1, 3) = të lehen (lindin) **mbi dhe** gjithë kafshat. Po ky fenomen sintaktik ka ndodhur edhe me parafjalët në a **ndë** e cila, si u-pa më lart, (f. 12 paragr. X, B) po ndërtohet në gjuhë të sotme të të shkruarit, me rasë kallëzore të çquar, tek duhej të ndërtohet rregullisht me kallëzore të paçquar

a me vendore. Do t'ishte mirë pra që të ringjallej prej shkrimtarëve tanë përdorimi i ndërtimit të kësaj parafjale me kallëzore të paçquar a me vendore, sipas natyrës e frymës së gjuhës, së shprehur, si e pamur, ndër shembëllat e shkrimtarëve të lashtë e të Rilindjes. Vetëm kur caktohet regjimi i parafjalës me një mbiemër a me një plotës **jo në rasë gjindore**, mund të durohet një ndërtim me kallëzore të çquar, p.sh. kish renë **mi shtratin** prej mushamaje (Doni II, 84), por mund thuhet më mirë: kish rënë **mi një shtrat** prej mushamaje; nga çdo dele muarën 80 kg. qumësht **mbi rendimentin e planifikuar**; do të marrim 50 ton çimento **mbi planin vjetor**; porse: **mbi plan të vitit** dhe **jo mbi planin e vitit**.

2. **Me kuptim vendi të figurtë**. Ndërtohet me kallëzore të paçquar • me tëjore parafjalore, p.sh. mori **mbi** sy të gjitha e dolli partizan (Bereq. 17); ka njëmijë halle **mbi kokë** (Buka 22); e kam **mbi krye** e sipër; përëndaj na ra kyj shtrëngim **mbi kokët** (Kristof. Hist. 32); bujqitë livruenë **mbi shpinët** t'eme (Kristof. Ps. 39, 3); të thyejmë zgjedhënë që po na rëndon **mbi zverkut** (Sam. Shqip. 96).

II. **Idenë e një drejtimi me qëllim kundërshtimi**. Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. u-lëshua pela **mbi kalë** dhe kali **mbi pelë** (Ped. 39); e ata u nisën të venë **përmbi Kordhën** (M. P. 278); u sul **përmbi ta** (M. M. 65).

III. **Idenë e sipërisë, të epërsisë a të së tepërmes**. Ndërtohet me kallëzore të çquar, të paçquar a me tëjore parafjalore p.sh. e u ty **përmbi shumë kafshë** kam me të vum (Buz. Mate XXV, 23); kishte një bir të sillënë doj mirë **përmbi gjithë kafshëtë** kësaj jete; u dukej se kanë një pushtet **përmbi natyrëtë** nierit (Bogd. Shk. I. Ligj. I, 9, 16); ishte një gjar-pënë dijekeq **mbi gjithë shtansëtë** dheut (Bogd. Shk. I. Ligj. VII. 1); dotë të bëjmë mbëret **mbi gjithë vëndin** tënë (M. P. 298); kishte një kopështë të bukur fort, i cili **përmbi të gjitha** kish edhe një dru ftuaje (M. M. 61); e duam mirë **mbi gjithë shërbiset** (Fjala, Nr. 3, 3); ishin mbledhur për ta dëgjuar **përmbi gjashtëqind veta**; epërsia e socializmit **mbi kapitalizmin**; nga shiu u-dëmtuan **mbi dyzet hektarë** perime; autokinemaja ka dhënë n'atë fshat **mbi njëzet** çfaqje filmi.

IV. **Idenë e një kohe të caktuar**. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. **mbi ato llaf** që llafoseshin mbreti me fjalënë, vete vajz' e mbretit e i shpie kafe (Ped. 25); të më ndërtojësh **mbi tri ditë** e sipër një të kë-tillë lodrë (M. M. 66); të mos vesh sy të keq mbë mua, se **përmbi gjashtë muaj** nukë dotë mënonj (M. P. 274); u ngjall **mbi tri ditë**, ashtu si ai tha gjindes (Fjala 1913, Nr. 7, f. 4).

V. **Idenë e argumentit** të gjësëndit, për të cilin flitet, shkruhet, botohet, çfaqet mendim a qëndrim, merret vendim. Ndërtohet me kallëzore të çquar, p.sh. u-fol **mbi veprimtarinë** e **mbi sukseset** e asaj ndërmarrje; si foli **mbi rëndësin'** e asaj dite të shënuar, u-bisedua **mbi nevojën** e një organizimi më të mirë të punës; u-botuan të dhëna konkrete **mbi zhvillimin** e arësimit e të kulturës; është çfaqur me kohë qëndrimi i tyre **mbi këtë çështje**.

**Verejtje 1.** Kv përdorim i kësaj parafjale me këtë funksion të fundit tregon një influencë të gjuhëvet të huaja, si të frengjishtes a t'italishtes, në të cilat ideja e argumentit çfaqet me parafjalët e tyre **sur, su, sopra**, që i përgjigjen parafjalës sonë **mbi** a **përmbi**. Do shtuar se gjithë këtë influencë të frengjishtes ka pësuar edhe gjuha romune me parafjalën e saj **asupra**. Mirë po në të tilla raste idenë e argumentit shqipja e çfaq me parafjalën **për**; duhet thënë pra: u-fol **për veprimtarinë** e **për suksese-**

set e asaj ndërmarrjeje; ai foli **për rëndësin'** e asaj dite të shënuar; u-**bo**-tuat të dhëna konkrete **për zhvillimin** e arësimit e të kulturës, etj. Me foljet **flas**, **shkruaj**, **botoj**, **bisedoj**, **diskutoj**, **kuvëndo**, **mendohem** idenë e argumentit shqipja pra e çfaq me parafjalën **për**. Me gjithë përhapjen e madhe t'atij konstrukti të huaj, në shtyp sidomos, nuk do hequr dorë nga përdorimi i konstruktit shqip me parafjalën **për**, kur duam të shkruajmë një shqipe të pastër.

2. Këtë parafjalë e gjejmë si parashtesë në disa klasë fjalësh të gjuhës popullore; emra apelativë: **përmbigrua** (shemër), **përmbiemër** (llagap); **përmbinip** (Bogd. Sh. I. Ligj. VII, 13; emra topikë: **Mbishinjon**, **Mbishkodër**; ndajfolje: **përmbipardje**, **përmbipasnesër**. Në gjuhë të shkrimit janë formuar me këtë disa kategori fjalësh; emra: **mbiemër**, **mbishkrim**, **mbivlerë**, etj; mbiemra: **i mbinatyrshëm**, **mbinjerëzor**; i **përmbiteshëm**, etj.; folje: **mbiçmoj**, **mbikëqyr**, **mbivlerësoj**, etj. bashkë me derivatet e tyre.

3. **Etimologjia**. Parafjala **mbi**, sipas Fr. Bopp-it, nga origjina është identike me greqishten **ἐπί**.

### 7. **ëndënë**, **ndënë**, a **ndën**, **nënë**, **nën**, **nen**, **nan**.

A. **Përdorimi**. Nga këto trajta, e para është përdorur prej Buzukut. Trajta e dytë prej Budit, Bogdanit e Argjirokastritit. Buzuku veç trajtës së parë përdor edhe trajtën **për ëndënë**. Nga shkrimtarët e Rilindjes Kristoforidhi e Vretua përdorin trajtën **ndënë**. Mitkua përdor trajtën **ndënë e nënë**, gjithashtu përdorin këtë trajtë të fundit edhe Dozoni e Peder-seni. Samiu e Naimi përdorin më tepër trajtën **nënë**. De Rada përdor më tepër trajtat **ndëen e nëen**. Trajta **nân** është e rrallë. Në gjuhën e sotme të shkrimit, ndër prodhime letrare e në shtyp, duket një fluktuacion në mes trajtavet **nënë e nën**, rrallë **ndën**. Koha do t'e tregojë se kujt do t'i mbesë më tutje sipëria e përdorimit.

B. **Funksioni e ndërtimi**. Kjo parafjalë tregon: I. **Idenë e të qënit ulët**: 1. Me kuptim vendi të mirëfilltë. Ndërtohet: a) Me kallëzore të pa-çquar; p.sh. e erdh e ëndenj **për ëndënë një lis** (Bus. 44 V b); uku **ndënë lëkurë** të deles (Bud. Pasq. 81); tue u vum gurët **ndënë krye të vet** (Bogd. Shk. I, Ligj. III, 12); u prëjtin **ndën lis** të madh (De Rada, Milosao XII, 5); kur jeshe **ndënë fik** (Argjir. Gjoni I, 49; edhe vu një gur **ndënë krye** për të fjeturë (Kristof. Hist. 23); mos flemë **ndënë hie** peme natënë (Vr. 68); vuri veshnë sa të gjegjet **ndënë dhe** (M. P. 299); vate **nënë hie** të lisit (M. M. 65); e fshehnej tamburanë **nënë sjetullë**; **nënë drasë** ishnë flori shumë; të rriç **nënë mollë** (Ped. 25, 27, 41); duke çapur **nënë dhe** dolli në një mal (Doz. 33); **ndënë parzëm** asht barku (Mjeda, I, 88); **rrite nën hije** të një dardhës së madhe (Mjeda, II, 31); ato lulzoshin **ndën hije** të lisavet të moçëm; **ndën fyt** zgjatet krahnori (Mjed. III, 4, 95); dy sy të vegjël **nën një ballë** si çomage (Çlir. I. 10); e flak kasqetën **nënë tryezë**; ay s'kishte gjësendi **nënë mushama** (Tokat, 38, 76); i kishte shkuar **nënë qafë** dorën e djathtë (Stuhi, 24); ca zbritën ne kroj **ndënë udhë** (Bereq. 16); mshehet **nën shkallë** (Kurti I. 28).

b) Me kallëzore të çuar, p.sh. e vloi **nën shtraan**; e **ndëen shiin** çë rrëjidh sipër (De Rada, Antol. 11, 60); kur ishnje **ndënë drurin'** e **fikut** (Kristof. Gjoni I, 49, toskërisht); rrinte **ndënë pjergullin'** e **vet** (Kristof. Hist. 92); e **nën qiellin e hapur** (Don. Kish. 33).

c) Me vendore, p.sh. u mbëlledhshinë ujnatë **për ëndënë** qiellt (Buz. Gjen. LIX/2); e ujnatë ma të trasha mbetnë **ndënë** qiellt (Bogd. Shk. I.

Ligj. IV. 23); ecja per **nëen ullinjet** (Milosao, III, 17); kur ti ishje **nën fikut** (Fjala, 1913, Nr. 1, 1); për të ulëshuar poshtë **ndënë dhet**; ky pra i lëryerë **nënë dhet** (M. M. 62, 65); dardha bije **nënë dardhët** (N. Mës. 18).

2. Me kuptim vendi të figurtë. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, a të çquar, a me vendore, p.sh. fshihte **nënë maskën** e krenarisë një pamje tjetër (Doni II, 100); **ndënë gjuhët** t'ati ashtë e keqja (Kristof. Pas. X, 8); kishte tetëmbëdhjet' enëntë vjet **nën lëkurë** (Bruski, 14); analfabetizmi **nën moshën** dyzet vjeç u zhduk krejt nga Shqipëria; punonte **ndën dorë** pa e kuptue kush.

II. **Idenë e uljes, të urdhërit, të të mposhturit a të nënshtrimit.** Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar, me vendore p.sh. munduom **për ëndënë ordhënë** të Pilatit; e tash **ëndënë Jezu Krishtinë** (Buz. XXV b); me qenë **ndënë urdhënitë** t'parit (Bud, Pasq. 102); është **ndënë urdhër** të burrit (Argjir. Korint. A. XI, 10); e të lëkundunitë gjymtyrëvet pat me kjanë **ndënë urdhënitë** volëndetsë (Bogd. Shk. I. Ligj. VI, 20); ishte **ndënë pushtet** të Jebusitëvet (Kristof. 86); Tyrqitë po i mbajnë kombetë **nënë një egërsi, nënë një varfëri, nënë një tirani** që tëmeron gjithë botënë (Sam. Shqip. 58); dështuan me turp gjithë orvatjet e imperialistëvet, për t'i vënë vendet socialiste **nënë zgjedhë** të çifligarëvet.

**Verejtje.** 1. Si u pa te shembëllat e sipërme, shkrimtarët e herëshëm dhe të Rilindjes e përdorin parafjalën **ndënë** a **nënë** shpesh me kallëzore të paçquar a me tëjore parafjalore dhe rrallë me të çquar, kurse përdorimi me këtë trajtë të fundit është përhapur me të madhe në gjuhë të sotme të shkrimit në vend të kallëzores së paçquar a të vendores; p.sh. ndënji **nënë hijen** e një mani (Atan. 29) në vend të: ndënji **nënë hije** të një mani; për këtë krh. N., K. II, 23: ndënj **nënë hije t'arrësë**; fshiu djersët e ballit **nënë strehen** dhe pastaj hyri në dhomën e tij (Doni II, 84) në vend të: fshiu djersët e ballit **nënë strehe** e pastaj hyri **në dhomë** të tij; edhe për këtë krh. Kristof. Mate VIII, 8: nukë jam i zoti që të më hyjsh **ndënë strehet**; gjithashtu: dy koce të dëndura që dilnin **nënë shaminë** (Ujët 18) = dy koce të dëndura që dilnin **nënë shami**; mezi ecin **nënë peshën** e barit (Dh. Shuteriqi, Çlir. 43) = mezi ecën **nënë peshë** të barit; mendja e tij undodh **nënë pushtetin** e një ndjenje të çuditëshme; (Stuhi 20) = mëndja e tij u ndodh **nënë pushtet** të një ndjenje të çuditëshme; popujt e Afrikës ranë **nënë zgjedhën** e kolonizatorëvet = ranë **nënë zgjedhë** të kolonizatorëvet; gjithë veprimtaria e tij është **nën kontrollin** e masave punonjëse = **nën kontroll** të masave punonjëse; kjo lihet **nënë kujdesin** e punëtorëvet = **nënë kujdes** të punëtorëve.

Përveç kësaj parregullie, parafjala **nënë** a **nën** në gjuhë të sotme të shkrimit po përdoret në vend të parafjalëve të tjera, p.sh. **nënë she-mbullin** e asaj ndërmarrjeje po ecin edhe ndërmarrjet e tjera = pas she-mbëllës s'asaj ndërmarrjeje po ecin edhe ndërmarrjet e tjera; sivjet po vihen **nën kulturë** dhe dhjetra ha. tokë të reja = sivjet **po gatiten për kulturë** ose sivjet do të **hyjnë në kulturë** edhe dhjetra ha. tokë të reja. Këtu hyjnë edhe disa sintagma që përdoren në shtyp: **nën udhëheqjen e, nën kujdesin e, nënë mprojtjen e**, të cilat thuhën me mirë shqip: **me udhëheqjen e, me kujdesin e, me mprojtjen e**. Gjithashtu fraza: **u-thirr nënë armë** (Tokat 46) është një përktim i frëngjishtes **sous les armes** a t'italishtes **sotto le armi**; shqip do t'ishte: **u-thirr për armë**, sikundër thuhet **u-thirr** a u ftua **për darkë, për dasmë**, etj. Të gjitha këto janë përktime nga frëngjishtja a italishtja, të cilat në rase të tilla përdorin parafjalët e tyre **sous** (fr.); e **sotto** (it.). Do shtuar se edhe në ruma-

nishtet parafjala **sub** është përdorur në gjuhë të shkrimit pas gjedhes së frengjishtes a gjermanishtes në vend të parafjalëve **cu, din, in e prin**. (J. Jordan, Limba romina contemporana, 499-500).

Ky farë përdorimi i parafjalës **nënë** a **nën** mund përdoret në gjuhë për disa rasa, p.sh. kur kufizohet fjala e përcaktuar prej një mbiemri, p.sh. qeshi **nën barrën e rëndë** të shkarpavet (Atan. 94); **nën mbikqyrjen e rrehtë** të oficerëve (Doni II, 82); etj. Në rasa të tjera mund përdoret pun' e madhe kallëzorja e paçquar ose tëjorja parafjalore. Prandaj është e arësyeshme që të mos hiqet dorë nga përdorimi i kësaj parafjale me kallëzore të paçquar a me tëjore parafjalore, përdorim që i përshtatet mirëfilli strukturës së natyrëshme të shqipes.

2. Sikundër parafjalën **ndaj**, që pamë më sipër (f. 25), kështu edhe parafjalën **ndëen** De Rada e përdor si ndajfolje, mbase pas parafjalës italishte **sotto**, që përdoret në këtë mënyrë; ndieta shehën se më tundej **ndëen** (Antol. 36) = e ndjeva se po më tundej karriga përposh.

3. Këte parafjalë e gjejmë si parashtesë në disa emra apellativë e topikë të gjuhës popullore, si **nënbarke, nënbishte, nënkamce, nënkreje** (= jostek), **nënqingje; Nënshat, Nënnavrio** etj. Gjuha e shkrimit ka formuar me këte parafjalë si parashtesë një tog fjalësh duke i përkthyer nga gjuhët e huaja; emra e mbiemra: **nëndarje, nëndetse, nëndrejtor, nënkryetar, nënshtetas, nëntoger, nëntokë, etj.**, i nëndheshëm, nëntokësor, etj.; folje: **nënçmoj, nënkuptoj, nënshkruaj, nënvlërësoj, etj.** (Shih. Bulet. i Shk. Shoq. 1. c).

4. **Etimologjia**. Sipas Fr. Bopp-it (501) parafjala **ndën** lidhet me sanskrishten **adās**.

## 8. Kaa, kâ, kah, kaha, nga, na, ngaha.

A. **Përdorimi**. Tri trajtat e para të kësaj parafjale janë përdorur prej shkrimtarëve të moçëm të Veriut, si prej Buzukut, Budit e Bogdanit. De Rada ka përdorur trajtën **ka** e **kaa** dhe **nka**, këte të fundit e kanë përdorur dhe shkrimtarë të tjerë arbreshë, si Matranga, Dara e të tjerë. Kristoforidhi ka përdorur trajtën **nga** për toskërishten dhe trajtat **kah** e **kaha** për gegërishten. Këto të fundit janë përdorur edhe prej shkrimtarëve të mëvonshëm të Veriut. Trajta **ngaha** është përdorur edhe prej shkrimtarëve të Jugut, si prej Mitkos. Trajta **nga**, popullore në Jug e në Shqipëri të mesme, e përdorur në të shkruar të Jugut që prej Argji-rokastritit e tehu, është përgjithësuar sot në gjuhë të shkrimit duke dalë krejt sipër trajtavet të tjera.

B. **Funksioni e ndërtimi**. Kjo parafjalë ndërtohet gjithmonë me emërore të çquar. Tregon:

I. **Pikënisjen** nga një vend a nga një gjësend në lidhje me një veprim a ndodhje, p.sh. një ditë u-ngre **nga fshati** e vate më një anë deti; atje **u-zdirgj nga karoca** dhe hiri më një shtëpi (Ped. 24, 87); si u kthye djali **nga shtëpia** (Doz. 60); sa u pat kthyer **nga mërgimi** gjatë (Atan. 10); zbriste vetëm **nga mali** (Ujët 9); i shpien nga fshati në qytet prodhimet e bujqësisë; e përshëndeste **nga dritarja** e aeroplanit; duhet të nisemi **nga të dhëna** konkrete.

**Verejtje**. Këte pikënisje parafjala **nga** e kallëzon në të folët e Jugut e të Shqipërisë së mesme, kurse në të folët e Veriut ky funksion tregohet me parafjalën **prej** (si do ta shohim më tutje), p.sh. kthehem **prej pazarit**, del **prej shtëpie**, etj.

II. **Drejtimit** për një vend, për një njeri a për një gjësend me qëllim pak a shumë të caktuar, p.sh. shtatë dema të bukurë po hypshinë **kah lumi** (Kristofor. Hist. 29); me gjithë këtë u kinja të **veja ka vreshta** (De Rada, Antol. 35); e ktheu syrin **nga shtëpia** e armikut (Kas. 137); kaloi pa sjellë kryet aspak **kah plaku** (Mjed. II. 12); mbasi u nginë tuj pa njato sende, drodhne **kah shtëpia** (Mjed. III. 147); një odë e vogël me një dritare të vetme **nga oborri** (Çlir. I. 8); u drejtua përnjëherë **nga ay** (Doni II. 80); i grah gomarit **kah mullini**; i u desht me kthye **kah shtëpia** (Kurti I. 19, 23).

**Verejtje.** 1. Parafjala nga me këte funksion tregon drejtim të pacaktuar me përpikëri përkundër parafjalës **në**, që e kallëzon drejtimit të caktuar, p.sh. një ditë na shkoi një dervish **nga ajo kope** (Doz. 25), këtu kemi një drejtim të papërcaktuar mirëfillit. Kur themi: po vete **nga pazari, nga dyqani**, ose po dal **nga pazari, nga dyqani** tregoj një drejtim të pacaktuar, kurse kur themi: **po vete në pazar, në dyqan**, ose **po dal në pazar, në dyqan** tregoj një drejtim pak a shumë të caktuar. Përveç kësaj, shprehjet me foljen **dal** të bashkuar me parafjalën **nga** tregojnë pikënisjen **për një vend** dhe pikënisjen **nga një vend**; p.sh. **dola nga pazari a nga vreshta** do të thotë: 1) si dola nga shtëpia a nga një vend tjetër, u-nisa për të vajtur në pazar a në vreshtë: 2) duke qenë në pazar a në vreshtë, dola nga këto vende dhe u-nisa për gjetkë. Për t'i dalluar këto funksione duhet të mendohemi se në rasë të parë shprehja mund të çfaqet edhe me rasë rrjedhore ose me parafjalën **në** dola pazarit, dola vreshtës, ose dola në pazar, dola në vreshtë, kurse në rasë të dytë mund të zëvendësohet vetëm me parafjalën **prej** dola prej pazarit dola prej vreshtës.

2. Ndonjë shprehje tjetër me parafjalën **nga** kallëzon të qëndruarit, të ndenjurit në një vend, atëherë kjo parafjalë ka vlerën e parafjalës **në**, p.sh. ai tërë ditën e shkente nga shtabi (Bereq. 12) = **në shtab**. Gjithashtu mund zëvendësohet **nga**-ja me **në**-n, kur kallëzohet një lëvizje, një drejtim për një vend, p.sh. e dërgoi e shoqja **nga hani** (Ped. 28) = **në han**; e ç'do të kemi **nga fshati** vëllezër! (Atan. 11) = **në fshat**. Këso farë shprehjesh janë të zakonëshme në të folët të Jugut më tepër, prandaj mund themi se këtu kemi, në mos një influencë, një paralelizëm me të greqishtes së re, e cila në këso rasash përdor parafjalën **ἀπό** që i përgjigjet këtu parafjalës sonë **nga**.

III. **Prejardhjen**, d.m.th. të ardhurit, të dalët, të kthyerit:

1. Nga një vend, nga një gjësend, nga një të ndodhur a të qenë, p.sh. i doli një trandafil **nga faqja** (M. M. 58); të mblidhen trimat **ngaha gjithë anët** e anëvet (M. P. 297); doli kuçedra **nga pusi** (Doz. 33); dheu është një shkëndij' e këputurë **nga dielli**; avulli ngrihetë **nga deti** (N. Mës. 33, 34); **nga fytyra** i kullonin djersë të ftohta (Atan. 39); **nga gazetata** e muarëm vesht (Stuhi 114); të ardhura të mira u-siguruan edhe **nga blegtoria; nga ushtar** i thjeshtë arriti shef shtabi të një regjimenti.

2. Nga një person a gjithsesi nga një frymor, p.sh. i thotë i shoqi ç'do **nga mua**; ç'të mirë doni **nga u** të ua bëj (Ped. 27, 33); kjo varet **nga ju**; po vij nga **Petrity**; e mora vesht **nga im vëlia**; **nga çdo dele** mori 80 kg. qumësht.

**Verejtje.** 1. Këtu hyn edhe kuptimi i origjinës d.m.th. i burimit a i gurrës, ngaha del dikush a dishka, p.sh. ish **nga katundi** Drithas (Atan. 10); ata ishin **nga derë** fisnike (Ballz. 23); ajo ishte **nga der'** e madhe dhe e pasur (Lufta, 8); Drini del **kah liqeni** i Ohrit (Mjed. Kënd.); shqipja rrjedh **nga ilirishtja**.

2. Herë-herë me parafjalën **nga a kah** tregohet një vend abstrakt, p.sh. vajza si u-ngre nga gjumi (Ped. 26); u ngrit **nga gjumi** dhe e vrau (Doz. 34).

IV. **Largimin**, d.m.th. të ruajturit a të shpëtuarit, të ikurit, të ndarët a të hequrit nga një kafshë a nga një person, p.sh. si vate mërguarë nga shtëpia hapi kutinë; u s'helq dorë **nga ti** (Ped. 26, 36); këjo më shpëtoi nga vdekja (Doz. 37); **nga ky njeri** s'kam shpëtim më (M. P. 277); shpëtoj kombinë **nga të këqijatë**; prapsi **nga ligësitë**; ndruhu **nga gjithë të këqijatë** (N. Mës. 53, 54, 58); shëroheshin me një herë **nga plagët** (Don Kish. 26); të qirohet far' e ligë **nga ara** (Doni 91); ay i shpëtoi **nga duartë** (Tokat 77); kjo ndërmarrje doli **nga prapambetja**; e çarkakuan **nga detyra**; e pushuan **nga puna**. Këtu hyn edhe kuptimi i **largësisë**, p.sh. Tirana mba nga Durrësi 38 kilometra.

V. **Kalimin** nëpër një vend; edhe iku e vate nga ajo udhë që i tha Asllani. (Ped. 33).

VI. **Shkakun** nga i cili rrjedh një të vepruar, p.sh. i derdhet që ta hante, po **nga bukuria** i erdhi keq dhe e la; ai **nga frika** nuk u përgjegj (Doz. 23, 63); i rraskapitur **nga lodhja** (Kas. 138); i u ngjeth misht **nga të ftohtit** (Ujët 10); **nga kjo punë** të korrat s'ecnin (Bereq. 13); e njohu se ish e shoqja **nga të ecurit** (Doni II. 80); u hidhërua **nga vdekja e t'et**; i u-ndritën sytë **nga gëzimi**; e njohu përnjëherë **nga zëri** se ish ay; ky përmirësim u-arrit **nga kujdesi** i veçantë i kooperativistëve.

VII. Personin a frymorin **veprues** ose sendin konkret a abstrakt të përfytyruar si veprues me anë të një folje refleksive, intransitive a perifrastike, p.sh. mos mëconi si ata që u prishnë **nga prishësi** (Argjir. Korint. A. X. 10); u trëmp **nga kau** (Ped. 27); fjala e tij u-duartrokrit **nga të pranishmit**; degët e lisavet dridheshin **nga lodrat** e zogjvet (Kas. 3); nuk i ndjeu duartë që ishin prerë **nga fletët** e mprehta të misrit (Ujët 9); fushat tona po çahen për ditë **nga kanale** kullonjës e ujitës; punët e bujqësisë përcaktohen edhe **nga koha**.

VIII. **Pikëfillimin** e një pune a të një gjëje lidhur me vendin a me kohën ose punën e mbaruar, p.sh. shqipëtarët s'kanë nevojë të zirenë **nga armëtë** (Sami, Shqip. 60); Piqininua me shokët uzunë **nga djallëzitë** (N. K. I); përveshi mëngët e këmishës dhe filloi **nga puna** (Atan. 101); duhet të fillojmë **nga të vjelat** (Ballz. 19); si sosënë **nga buka**; në ate mot do pushonte **nga puna** (Doz. 24. 65); mbaroj **nga të folurit** plaku (Dhorat Argj. 34); ka tri ditë që ato brigada kanë filluar **nga puna**.

**Verejtje.** Këto farë shprehesh me parafjalën nga janë të zakonshme dhe bërë popullore në të folët të Jugut të Shqipërisë, kurse në krahinat e tjera të saj këto i përgjigjen funksionit të një kundrine në rasë kallëzore, p.sh. duhet të fillojmë **nga të vjelat** = duhet të fillojmë **të vjelat**, si sosën **nga buka** = si sosën **bukën**, etj. Nga përhapja e këtyre shprehjeve vetëm në Jug, duket se kemi këtu një influencë të greqishtes, e cila foljet **ἀρχομαι** (= «filloj», të greqishtes së vjetër) dhe **ἀρχίζω** (= «filloj», të greqishtes së re) i ndërton me parafjalën **ἀπό** = nga, p.sh. **ἀρχομαι ἀπό τῶν προγόνων** (greq. e vjetër, = po filloj nga stërgjyshërit, **ἀρχισε ἀπό τὰ κλάματα** (greq. e re) = zuri nga të qarat, etj. Me analogji të shprehjes me foljen filloj a zë është formuar edhe shprehja me foljen mbaroj a sos: si sosënë **nga buka**, si mbaruan **nga buka** (Doz. 24. 79). Prapó, në të folët të Veriut e të së mesmes foljet **nis**, **zâ fill**, **filloj** nuk ndërtohen me parafjalën **nga**, po me kallëzore, si e pamë këtu sipër, ose me parafjalën **me**: po zamë

fill me një gotë raki, etj. Folja **mbaroj** ndërtohet edhe me një emër foljor në rasë rrjedhore në të dy dialektet; tashti mbarova së **shkruemi** a së **shkruari**; ose me një infinitiv, sipas të folit të Veriut; tash mbarova **me shkruar**.

IX. **Sasinë e një gjëje** të ndarë a të pjesëtuar për çdo njësi, p.sh. thotë mbreti, të thoshte gjithëkush **nga një përrallë** (Doz. 24); ua dau **nga pesë** kokra për shoq; u dha **nga një dash** për shpërblim.

X. **Tërësinë**, grumbullin nga e cila mirret një pjesë, p.sh. vate një **nga të naftërit** dhe e gjeti; një **nga të di** vëllezërit (Ped. 24, 31); ti na heth pak thërrime **nga bukë të mykurë** (Doz. 59); dridhetë të prishnjë gjëkafshë **nga gjëja** që ka (Vr. 62); duan të marrën **nka e bëna** e shokëvet (De Rada, Antol. 62); ishte oficer nga kuadrat e vjetra (Doni, 92); nuk ishte **nga pleq'** e fshatit m'i shkuari (Bereq. 11); për të shitur një dhi **nga ato** që kishte (Atan. 11); ai ka qenë një **nga ata** që muarën fletën e lavdërimit.

XI. **Anën a pjesën e një vendi a të një gjëje**, p.sh. ja mori **nga duartë**; e vështron **nga brim'e** derës (Ped. 26, 72); vete ta zërë **nga dora**; zërë **nga veshi** (Doz. 36, 73); i ra luga **nga dora** dhe nisi të qarit (Kas. 51); po e zinte **nga krahu** (Lufta, 17); hoqi pushkën **nga supi** (Doni II. 98)

XII. **Krahasimin** (të shkallës krahasore a sipërore) në mes dy elementeve të një fjalie a të dy fjalëve, p.sh. do shitet më mirë **nga ç'do shitej**; ish m'i bukur **nga thëllënza** (Ped. 70, 91); kur merr më pak **nga ç'ep** (N. Mës. 29); Shqipëria do të bëhetë një **nga më të mirëtë e nga më të bukuritë** vënde t'Evropës (Sami, Shqip. 59); ishte më i pakët **nga unë** (Tokat, 54); u-mbaruan mbjelljet një muaj më parë **nga viti** i kaluar; i kanë dorëzuar shtetit dhjetë herë më shumë pambuk **nga ç'i dorëzuan** vitin e kaluar.

XIII. **Kufizimin e kuptimit të fjalës së përcaktuar**, p.sh. këndonej aqë mirë, sa prishi dynjanë **nga mënt** (Ped. 35); erdhi duke çaluarë **nga këmba** (N. K. II. 34); ata daheshin njani prej tjetrit **kah puna e kah mendja e kah shkalla** (Kristof. Hist. 135); një grua e pakë **nga trupi** (Doni II. 5); i sëmurë **nga mend** (Tokat 21); **nga shtati** ishte nja pesë këmbë i lartë (Ballz. 21); i shkuar **nga moshë**; i randë **kah veshët**; burrë beset si **kah fjala, si kah puna**.

**Verejtje**. I afërt me kuptimin e kufizimit është edhe kuptimi «sa për», «për sa i përket» që tregohet me këtë parafjalë, p.sh. të vemi t'i shohimë qysh janë **nga shëndeti** (Doz. 79); tregu është i paligjshëm **kah kanuja** (Kan. 53); ai nuk merr vesht **nga politika**.

XIV. Kohën e çfaqur përafërsisht me fjalë që tregojnë kohë, p.sh. **nga fundi** i korrikut mbaron korja e grurit; do të kthehem në fshat **nga e shtunda**; **nga mezi** i korrikut parashikohet të mbarohet shkolla e re; tha se do të kthehej në shtëpi **kah mbramja**. Për të treguar përafërin' e kohës më pak të caktuar vihen përpara **nga-s** a **kah-së** ndajfoljet **aty, si, andej**, p.sh. **aty nga mezi** i vitit të kaluar u-ngreh një tjetër kooperativë n'atë rreth; kam me ardhë **aty kah mesdita**; u-kthye **andej aty kah mbramja**; arrin **si nga ora** gjashtë.

**Verejtje 1**. Parafjala **nga e vënë** në mes të së njëjtën fjalë kallëzon vazhdimin e një të vepruari në rasë kallëzore të paqquar me kuptim: a) vendi, p.sh. (i mblodhi) **golë nka golë, fjalë nga fjalë** (Kënk' e spr. 30, 38); b) kohe, p.sh. i pille **ditë nga ditë** nga një koqe ve (Doz. 38); **vit' nka vit** (Kënk' e spr. 24); c) mënyre, p.sh. i zbriti **dy nga dy** shkallët; po ecnin **katër nga katër**. Në këto farë sintagmash toskërishte, në gegërishtet, sidomos të Veriut, parafjalës **nga** herë i përgjigjet parafja-

lës për, herë parafjala **kah**: ditë për ditë, vit për vit; i zbriti shkallët **dy kah dy**; po ecnin **katër kah katër**, etj. Shprehja **nga viti në vit**, që shihet herë-herë në shtyp, është një **calque** nga greqishtja a nga italishtja, se shqip duhet thënë **vit nga vit** ose **vit për vit**.

2. Sintagma e formuar me parafjalën **nga** të ndjekur prej një emri në emërore të çquar a të paçquar nuk e çfaq drejt shqip kuptimin e lëndës; nuk thuhet p.sh. **lugë nga dru** a **lugë nga druri**, por **lugë druri** a **lugë e drunjtë**, **unazë floriri** a **unazë e florinjhtë**<sup>1)</sup>. Shprehje të tilla, si **lugë nga dru**, **unazë nga flori**, e në qoftë se thuhen rrallë gjëkund kallëzojnë një influencë të greqishtes së re, e cila tregon kuptimin e lëndës me parafjalën **ἀπό** (**ἀπό ξύλο, ἀπό σίδηρο** etj), që i përgjigjet parafjalës sonë **nga**.

3. Nga ndonjë herë parafjala **nga** e bashkuar me një emër i përgjigjet, sidomos në gegërishtet, një plotësi në rasë rrjedhore të këtij emri, p.sh. luajti **nga mëntë** (t.) = luejti **mensh** a **menç** (g.); e lidhi **nga këmbët** e **nga duartë** = e lidhi **kambësh** e **duersh** (Rapsodi i Mujës Nr. 20, f. 12).

4. Parafjala **nga** në toskërishtet e n'arbrishtet, më tepër kur bashkohet me fjalë kohe, merr kuptimin e parafjalës **për** ose të mbiemrit të pakufishëm **çdo**, p.sh. vdes **nga ditë** (Argjir. Korint. A. XV 31) = **për ditë** vdes (Kristof. ibid.); bora mëmën e me atë **nka të mirë** (De Rada) = çdo të mirë; **nka mbrëma** çë falej (Athena 45, 132) = çdo mbrëma kur falej; **nka njeri** (= çdo njeri) prirej gëzuar (Kënk' e spr. 34); krhs. **nga mot** e gëzuar.

5. Parafjala **nga** dhe trajtat e tjera të saj, si **kah** e **kaha** përdoren si ndajfolje e si lidhëse; a) si ndajfolje ndër fjali pyetëse të drejta e të zhdrejta, p.sh. e **kaha e ke** ti ata një të gjallët (Buz. Gjoni IV 12); e di **kaha erdhshë** (Buz. Gjoni VIII. 14 = e di nga erdha (Kristof. ibid); mrimanga **kaha zû** me tjerë kaqa hollë (Bogd. Shk. I. Ligj. I. 2); i dëftoi fshatin se **ngaha ish**; na humbi karroca nga rëpara sivet dhe më s'e pamë **ngaha na bëri** (Ped. 85, 87); u mendua **kaha të vejë** (M. M. 60), e pyet ky këtë **ngaha vjen** (M. P. 274); **kah erdh këjo** e zezë? (Mjed. II. 22); që **nga vini** kështu? (Tokat, 7); b) si lidhëzë ndër fjali vendore e kohore, p.sh. posi kuur kruo i gjallë **kaha dalënë** gjithë të miratë e kësaj jete. (Budi. Pasq. 139); ashtë kruet **kahë bunon** e **rrjedh** të gjallëtë (Bog. Shk. I. Ligj. IV. 38); u-ngrit nga ay vend **ngaha kish shkuar** armiku (Kas. 132); **kah** të shkojë i zoti qeni i vehet mbrapa (Mjed. II. 65); e gjen **kah shtron** sofrën (Kurti I. 62).

6. Si e pamë të gjithë shembëllat e sipërme nëpër funksionet e ndryshme të saj, parafjala **nga** ndërtohet rregullisht me emërore të çquar. Në disa vise e gjejmë të ndërtuar me kallëzore të përemrit; ç'do ti **nga mua**? Rrallë herë e gjejmë të ndërtuar me rrjedhore të përemrit, p.sh. kur të kthehesh, shko **nga meje** të t'ap ujë për të sëmurmë (Doz. 27). Por tek Argjirokastriti kjo parafjalë gjindet shpesh e ndërtuar me rrjedhore të përemrit, sikundër dhe parafjala **te**, që pamë më lart (f. 38); i u lutnë Zotit të hiqet **nga meje** (Korint. B. VII. 8); ai që pat qenë **nga meje** helmuarë (Korint. B. II. 2) ndonjë **nga nesa** s'rron për vetëhe (Kom. XIV. 7); nuk pagëzova ndonjë **nga jush** (Korint. A. I. 14); unë nukë kam kri (= nevojë) **nga teje** (Korint. A. XII. 21).

1) G. Weigand, Alban. Gram. 85 Anm., — K. Cipo, Gram. 182,

7. Nga shembëllat e sipërme nëpër funksionet e ndryshme të parafjalës nga del se kjo parafjalë është baras nga kuptimi: a) me parafjalët në a të, p.sh. hunda e tij e trashë **nga maja** (Ballz. 21) = e trashë **në majë**; b) me parafjalën nëpër, p.sh. nuk më shkoi kjo nga mendja = nuk më shkoi kjo **nëpër mend**; c) me parafjalën prej (si do të shohim më poshtë), p.sh. i porositi që të mos ndahemi **nga** Jerusalemi (Argjir. Të bëratë I. 4) = i porositi mos me ndamë **prej Jerusalemit** (Kristof. ibid.); më doli **nga mendja** (g. e. t.) = më duel **prej mendjes** (g).

## 9. prej, pej, pi

A. **Funksioni.** Nga këto trajta të kësaj parafjale, e para ka marrë një përdorim të përgjithshëm, se është përdorur si prej shkrimtarëve të lashtë të Veriut e të Jugut, ashtu edhe prej të Rilindjes e të të sotmëve, nëpër vepra e në shtyp. Trajta **pej** është përdorur më pak se trajta e parë, prej Naimit, Mitkos e ndonjë tjetri. Trajta **pi** përdoret në gjuhë popullore të Dibrës.

B. **Funksioni e ndërtimi.** Kjo parafjalë ndërtohet me rrjedhore dhe kallëzon:

I. **Pikënisjen** prej një vendi a gjësendi në lidhje me një të vepruar të genë a të ndodhur, p.sh. një gur u rrëzue **prej një mali** (Bogd. shk. III. Ligj. IX. 4); këqyrte qiellin **prej ballkonit** (Mjed. II. 15); **prej goje e prej hunde** hyn ajri ndër shikza (Mjed. III. 96); sdrypi zgjermi **prej qiellit** (Babi, Vak. 114); ra **prej degët** në degë (Kurti I. 54).

II. **Drejtmin** për një vend, për një njeri a për një gjësend me qëllim të caktuar, p.sh. ata sytë e tu të përmishëriershëm **prej nesh** kthe; përvenë **prej meje** veshëtë e tu (Buz. XVI/n; Ps. 101, 3 = XVII); e u kthye **prej gruojet** (Buz. Luka VII. 44); ngre duortë e mendnë e zemërenë **prej qiellshit** (Budi, Pasq. 150); tue çuem sytë **prej qiellshit** (Bogd. Shk. I. Ligj. I. 16); usuell me ftyyr **prej murit** (Babi, Vak. 115); nana u suell **prej Cukut** e i tha (Mjed. III. 11); zu fiil udhën **prej Jerusalemit** (Bogd. Pj. II. Shk. I. Ligj. I. 10); un do të marr rrugën **prej Jutbinë** (= për Jutbinë); **prej Anadollit** (= për Anadoll) rrugën e ka marrë (Raps. Mujës Nr. 20 147, 119).

**Verejtje.** Si shihet, ky funksion i ndërtimit të parafjalës **prej** gjindet në të folmen e në shkrimet e Veriut, kurse në të Jugut e në të së Mesmes faqet ky me parafjalën **nga**, **për**, por edhe me ndonjë parafjalë tjetër, p.sh. e aj tue ecurë e tue u afëruom **prej Damaskut** (Buz. Punët, IX. 3) = kur u afërua ai **ndë Damasko** (Argjir. ibid.), kur uavit ai **ndë Damaskë** (Kristof. ibid.); e ktheu faqenë e ti **prej murit** (Buz. Isaia XXXVIII, 2) = nga muri; askurraaj maa **prej ncosh** (= te këto a nga këto) me mos nkthym; të mpshtetet me gjithë zemërë **prej nci** (Budi, Pasq. 8, 157) = tek ai a nga ai. Në gjuhë arbreshe për këtë funksion drejtimi parafjala **prej** ndërtohet me kallëzore të çuar, p.sh. **prej detin e kalthër** (= kundrejt detit të kalthër) ish zonja e madhe (Milosao, XII 7); shkuan me lusii prej zoon (DR. II. 74) = **passarono orando al Signore**; ushtra e Arbreshëvet dual nka diert tuke ecur **prej livadhin** (= drejt livadhit) Turqëvet; Arbreshët shtieull pëlhurët (e anijavet) u ndreqën **prej Salernin** (Kënk. e spr. 66, 70) = drejt Salernit. Mbase në këte konstrukt të gjuhës arbreshe kemi një influencë t'italishtes.

III. **Prejardhjen**, d.m.th. të ardhurit, të dalët, të kthyerit, të ngriturit.

1) Prej një vendi a një gjëje, prej një të ndodhuri a të qeni, p.sh. le të lenjë **prej dheut** gjithë shpirt i gjallë; shiu ashtë ujë qi derdhunë bje **prej renshtit** pikë pikë (Bogd. Shk. I. Ligj. V. 14, 25); këta erdhë **prej mezit** t'Azisë n'Evropë (Sami Shqip. 3); ajo kishte një shërbëtores marrë rob prej Iudesë (Kristof. Hist. 100); por edhe këta varet **prej fatit** (Vr. 61); këta liqej vinë **prej malesh**; **prej drunit** të pishës del një lang që i thonë **rrëshinë** a **shindër** (Mjed. III. 75, 125); **prej pyjevet** tona nxiret një sasi e madhe lende për dërrasa; ai **prej natyre** e ka ate zâ të bukur.

2. Prej një personi, p.sh. asndonjë të mirë **prej meje** të mos e kini (Budi. Pasq. 80); janë bënë të pasurë **prej sij** (Argjir. Korint. A. I. 5); kërkoi ndjesë **prej ndonjërit** (Vr. 161); këte të mirë dua **prej teje** (M. M. 66); ka pamë shumë ndere **prej atij**.

**Verejtje**. Këtu hyn edhe kuptimi i origjinës, d.m.th. i burimit a i gurrës, ngaha del dikush a dishka, p.sh. nieri leem **prej grueje** (Bogd. Shk. I. Ligj. VI. 6); kur janë **prej një ate e një ame** (Vr. 100); Llatinët janë **prej farës** së Pellazgëvet (Sami, Shqip. 4); ishte prej dere të madhe (Lufta, 18).

IV. **Largimin**, d.m.th të ruajturit a të shpëtuarit, të ndarët a të ikurit a të hequrit prej gjëkafshë a prej ndonjë personi, p.sh. prashtu Enea i silli iku **prej Trojet** e vote ndë Italet (Bogd. Shk. I. Ligj. I. 19); **dau prej meje**; nuk pat hequnë dorë **prej këso nunësh** këcia; por mbandaj duel **prej fjalës** (Krist. Hist. 12, 43, 109); largouni **prej syresh** (Argjir. Rom. XII. 17); e dëbuan Themistoklinë **prej mëmëdheut** (N. K. I. 43); i thotë m'u ruejtë **prej shokëvet** të këqij (Mjed. I. 36); gjelat na zgjojnë në mëngjes **prej gjumit**. Këtu hyn edhe kuptimi i largësisë, p.sh. Tirana mba **prej Shkodre** 120 kilometra.

V. **Shkakun** e ndonjë veprimi, të ndonjë gjëndje a ngjarje, p.sh. ishinë lodhunë **prej udhësë** largë (Kristof. Hist. 85); munt të pësojë **prej juzhine** a **prej shumë punërash** të tjera (Vr. 53); të kavitur **prej lodhjes** (Kas. 139); vozgat **prej vene** venë një lmask (Bjed. III. 128); ishte tuj u dridhë **prej së ftoftit** (Mjed. II. 13); ishte bâ helm **prej idhnimit** (Kurti, I. 69).

VI. **Personin a frymorin veprues** ose sendin konkret a abstrakt të përfytyruar si veprues me anë të një folje refleksive a intransitive a perifrastike, p.sh. sicili-do qeverisesh **prej këshillës** së parësisë (Sami. Shqip. 7); ishin burra të mësuarë në luftë dhe të krejtuarë **pej një burri** që s'kish shok ndë jetë (N., K. I. 48); shpendët e buta ushqehen **prej njerëzish** (Kristof. Abet. 19); uqënjyenë **prej një gjarpëni** (Kristof. Hist. 5); fjalët e tij u-kuptuan keq **prej shokëvet**; kishte frikë **prej babës** se mos e qortonte; të mbarojmë punët me kujdes pa uhequrë **prej përtimi** a **nxitimi** (Vr. 38); trupi i zoqvet ashtë mbuluem me pupla mos me u lagunë **prej shiut** (Kristof. Abet. 18); ka plasë toka **prej të nxehtit**.

VII. **Pjesën e një grumbulli a një të tëre**, p.sh. qish thonë disa **prej jush** (Argjir. Korint. A. XV 12); i pafajmi **prej jush** të hedhë gur mbi të (N. K. II. 19); njani **prej vëllazënish** tuej (Kristof. Hist. 31); **prej dreket** ruejte një grimë û për darkë (Mjed. III 18); e mira është të flasë njeri **prej nesh** (Atan. 29); asnjë **prej nxënësve**t nuk mori nota të dobëta; i dha një lugë **prej gjellës** që po hante.

VIII. **Anën a pjesën e një gjëje a të një vendi**, p.sh. e mori **prej dore** (Doz. 56); e zuri **prej krahu**; hyri prej **plasës** dërrasës; e kapi **prej flokësh**; i ra unaza **prej gishtit**.

IX. **Sasinë e një gjëje a të maturit e një gjëje a të një vendi**, p.sh. nga gjithë sipërfaqja **prej gjashtë hektarësh** dy hektarë përdoren për eksperimente; pjesa e kanalit që i takonte atij fshati ishte **prej shtatë kilometrash**, u-krijua një kope derrash **prej pesëdhjetë krerësh**.

X. **Krahasimin** në mes dy elementesh së fjalisë, p.sh. të shohim cila **prej nesh** është më e bukura (M. P. 269); **prej gjithë nxënësve** Bardhuli ishte i pari në klasë; **prej gjithë pemëvet** rrushi është më i dobishmi. Këtu hyn edhe shprehja e Shqipërisë së mesme, sidomos e Elbasanit: unë të jem **prej teje** (nuk e báj kështu); unë t'ishje **prej teje** (do t'i përgjigjesha ndryshe); etj. **baras me**: unë të jem në vend tand, unë t'ishje në vend tand, ose si ti.

XI. **Prej sa kohësh** ka ndodhur një veprim a një ngjarje, p.sh. shtabi e kish harruar fare **prej shumë ditësh** atë brigadë (Doni I. 72); **prej disa kohësh** vendin e parë e zinte ai (Stuhi, 29); s'kishte qenë n'atë qytet **prej tetë vjetësh**; kjo metodë është vjetëruar **prej kohe**; **prej disa ditësh** ka filluar edhe prashitja e dytë e misrit.

XII. **Lëndën**, prej së cilës gjindet a ndërtohet gjëkafshë, p.sh. dheu jashtë ka gujatë **prej dheu** (N. K. II. 22); të më bënë një palë këpucë **pe lekuri** (Doz. 81); pantallone të vjetra **prej pëlhure** (Kas. 46); kanistrat gërshetohen **prej arqitash a zhugash**.

XIII. **Karakteristikën a cilësinë a vetijën** e një personi a të një gjëje, p.sh. pamj' e tij **prej burri të kuturitur** u kallte frikën të gjithëve; vinte në veprim gjithë hret e saj të dikurshme **prej gruaje**; burrë i shëndoshë me shpatulla **prej vigani**; veshi i tij i hollë **prej fusharaku** (Kas. 20, 37, 49, 129); nënë jakën e këmishës dukej qafa e pjekur **prej të riu**; u-përgjegj me zë këmbonjës **prej tenori** (Doni I. 93, 131); me vërat e hundës **prej shpeshi rrëmbenjës** (Tokat, 18); më thirri me një zë të mekur **prej këndezi** (Ugul. 18); kjo qenka rrugë **pej dhie**.

**Verejtje.** 1. Këto farë sintagmash me parafjalën **prej** në këta paragraf të fundit i gjejmë vetëm në të folët e në shkrimet e Jugut, kurse në të folmen e në shkrimet e të së mesmes e të veriut në këso rasash përdoret rrjedhorja e thjeshtë p.sh. pashë një fole **prej zogu** (N. K. I. 51) = një fole **zogu**; kish një pamje **prej luani** (Kas. 50) = pamje luani; me një forcë **prej mashkulli** (Tokat 57) = forcë mashkulli; ulërimë **prej ujku** = ulërimë ujku.

2. Përveç atyre dy rasave, të funksionit të drejtimit e të karakteristikës, ku ndryshon përdorimi i parafjalës **nga e prej**, në toskërishtet e në gegërishtet, në çdo rasë tjetër parafjala **prej**, me gjithë sipërin' e saj në gegërishtet, përdoret edhe në toskërishtet **baras nga** kuptimi me parafjalën **nga**; p.sh. këta erdhë **prej mezit t'Azisë n'Evropë**; e të tjerë kombe t'ardhurë **nga Azia** (Sami, Shqip. 3, 4); gjuha jonë i ngjan shumë llatinishtes e gjuhëvevet që janë **ndarë prej asaj**; me këte mëndyrë **unda gjymës'** e Illyrisë **nga Shqipëria** (Sami, Shqip. 5, 9); kanë ardhurë **nga vende të huaj** e janë të mbledhurë **prej t'aratisuret** (N. Mës. 30); ca vijnënë **nga prapësi** e punëvet e **nga rrebesht'** i fatit, ca **prej plagësh** e **prej sëmundjesh** (Vr. 47).

Nga gjithë shembëllat e mësipërme del se parafjalët **nga e prej** përdoren, më të shumën, në objekte e situata identike e prandaj mund të mirren për sinonime.

## 10. ëndër, ndër, nnër, nër

A. **Përdorimi.** Nga këto trajta të kësaj parafjale e para është përdorur prej Buzukut dhe e dyta prej shkrimtarëve të moçëm të Veriut e të Jugut dhe të Rilindjes gjer prej të mëpastajmëvevet. Sot kjo trajtë ka marrë një përdorim të përgjithshëm në gjuhë të të shkruarit. Trajtat **nnër** e **nër** janë përdorur vetëm në disa shkrime të Veriut në kohë të ndryshme. Karakteristikë e kësaj parafjale është se ndërtohet gjithmonë me emra të numrit shumës në rasë kallëzore duke u marrë, sipas një konceptioni popullor, si shumës i parafjalës **në** a **ndë**.

B. **Funkcioni e ndërtimi.** Kjo parafjalë tregon:

I. **Të qenët, të qëndruarit a të ndodhurit e një gjëje a të një personi në mes të tjerësh a së tjerash, që mirren si shumicë.** Ndërtohet, më të shumën, me kallëzore të paçquar, p.sh. kle edhe ajo **ëndër të njohunitë** të parsë bekuomë (Buz. XXVI/b); Zotynë rri **ndër ta** (Bogd. Shk. I. Ligj. IV. 9); ç'ka **ndë** dhe edhe **ndër** **qiej** gjithë janë n'urdhërit të ti (N. Mës. 42); shih një cudi të madhe **ndër këto lule** (N., K. II. 25); ruantin me pushka **ndër duar** (N., K. II. 32) tue u djergunë **ndër ethe** (Kristof. Mate VIII. 15).

II. **Të lëvizurit a të vepruarit e një personi a të një gjëje në mes së tjerash a të tjerësh, që mirren si shumicë.** Ndërtohet, më të shumën, me kallëzore të paçquar, p.sh. ai mpshefi ata **ndër shpella** (Kristof. Hist. 96); kali duke marrë frenë **ndër dhëmbë** u kthye së prapi me vrap (N. K. II. 31); u shprishën **ndër të huajit** (Kënk. e Spr. 24); djalëthin tim unë edhe **ndër pesëqind** veta do ta njoh (M. P. 282); shtrini dorën **ndër hita** (Mjeda, II. 31); shumicën e pat shitur **ndër familje** të dorës së parë (Atan. 8); **ndër të tjera** u-vendos që të bëhet edhe një mbledhje tjetër.

III. **Idenë e sipërisë** në krahasim me të tjerë e me të tjera. Ndërtohet, më të shumën, me kallëzore të paçquar, p.sh. me kjanë i pari **ndër vëllazënë** (Bogd. Shk. I. Ligj. VII. 18); Goleni një mjek **ndër mâ** të mëdhaj (Mjed. II.18); ishte **ndër më** të mirat (Lufta, 18); ishte më i urti **ndër të gjithë**.

IV. **Idenë e njërijatrës** (të reciprocitetit) ose të pjesës ku vepron një veprim i kësaj natyre. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. vunë ore **ndër sy** njani-tjetrinë (Kristof. Hist. 33); udeshtin **ndër ta** (De Rada Antol. 9); **panë sy ndër sy** njëri-jatrin; dy motrat kishim nirë me u dashtë **ndër vedi** (Kurti I. 64).

**Verejtje.** 1. Paralelizmin që pamë te parafjala **te** me parafjalën **mbë** a **më** e gjejmë edhe në parafjalën **ndër** me parafjalë të tjera: a) me parafjalën **te**, p.sh. që të vinj me gëzim **ndër ju** (Argjir. Rom. XV. 32) = që të vij me gëzim **te ju** (Kristof. ibid.); u mbodhiçë shumë herë të vinj **ndër ju** (Argjir. Rom. XV. 22) = undala shumë herë me ardhunë **te ju** (Kristof. ibid.); kur arçë **ndër juvet** (Argjir. Korint. A. II. 1) = kur erdha **te ju** (Kristof. ibid.); — b) me parafjalët **mbë** a **ndë**, p.sh. ka me klenë dhanë **ëndër duor** të pëganëvevet (Buz. Luka XVIII. 32) = do të ipetë **ndër duar** të së pabesëvevet (Argjir. Ibid.); **ndë** ndëjtë shpirti i Perëndisë **ndër ju** (Kristof. Rom. VIII. 9) = sepse rri shpirti i Perëndisë **mbë ju** (Argjir, ibid.); mbanë të kotë **ndër mendimet e veta** (Kristof. Rom. I. 21) = u marruanë **ndë mënt** të ture (Argjir. ibid.); sepse e pashë me udhë mos me ditunë asgjë **ndër ju** (Kristof. Korint. A. II. 2) sepse nuk silloisa të di gjë tjetër **ndë juvet** (Argjir. ibid.); — c) me parafjalën **me**, p.sh. u. mendua pakëzë e tha **ndër vetëhe** (M. P. 291); tue kuvendua

**ndër vedi** (Kurti I. 17) = duke kuvënduar në vetëhe. Prej gjithë këtyre shembëllave del se parafjala **ndër** bëhet sinonime me ato parafjalë të tjera duke u-larguar nga kuptimi i parë i saj: «**në mes**» të ndonjë gjëje. Ky fenomen i këtij largimi duket më qartë në të folmen e gegërishtes veriore, ku parafjala **ndër** përdoret më dëndur dhe në të folmet e tjera mund zëvendësohet me parafjalë të tjera, paralele me këte nga kuptimi: p.sh. kur përtrihet mëngjezi **ndër rrugët** e qytetit (Migjeni) = **në rrugët** ose **nëpër rrugët** e qytetit; ja shpërblen me të mira **ndër ditët** e mbrame të jetës = **në ditët** e mbrame të jetës; k'jherë nana e merr me vedi **ndër miq** (Mjeda, I. 86) = **në a nëpër miq**; e ndiente vendin të lidhun për të **ndër të gjitha detyrët** shejte = **në të gjitha detyrët** shejte; Pierini kish-te shkue **ndër vorre** = kishte shkue **në vorret** a **te vorret**.

2. Përveç funksionit adnominal sintaktik, parafjala **ndër** është përdorur në gjuhë edhe me funksion adnominal e adverbial morfologjik, duke u formuar me të, në gjuhë popullore, shumë fjalë: a) emra apelativë e topikë, si **ndërgishte**, **ndërdym**, **Ndërfandëna**, **Ndërfusha**, **Ndërkusha** etj.; b) folje, si **ndërkambunë** (Bogd. Shk. III. Ligj. VI. 7). **ndërkrehem**, **ndërliqem**, **ndërmendem**, **ndërmbllys**, etj. Edhe në gjuhë të shkrimtë janë formuar me këte parafjalë, sipas gjedhes së gjuhëvevet të huaja, një varg fjalësh; emra e mbiemra, si **ndërgjegjë**, **ndërkohë**, **ndërlidhje**, **ndërkombëtar**, i **ndërgjegjshëm**, etj.; folje, si **ndërhyj**, **ndërmarr**, **ndërpres**, **ndërmjetësoj**, etj. bashkë me derivatet e tyre.

## 12. ndjerie, ndjerë, deri, ngjera, ngjer, gjerë, njera, njer.

A. **Përdorimi**. Nga këto trajta, të parën e përdor Buzuku, të dytën Budi e Bogdani. Argjirokastriti përdor trajtën **ngjera**, Kristoforidhi trajtat **deri** e **ngjer**. Samiu, Naimi e Mitkua përdorin trajtat **gjerë** e **gjer**. Pedersenin përdor trajtën **njera** dhe Dozoni **njer**. N'arbrishtet përdoren trajtat **njera**, **njer**. Në gjuhë të sotme të shkrimtë zotëron përdorimi i të dyja trajtavet **deri** e **gjer**. Me kohë do të duket se cila nga këto dy trajta do të ketë sipërinë.

B. **Funkcioni e ndërtimi**. Kjo parafjalë kallëzon kufirin e cakun e **vendit** a të **kohës**, teku merr fund lëvizja a veprimi dhe ku arrihet dishka. Ndërtohet me emra e me ndajfolje. Kur ndërtohet me emra bashkohet me parafjalë të tjera: **ndë** a **në**, **mbë** a **më**, **mbi** a **përmbi**, **për** etj.; kur ndërtohet me ndajfolje, bashkohet ose jo me ndonjë nga ato parafjalë. Këso-dore formohet një parafjalë e përngjitur ose një shprehje parafjalore.

I. **Caku i vendit**. Ndërtohet me parafjalë të ndryshme, p.sh. të këqiatë e mii shkuonë **ndjerie përëmbii** kryet tim (Buz. Ps. 37, 5); e i mbushne **djerie për** majesh (Buz. Gjoni II. 7); me thanë (mkatet) **ndjerë ndë** kandt; me e paguom damtë **ndjerë** nd'anët (Budi, Pasq. I, 102); së sillash (ujëna) gjithë dheu ishte mbuluem **ndjerë mbë** qiell (Bogd. Shk. I. Ligj. IV. 23); e i mbushnë qupetë **ngjera mbë grykë** (Argjir. Gjoni II. 7); s'kam me marrë prej gjasë sate çë prej fijesë **deri mbë** trup të shollësë; kam me ta folunë **ngjer ndë** gjymësë të mbretnisë (Kristof. Hist. 13, 126); e shpunë me karrocë **njera në** akëç fshat (Ped. 87); kish dhuratë të fluturonjë **gjer ndë** qiell; vuri veshnë sa të gjegjet poshtë **gjerë ndënë dhe** (M. P. 298, 299); râr (kezi i saj) **njera te këmbat** (Kënk. e spr. 31); nevoja më shpuri **gjer te** lipësija; bari ish **gjer më** gjunjë (N., K. I. 15 dhe K. II. 14);

hyri brënda në kanal **gjer më** gjunjë (Kas. 53); me mujtë me u shty **deri te** ai hyll (Mjeda II. 5); këmbët e kuajve të lagura **gjer në noçkët** (Doni II. 71); livadh i bukur me bar **deri në** gju (Kurti I. 64) — **njer këtu** ishte prallëza (Doz. 75); **ndjerë afërë** zjarmit (Bogd. Shk. I. Ligj. V. 22); **deri aty**, më tej mos shko; **gjer atje** e hodhi topin.

II. **Caku i kohës**. Ndërtohet me regjim që tregon kohë, ose me ndajfolje të bashkuar ose jo me ndonjë parafjalë, p.sh. **ndjerie për** jetë të jetësë (Buz. Ps. 124, 3); **ndjerie ënbë e sosunit** të dheut (Buz. Punët I. 9); **ndjerë ndë** kohët të martesës (Bogd. Pj. II. Ligj. II. 5); **ndjerë mbë ditë** të gjyqit (Bogd. Shk. I. Ligj. VII. 14); u mbodhiçë **ngjera të sormenë; ngjera mbë** kohë të nomit (Argjir. Rom/I. 19, V. 13); **deri mbë kohë** të mbrapëme; **ngjer mbë këte ditë** (Kristof. Hist. 26, 133); u-glendisnë **njera në njëmbëdhjetë sahati** (Ped. 86); nukë dot ipem **gjer mbë vdekëje** (M. M. 65); **njera te dita** e sonëme (Kënk. e spr. 74); oficerët bisedonin **gjer në agim** (Doni II. 92); **gjer para disa ditë** ishte mbjellur një sipërfaqe e gjerë me grurë; **ndjerie mbramanet** (Buz. Ps. 129, 6); punët e bëra janë ndë të dhëmburë **ngjera mbë sot** (Argjir. Rom. VIII. 22) = ka të dhimtnë **deri tashti** (Kristof. ibid.); ashtë këthyem ndë 205 gjuhë të hueja **ngjer mbë sot** (Kristof. Hist. 136); në qoftë se rronj **gjer atëherë** (Doz. 66); s'na kanë rënë më qafë **gjer më tani** (Tokat 25); **deri prej mramjet** (Babi, Vak. 114).

**Verejtje**. 1. Si e pamë, kjo parafjalë, kur ndërtohet me emra, bashkohet me parafjalë të ndryshme; por ka rasa kur, edhe me emra e ndërtuar, nuk bashkohet me ndonjë parafjalë, e cila atëhere nënkuptohet, p.sh. **ndjerë barkut** s'amës (Bogd. Pj. II. Ligj. II. 14) = ndjerë në barkut s'amës Hyji i pushtueshim **ndjerë së zani** (= deri në të zanë fill, deri në fillim) krijoj qiellnë e dhenë (Bogd. Shk. I. Ligj. IV. 4); gjer ditët e fundit (= gjer në ditët e fundit) nuk ish mbaruar puna.

2. Për t'u-treguar një emfazë, kjo parafjalë ndërtohet me rasë emërore të një emri a mbiemri pa u-bashkuar me parafjalë tjetër, p.sh. **ndjerë mushkaja** kallëzon se ashtë Hyji; **ndjerë barënat** e kopështinjet e adhurojnë për Hyj (Bogd. Shk. I. Ligj. I. 14); **gjer të vegjëlit** e kanë kuptuar këte të vërtetë. Pa emfazë, kur nuk bashkohet me parafjalë tjetër, ndërtohet me kallëzore, p.sh. **gjer të mërkurrën**.

3. Kur i prin kësaj parafjale ndajfolja **aty-e** tregohet një veprim i zgjatur që më parë, p.sh. tue të ruojtunë **aty e ndjerë** mbi horët të mortësë tij; qysh se uzu shekulli **aty e ndjerë** mb'atë ditë (Budi, Pasq. 55, 127).

4. E bashkuar me numra kjo parafjalë tregon sasinë maksimale të një gjëje a të një veprimi, p.sh. e shiste **gjer pesëdhjetë** lekë killon e arravet; këcente **gjer më një metër** lart.

5. Kjo parafjalë duke u-bashkuar ose jo me fjalëzat sa, që përdoret edhe si lidhëzë, për t'u-formuar me të fjali kohore zgjatëse, p.sh. **djerie u të ve** anëmiqtë e tu ënbë vend (Buz; Ps. 112, 3); **djerë gjen** kohonë (Budi, Pasq. 263); edhe nuk ukëthyeshë **der sa s'mbetnë** më (Kristof. Ps. XVIII 37); **gjer të ndejmë** mirë se e muarmë vetëhenë (Vr. 69); **njera sa erdha** këtu (Ped. 33); u priste kryet **njer sa i prishi** të tërë. (Doz. 80); ka **gjer sa plaketë** (N. Mës. 18); **njeer sa ajo hiri** ndër shpiit; **njeer çë shkuan** nëent vjet (De Rada, Antol. 7, 50).

6. Përveç trajtavet të sipërmendura të kësaj parafjale kemi edhe trajtat dialektore **njaram e njam**, që fliten në çamërishtet: **njaram aty, njaram në shtëpi, njam këtu, njam në kopësht**. Në të dyja këto trajta

kemi një shformim e një aglutinacion: **njaram** = njara + m(ë), **njam** = nja(ra) + m(ë).

7. Parafjala **deri** është korelativi i parafjalës **nga** a **prej** në kohë e në hapësirë për të treguar mbarimin: prej malit deri në breg detit;

### andy, andyç

12. Këto dy parafjalë, sinonime të parafjalës **deri**, **gjer**, përdoren në Shqipëri të mesme pa u-bashkuar me parafjalë të tjera, p.sh. **andy djalli** u qet kapistërë mçafë (Budi, Pasq. 8) **andyç bari** s'bin (Kristof. Fjalor 6); **andy tutje** = këtej e tutje; **andy** < a(n)ty, **andyç** < a(n)ty+çë.

### 13. mje, mjen, mjet, mjeç.

Edhe këto variante parafjalësh janë sinonime të parafjalës **deri**, **gjer**, të përdorura në Shqipëri të Veriut dhe të formuara, ato dy të parafundit, nga të puqurit e dy fjalëve: **mjen** = mje + në, **mjet** = mje + të; p.sh. **mje m'** Sulah e ka mustakun (Lahuta e Malcis, 34); **mje që** të dalë drita; **mje ditën** e Shën Gjergjit; **mje në** mbramin dysh; **mje në perëndim** të diellit (Kan, 32, 53, 56); **mjen** më tretët ditë; **mjen** këte ditë, udanë më dy prej së nalti **mjen** poshtë (Anonimi, 83, 101, 114). Trajta e fundi **mjeç**, nga **mje+çë** (= deri në) ka qenë përdorur lashtazi në Shqipëri të mesme, sidomos në Elbasan: **mjeç ke** sa të bii elbi; **mjeç ke** të shtërofi (Shih. Buletin Univers. Shk. Shoq. 1959, Nr. 1, 182).

### 14. pas, mbas, mas

A. **Përdorimi**. Nga këto tri trajta, e para është përdorur prej shkrimtarëve të Jugut, të vjetër e të rinj, e dyta prej të Veriut, gjithashtu po prej këtyre edhe trajta e asimiluar **mas**, ndonëse me një përhapje më të vogël. Në gjuhë të sotme e të shkrimit sipërinë e ka marrë trajta **pas**.

B. **Funkcioni e ndërtimi**. Kjo parafjalë tregon: I. Të qenët, të lëvizurit a të vepruarit:

1. **Prapa një vendi**, një gjëje a një personi. Ndërtohet me vendore, p.sh. e shkreta a strukë **mbas një turre drush** (Mjeda, II. 9); mshehet Marashi **mbas një çube** (Kurti I. 57); nga frika e t'et u psheh **pas s'ëmës**: qante ajo duke u pështetur **pas derës** (Doni, I. 27).

2. **Në një vend, pranë a afër një gjëje a një personi**, ose **mbi** të. Ndërtohet me vendore a me rrjedhore, p.sh. kur sheh plakënë e mjerë që dridhetë e qas **pas zjarrit** (N. Mës. 16); vuri veshnë **pas faqes** dheut (M. P. 299); i kishin rënë margaritara **pas faqesh** (M. M. 57); Jozefi uzu **pas kovësë** dhe e nxuarrë (Sami, Abet. 70); i lëshoj ujë të ftohtë **mbas kreje** (Mjeda. III. 130); u përpoq **pas ombrellës** së Romeshit (Stuhi, 116); u kaça **pas balleve** të shtratit; rrahu këmbën **pas truallit** (Nov., 26, 69); u mbështet **pas murit** (Ujët, 13); duke përpjekur gjuhën **pas qiellzës** (Tokat, 75); rrahu majën e cigares **pas kutisë** (Doni, II. 79); po rrinte shtrivë me këmbë **mbas zjarrit**.

II. **Mënyrën e një të qeni a të vepruari me anë të një mjeti a vegle ose pa të**. Ndërtohet me rrjedhore, p.sh. duke tërhequr kafshët **pas kapistallit**; mori pelën **pas kapistallit** e shkoi (Atan. 30, 100); hiqej zvarrë me këmishë të lagur ngjitur **pas trupit** (Doni II. 99); dhe me duar të

lidhura **pas zverkut** vajza po flinte (Stuhi, 19); ajo rrobe i rrinte prerë **pas trupit** (Bruski, 15); e mësova gjuhën **pas kësaj** metode.

**Verejtje.** Si duket nga këto shembëlla të numrit 2 e të paragrafit II parafjala **pas e mbas** bën funksionin e ndonjë parafjale tjetër e mund zëvendësohet me ndonjë syresh, p.sh. duke përpjekur gjuhën **pas qiellzës** = në qiellzët; rrahu majën e cigares **pas kutisë** = mbi kutinë; e lidhi kalin **mbas nji ullini** = në nji ulli a te nji ulli; etj. Duket se ky farë përdorimi i kësaj parafjale, në vend të një parafjale tjetër, e tregon më gjallë shllimin hapësinor.

III. **Personin e gjësendin, pas të cilit shkon** a rregullohet një person e një gjësend tjetër. Ndërtohet me tëjore parafjalore a me rrjedhore, p.sh. djali u ra **pas këtyre** dhe u kalli një vapë, sa mënt i diqte; shko ti përpara, pa edh' unë po vij **pas teje** (M. P. 300, 304); koha s'vjen **pas teje**, ti hiq **pas kohësë** (N. Mës. 30); dy femi të vegjël ngitshin **mbas fluturave** bregut të visë (Mjed. I. 79); retë vraponin njëra **pas tjetrës** (Buka, 25); qeni ecën **pas të zotit**; duke ecur **pas gjurmës** e diktoi gjakun.

IV. **Të vazhduarit e një veprimi.** Ndërtohet me rrjedhore, p.sh. ai është i bekuarë jetë **pas jetet** (Argjir. Rom. I. 25); herë **pas here** e kthen-te kokën atej (Bereq. 19); **pas çdo fjale** që më kujtohej harroja fjalën tjetër; lirinë e fituar me gjak në luftë kundër fashizmit shqiptarët do ta mprojnë e do ta gëzojnë **brez pas brezi**.

V. **Të qenët a të vepruarit sipas një situate a sipas të vepruarit a mendimit të ndonjërit.** Ndërtohet me rrjedhore, p.sh. ka me ja paguem **mbas veprave** ati (Kristof. Rom. VI. 7); Pellazgëtë, **pas vendeve** që rrininë, ndaheshinë në shumë fara e fise (Sami, Shqip. 5); duke punuarë **pas fjalëve** të vlera e t'urta (N., K. I. 47); kjo kohëzë, cave **pas punësë** që kanë, u është e shumë (Vr. 47); **pas urdhërit** mbretit e suallnë përpara ati (M. M. 64); kjo **pas fjalës** mbretit e vuri në një kuti; erdhi zogua **pas zakonit** që kish (Doz. 28, 42); ai rron **mbas këshillave** të mjekut: **mbas mendjes** sime ai s'kishte të drejtë.

VI. **Tendencë, dëshirë, të dhënë pas një gjëje, të kujdesur për një gjë a për një person.** Ndërtohet me rrjedhore, p.sh. ushti kaqë **pas asaj**, sa taksi të vejë e ta marrë (M. P. 283); aty e mbrapa ulqinakët u dhanë **mbas tregtie** në det; Shiroka, katund i dhanun **mbas lundrimit e peshkut** (Mjed. III. 73. 74); e shkruini gjithë pasjen **mbas bamirësive**; nëna tërë ditën e shkonte **pas djalit**, se ishte sëmure.

VII. **Kohën e afërme a të larkme pas një të vepruari a një ngjarje të ndodhur.** Ndërtohet me kallëzore të paçquar a me rrjedhore, p.sh. kur të kthehem unë **pas motmot**; **pas dy a tri vjet** ubë ajo me barrë (Doz. 36, 37); **mbas mundit** pushimi është i ambël (Mjed. II. 10); **pas disa minutash** tre kozakë e ndiqnin prapa (Doni II. 99); **pas një heshtje** foli (Ujët, 12); **pas dy ditësh** u bë dasma jonë (Stuhi, 2 21); **pas të tretët ditë** (Anonimi, 83).

**Verejtje.** 1. Sikundër u-pa te shembëllat e sipërme, kjo parafjalë ndërtohet, më të shumën, me rrjedhore; por rrallë herë edhe me kallëzore të paçquar, p.sh. ai erdhi **pas mua**; do të kthehem **pas motmot**, etj. Me kallëzore të çquar ndërtohet kjo në arbërisht sipas italishtes, p.sh. **pas atë**; **pas vëdekjen** e Skanderbegut (Kënk. e spr. 26, 60); **pas ditën** keq të djegun (DR. II 72).

2. Kjo parafjalë përdoret edhe si ndajfolje p.sh. mbreti kish dalë me shumë njerës **pas**, për të bariturë (M. M. 57); mjeku i ra **pas e po e**

ndiqte me vrap (M. P. 286); bëri tutje ipja dhe djali i vij pas (Ped. 26); shitëblerësi nga do vij **qen'e mir pas**, edh'e kish në vend të shokut (N. K. 16); e mira vjen **mbas**.

3. Me t'u bashkuar parafjala **pas e mbas** me ndajfoljen si është formuar lidhëza **pas si** a pasi, **mbas si** a **mbasi**. Në arbërisht përdoret lidhëza **pas çë**.

4. Si parashtesë e gjejmë këte parafjalë në pak fjalë të gjuhës popullore: në emra, si **pasdrekë**, **pasdërkë**, **paslugë** (= një farë ëmbëlsire që hahet pas buke), **pas-mbesë**, **pasrregullë**; në ndajfolje, si **pasnesër**, **pastaj**, **mbasandaj**. Në gjuhë të shkrimit, përveç foljes **pasoj**, e gjejmë këte në pak emra, si **pasardhës**, **pasluftë**, **passhkrim** **pasthirmë**.

## 16. për

**A. Përdorimi.** Kjo parafjalë ka vetëm një trajtë, dhe me këte është përdorur në gjuhë të shkrimit prej gjithë shkrimtarëve, të vjetër e të rinj, në çdo kohë.

**B. Funkzioni e ndërtimi.** Kjo parafjalë tregon:

**I. Vendin, te ku gjëndet** a bëhet dishka, ose ku vepron a për ku drejtohet dishka a dikush. Ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar, p.sh. e laanë me vdekunë **për dyer** të shekullit; kanë vuuum shtrazë e të ruojtunë **për dhe** e **për det** (Budi, Pasq. 38, 102); atëherë gjuetarët e lidhin balenën **për fëllugë**; thojt e ti i vijn me u kapë **për landë** (Mjeda, III. 116, 123); baate **për shtat** një soj mlojet që ishte baa me kmëen dhiet (Babi, Cak. 181); e shkrepri llullën **për gur**; dhelpna u lidhi bishtat **për dardhë** (Kurti, I. 19, 29); lidhi një futë për mjedis (Anonimi 81); e gjeti shtrimë **për dhe**; u-nis **për udhë** (Stuhi, 114); ky mall vete **për Çekosllovakia**; kishte marrë udhën me vrap **për atë fshat**;

2. Me rrjedhore p.sh. derdhënë ujë **për truollit**; ecënjënë sikur ditë-në **për diellit** (Budi, Pasq. 55, 246); e përpoqi **për dheu** (M. M. 63); i poq filxhani **për dheu** (Ped. 178); dhe përpiqej ta mbante se mos thërmonte kokën **për muri**; mënt binte **për dheu** nga zalia (Kas. 93, 96); mos të rrafte shpina **për dheu**.

**Verejtje.** Si duket nga këto shembëlla, parafjala **për** herë herë është baras nga kuptimi me parafjalët **nëpër**, **në**, p.sh. e kanë lanë idhunë e tukeq **për dyer** të shekullit (Budi) = **nëpër dyer** të shekullit; vehet me shikjue **për birë** të çilsit (Kurti, I. 32) = **nëpër birë** të çilsit; baate **për shtat** një soj mlojet (Babi) = baate në shtat; e vesh fanellën **për mish** = në mish. Ky përdorim i parafjalës **për** me kuptim t'atyre parafjalëve është karakteristikë e të folurit të Veriut më tepër. Në sintagma të tjera po të këtij të foluri parafjala **për** ka vlerën e parafjalës nga, p.sh; ai që hin **për deret** n'oborr (Buz. Gjoni X. 1) = ai që hin nga dera n'oborr; gjithashtu: duel **për dere**, **për penxhere** = duel nga dera, nga penxherja. Në këte mënyrë të shprehuri kemi një influencë a paralelizëm me latinishten: intrare per ianuam, ose t'italishtes: entrare per la porta. Me gjithatë, në të folët e Veriut përdoret edhe parafjala **kah** në të tilla shprehje: duel **kah dera**, duel **kah penxherja**.

**II. Mënyrën** se si çfaqet një veprim ose një gjendje. Ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar, p.sh. ra në lëngim e u bë **për vdekëje** (M. P. 278); e goditi **për ngordhëje** (M. M. 63); 'u smun **për deek** (Babi 135); dhënëjenë mos e prishni duke përfolur si ata që bëjnë **për faqë**

(N. Mës. 44); si **duel për faqe** mjeshtëria e shtypëshkronjës; kjo punë ka **qenë për humbje e jo për fitim**.

2. Me shprehje ndajfoljore, p.sh. **kaa dalë e për ngee** (Budi, Pasq. 104); i ligu ziret **ngoje për likshtë** (N. Mës. 11); sëmundja mori **për më keq** (Vr. 69); Shkodra ka një të pamë **për bindë** (Mjed. III. 75); të lash-tat atë mot kishin marrë **për mbarë** (Nov. 75); e kishte shkruar **për bu-kuri**; fliste **për gas**; kishte ardhë **për ngut**; i zbatonte urdhërat e drejto-rit **pikë për pikë**.

**Verejtje.** Me këte funksion të kësaj parafjale lidhet edhe funksioni i betimit, ndërtuar me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. betohem **për atë qiell, për at'dhe, për syt'e ballit; për nder, për miqësi** që kemi, **për Zotin**; ose me tëjoren parafjalore p.sh. baj bee **për qiellt e për dhet e për detit** (Budi, Pasq. 29); bani be e tha: **për bukët** që s'të rrej.

III. **Kohën e zgjatur a të caktuar, d.m.th.** sa kohë mba një punë sa kohë lypset për të kryer një punë, ose në ç'kohë të caktuar bëhet kjo. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. ep bamirëvet të miratë **për mot të glatë** (Buz. IX b); me e pritun **për disa mot** (Budi, Pasq. 64); **për di sahat e mbushën kaiken** (Ped. 24); u mësue e vij **për mëngjes** (N. K. II. 11); lufta qe shuar **për disa vjet** (Çlir. 14); e bëri këte rrugë **për tri orë**; po e lamë **për një herë** tjetër këte çështje; do të vij **për vit të ri**.

IV. **Cilësinë, aftësinë e zotësin'** e një personi lidhur me një mbiemër a emër me kuptim cilësor. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. gji-thë bota e kishin **për të mirë**; bota do të më kenë për kusar (N. K. I. 30; II. 60); ai s'rrëfente vetëhenë **për fajtuer** (Kristof. Hist. 5); e kishm **për nder** të gjithë (Kristof. Hist. 37, 136); e atëherë zihet **për kusar** (M. M. 60);

**Verejtje.** Në këtë funksion të mënyrës e të cilësisë ka rasa ku pa-rafjala **për** mund zëvendësohet me parafjalët **me e si**, p.sh. e mbajnë **për nder** = e mbajnë me nder: të kemi edhe ne ty **për vëlla** (M. P. 277) = si vëlla; ose mund të mungojë parafjala **për**: emëri gënjeshtar është **për turp të madh** (Vr. 82) = është turp i madh. Veçse me parafjalën **për** çfaqet një nuancë mënyre e cilësie më e theksuar.

V. **Shkakun**, për të cilin ndodh një të vepruar a një ngjarje. Ndër-tohet:

1. Me kallëzore të paçquar, p.sh. edhe dot' u nxjerënë juve **për punë time** përpara mbëretërish (Kristof. Mate, X. 18); drenit i vehen në shpinë **për mish** të mirë qi ka e **për lëkurë** (Mjeda, III. 110); mos vajto-ni **për t'keqe teme** (Babi, Vak. 271); kjo e metë ka ndodhur **për mungesë** të një studimi të hollë.

2. Me kallëzore të çquar, p.sh. u kënaq **për dashurin'** e madhe (M. M. 64); e kritikuan edhe **për gabimin** më të vogël.

3. Me tëjore parafjalore p.sh. i fali vetëdijenë q'e gyykon dh'e gë-izon **për punët** të mirë; ata q'apënë **për dashurit** të Zotit e **për mirësit** të shpirtit (N. Mës. 10, 44); ushtarëtë turq e donin shumë Skënderbenë **për trimërit e për zemërmirësit** të ti (Sami, Shqip. 12); edhe kanë me unxjerrë **për punët** meje përpara mbretënish (Kristof. Matë, X. 18); ishin të psuamit mbyllun **për frikët** të Judhejvet (Anonimi, 84).

VI **Qëllimin**, për të cilin bëhet një punë a ndërmirret një veprim. Ndërtohet:

1. Me kallëzore të paçquar, p.sh. e madhe porsu ushtëria qi anshtë trajtueri **për luftë** (Buz. X. a); janë vum **për ronjë** të tyne (Bogd. Shk. I. I'gj. IV. 15); dëshërimi i zemëresë sime **për shpëtim** të ture (Argjir.

Rom. X. 1); ai urdhëroi atë ditë të jetë **për festë** (Kristof. Hist. 2); kish dalë **për gja**; i thotë që nesër të vinë se i kam **për darkë** (Ped. 36. 88); po unë nukë ta bën **për mëri** (Doz. 56); një ditë ay unis **për udhë** të gjatë (N., K. II. 19); rrëmbyen pushkën **për liri** (Çlir. 14); ushtarët dualrë **për stërvitje**; vojti **për gërshani**; studion **për bujqësi**.

2. Me kallëzore të çquar, p.sh. punojnë **për realizimin** e shpejtë të planit; sivjet është punuar mirë **për pyllëzimin** e bregdetit; ka filluar puna **për grumbullimin** e ullinjvet; **për kullimin** e ujrave nuk është punuar sa duhet.

3. Me tëjore parafjalore p.sh. ajy që punon **për fitimt** të kësaj jete; bëri natënë **për prëhjet** të njeriut (N. Mës. 14, 46); Shqipëtar' i vërtetë **për kombërit** e ri (Sami. Shqip. 36).

**Verejtje.** Si shihet te shembëllat e sipërme, parafjala **për**, kur tregon shkakun a qëllimin, është përdorur më rasë kallëzore të paçquar a me rrjedhore prej shkrimtarëve të vjetër e të Rilindjes, kurse në gjuhë të sotme të të shkruarit, sidomos në shtyp, ka hyrë përdorimi i saj me kallëzore të çquar, si duket prej influencës së gjuhëve të huaja. Gjithë këte fenomen pamë edhe te parafjalët në (f. 16 e 17) e **mbi** (f. 39), që edhe këto sipas gjedhes së huaj, po përdoren me kallëzore të çquar në vend të së paçquarës a të rrjedhores. Me gjithë përhapjen e madhe të këtij përdorimi, herë herë mund përdoret ndërtimi i hershëm me rasë kallëzore të paçquarë, që pajtohet mirëfilli me natyrën e gjuhës; p.sh. në vend të: janë marrë masa **për zgjerimin** e kolektivizimit, mund thuhet fare bukur: janë marrë masa **për zgjerim** të kolektivizimit, etj.

VII. **Kufizim** në lidhje me foljet, emra, mbiemra që tregojnë **tendencë, dëshirë, prirje**. Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. e mori malli **për shokëtë**; ki mëshirë **për të varfërinë** (N. K. I. 7; II. 12); u tij të dua **për burrë** (Ped. 25); të gjithë ishin të vrarë **për gjumë** (Kas. 139); ai dëshëronte **për argjand** e **për ar** e **për petëka** të bukura (Kristof. Hist. 101); gjithkujt i rreh zemra **për shpi** të parëvet, **për vend** ku ka le; dashnija **për katund**, dashnija **për atdhe** (Mjeda, III. 107, 108); nuk kishte prirje **për muzikë**.

VIII. **Dobinë, fitimin** a gjithsesi të mirën; **dëmin** a gjithsesi të keqen. Ndërtohet:

1. Me kallëzore të çquar a të paçquar, p.sh. er'e qëruarë është shumë e mirë **për shëndet** të njeriut (N. Gjith. 75); mbë cilindo është dhënë për të çfaqurit e shpirtit **për mbroth** (Argjir. Korint. II. 7) = i epetë gjithësecilit **për të mirënë** (Kristof. Ibid.); të gjithë votuan **për Frontin**; më tepër u kujdes **për atë** se për vehten e vet;

2. Me tëjore parafjalore p.sh. të përpiqemi **për të mirët** të kombit tënë; të mos punojmë **për humbjet tënë** (Sami, Shqip. 95); kur bën ligësinë, e bën **për kokët të ti** (N. Mës. 36).

IX. **Pjesën a anën e një të tëre**, ku bie veprimi. Ndërtohet me tëjore parafjalore, p.sh. e muor **për kript** të kresë ti (Buz. 60 a); ate qi ansh-të nlidhunë **për kambësh** (Buz. Ps. 145, 8, XX/2); ta zëç **për koke** (Doz. 81); e mori të bijën **për doret** (Mjed. II. 16); e rroku **për mezi** (Doni II. 98); e përfshiu plakun **për mjekre** (Tokat 50); i zë qetë **për briri** (Ujët, 19); e tuj e shkundë **për krahit** (Kurti, I. 16);

X. **Objektin mbi të cilin shtrihet një veprim** a një gjëndje. Ndërtohet me kallëzore të çquar a të paçquar, p.sh. vajza si u-ngre nga gjumi, vështron **për burrë** (Ped. 26); pyeti **për plakun** se ç'njeri është ay;

passi nxù për ata se janë mirë (M. M. 59, 66); i ra në mend për shoqe të vet (Mjed. II. 4); e pyesën edhe për emërin e tij (M. P. 275); as që pyes për ty (Doni, II. 99); s'kishte gjetë se shka me hangër, e i ra në mend për qyp të mjaltsës (Kurti I. 31); deshte të marrë vesht për shënden' e tij; tue dëgjuem për t'amën nuk çan kryet aspak; u-interesua fort për zgjidhjen e asaj çështje.

XI. **Argumentin**, d.m.th. njerinë, gjënë a gjësendin, për të cilin flitet, shkruhet, çfaqet mendim a qëndrim, lidhur me foljet **flas**, **shkruaj**, **bisedoj**, **kuvendoj**, **mendohem**. Ndërtohet me kallëzore të çquar a të paçquar, p.sh. le të flasim pak fjalë për këtë libër të mrekullueshëm (Krisstof. Hist. 34); mejtoi për të bijën (Doni II. 64); kuvënduan për punët e fshatit (Atan. 9); duke menduar gjithmonë për të shoqen; le të flasim për këte punë (Stuhi, 20, 66); është shkruar mjaft për këte temë; biseduan gjatë për punët e blegtorisë.

XII. **Mjetin**, me anë të cilit bëhet dishka. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. ashtu na për ty për të lutunatë të saj na të jemi ëndimuum (Buz. XV. B); tue folë për gojë të Davidit (Bogd. Shk. I. Ligj. III. 15); po t'i dërgoj plaçkat për shërbëtorin

b) Me tëjore parafjalore, p.sh. pasi pat thashunë për gojet të shenj-tet (Buz. IX. a); po të tëhek mbas vetëhej posikuur kanë për litari (Budi).

XIII. **Kufizimin** e kuptimit të fjalës që përcaktohet. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar, p.sh. shqarshi për shtat është sa një micë (Mjeda, II 71); Evropasit dajnë për fytyrë të bardhë qi kanë e për hie-dhim të shtatit; për det e për tokë Ilirt ishin ushtarë të përmendun (Mjeda, III. 63, 173); i vlerë për mëmëdhe e për shtëpi (N., K. I. 47); moti sot është i mirë për bimët.

b) Me rrjedhore, p.sh. e njofta për zani.

**Verejtje**. 1. Parafjala për, me këte ndërtim për kufizimin, përdoret më tepër në të folët e Veriut dhe rrallë në të së mesmes, kurse në të folët e Jugut e të së mesmes përdoret parafjala nga (F. 54. XIV). Por edhe parafjala kah përdoret në Veri për kufizimin, si e pamë atje.

2. Në këte kuptim të kufizimit hyn edhe kuptimi «sa për», «për sa i përket», që tregon kjo parafjalë, p.sh. puna ma e ndershme për burrë është gjoja e luta (Mjeda. III. 169); ajo ish pak e ngjallme për moshën e saj (Lufta 12); për shok është shumë i përgjindshëm; për mik s'e ka shoqin; për rregullë në shtëpi është e vetmja; ose duke e përsëritur regjimin a atributin: për i bukur është i bukur; për i shpejtë është i shpejtë.

XIV. **Përsëritjen** e një pune në bazë të një kohe, kohën e vazhdi-mit të saj ose mënyrën e kryerjes; e kjo ndodh kur vihet parafjala në mes po t'asaj fjale, ose përpara një përemri të pakufishëm, me kuptim vendi, kohe a mënyre. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. si pa zo-gun që vinte mëngjes për mëngjes (Doz. 41); e njeh vendin pëllëmbë për pëllëmbë; vit për vit; për gjithë mbramje; për çdo muaj; gratë pu-nojnë krah për krah me burrat; ka me zotënuem për jetët të jetës shtëpin' e Jakobit (Bogd. Pj. II. Shk. I. Ligj. III. 6).

**Verejtje**. 1. Përveç funksionevet të lartpërmendura, me parafjalën për kemi edhe funksione të tjera: 1) të ndarjes a të pjesëtimit, p.sh. na ndau nga dhjetë lekë për krye; 2) të zëvendësimit, p.sh. u apëmë plaçkë të prishurë për të mirë (Vr. 83); i lypa një barrë grunë për dam qi më kishte bā (Kurti I. 16); pagova dy për një; ky njeri është sa për tre;

3) të çmimit a të shpërblimit p.sh. e bleva për njëzet lekë; e shita për pak gjë; punonte për njëqint lekë ditën; 4) të nevojës a mungesës, p.sh. s'ke nevojë për të mirat e mia (Kristof. Ps. XVI. 2); hiqnin keq për bukë.

2. Parafjala për përdoret me kuptime të ndryshme në shprehje ndajfoljore të formuara me përsëritjen e një fjale, p.sh. ballë për ballë, mes për mes (vend); buzë për buzë, dorë për dorë, fije për fije, plot për plot (mënyrë); ditë për ditë, sot për sot, vit për vit (kohë); krye për krye, pesë për pesë (ndarje).

3. Me parafjalën për janë formuar disa shprehje foljore, si ato me parafjalën në (F. 9), p.sh. nuk e zë për fill, nuk e zâ për gjâ: nuk zihenë për fill ndë kishë (Argjir. Korint. A. VI. 4) = nuk zihenë për gjâ ndë kishë (Kristof. ibid); e ve për fije, vihem për fije; i dal për zot: dili për zot të varfërit (N., K. II. 6); jam për ngut.

4. Në disa rase funksionesh parafjala për formon pleonazëm, e prandaj mund të mungojë, p.sh. e kam për detyrë = e kam detyrë; e zgjodhën për kryetar = e zgjodhën kryetar; për afër = afër, për ndryshe = ndryshe; për në qoftë = në qoftë, për në daç = në daç; ose mund zëvendësohet me parafjalën si a me, si e pamë më lart (f. 44, IV).

5. Parafjala për, kur i prin parafjalës në me funksion drejtimi, i jep shprehjes në ton emfatik, p.sh. u-nisën për në kasaba (Ped. 24); kishte marrë udhën me të shpejtë për në fshat.

6. Parafjala për duke u-bashkuar me paskajoren e ndonjë folje në gegërishtet ose me emrin foljor në toskërishtet formon me to fjali qëllimore a fthillzuese të pashtjellme p.sh. kish këmishët për të larë; i lypën ndjesë për të vajturë në dhe të tyre (M. P. 272., 280); mbëretën' erthnë prej së largu për me pam'ate (Kristof. Hist. 93); presa vihetë për të ndarë fjalëtë (Sami, Abet. 56); kur erdhi koha për të ikurë (Doz. 74); kish nevojë të madhe për të marrë udhën shpejt për fshat.

7. Nga gjithë parafjalët e tjera, parafjala për, si parashtesë, është bërë shumë produktive në gjuhë, në populloren e në të shkrimit, duke u formuar me të një varg i madh emrash mbiemrash, foljesh e ndajfoljesh. Për të gjitha këto kr.hs. «Buletini për Shkencat Shoqërore» 1956, Nr. 4, f. 88-90.

## 16. ndërper, ndëper, nëper

A. Përdorimi. Nga këto trajta e parë është përdorur prej Buzukut dhe e dyta prej shkrimtarëve të vjetër, si prej Budit, Bogdanit e Argjirokastritit, si edhe nga Rilindasit: prej Kristoforidhit, Mitkos e Vretos. Naimi e Samiu kanë përdorur trajtën nëper, e cila që nga koha pas Rilindjes ka marrë një përdorim të përgjithshëm në gjuhë të sotme të shkrimit.

B. Funkcioni e ndërtimi. Kjo parafjalë tregon:

I. Lëvizjen a drejtimin për mes një vendi. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. u lut sa t'i shohë glish-tin ndëper një vërë (M. P. 300); vështronte ndëper të plasurat e derës (M. M. 66); shkova penë ndëper verën e gjilpëresë (Kristof. Fjal. 270); i ra shkurt udhës nëper një grurore që sapo ish korrë (Çlir. 28); nëper një birë kalojnë njena mbas tjetrës (Kurti I. 57).

b) Me tëjore parafjalore p.sh. zbriturë poshtë qerozi ndëper vërët

dëften se ish mbë rrezik (M. M. 62); fut glishtin e vogëlë **ndëpër derët** (M. M. 304); u hoth **ndëpër penxheret me gjithë** të shoqen (M. P. 280).

II. **Lëvizjen a drejtimin** më një hapësirë a sipërfaqe pak a shumë të madhe. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. ky zâ duol **ëndërpër gjithë atë dhe** (Buz. Mate IV. 27); gjithë qish hin ndër mendt' tona përcilletë **ndëpër shise të korpitë** (Bogd. Shk. I. Ligj. I. 23); nuk' e gjet jashtë **ndëpër lagjet** (Bogd. Pj. II Shk. I. Ligj. III. 4); Davidi rrinte **ndëpër shkrepet e ndëpër shpellat** e Judesë (Kristof. Hist. 52); nisi të kërkojë **ndëpër gazetë** e katojet' e t'et (M. P. 290); këto kënetat janë plot peshq e munt të lëvrijnë **nëpër to** disa vapore (Sam. Shqip. 276); një ditë kishinë dalë **nëpër qytet** (N., K. I. 10); gjetne **nëpër bar dretha** sa ujë (Mjed. II. 36); breth **nëpër kodra** e **nëpër pyje** (Atan. 30); **nëpër pyllë** sillej nji muzat i larmë (Kurti. I. 56).

b) Me tëjore parafjalore, p.sh. e shpata të mos shkonjë **ëndërpër dheet** taj (Buz. LXXII = LXXXII, Levit, 26, 6); me predikuem shintinë ungjill **ndëpër shekullit** (Budi, Pasq. 185); për tri ditë ecnë **ndëpër shkretëtit** (Bogd. Shk. I. Ligj. I. 18); zogjtë fluturojnë **ndëpër erët** (Kristof. Abet. 18); i përhapur (ky komp) **nëpër gjithë Evropët** e Lindjesë; kjo bankë do të jetë gati **nëpër të tërë Shqipëri** (Sami, Shqip. 4, 85).

III. **Shkakun**, për të cilin bëhet a ndodhet gjëkafshë. Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar p.sh. ai **ndëpër të madhe madhëshiti** të tinaj bani me bam' nji statue mbë gjasë të tinaj; ata janë gjithë shurdhëtë **ndëpër ata zâ** të madh e të egrë qi ban (Bogd. Shk. I. Ligj. I. 12, 22); **Mërkuri ndëpër të afërit** të diellit rallë duketë (Bogd. Shk. I. Ligj. IV. 26).

IV. **Mjetin**, me anë të cilit bëhet a ndodhet dishka. Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. **ndëpër të këqitë** nalcohenë të mirëtë (Bogd. Shk. I. Ligj. VII. 12) **nëpër tyy** kam me bekue gjithë komet e cheut (T'Nnollunat Shejte, 7); **ndëpër lëndë** qi zbukuron ato vende dalin minare xhamijash e kulme shtëpijash të mëdha; **nëpër dritë** shohim senet (Mjed. III. 75, 156).

**Verejtje**. 1. Si duket nga shembëllat e këtyre dy paragrafeve të fundit, këto farë shprehjesh me parafjalën **nëpër** përdoren rëndom në të folët e në prodhimet gjuhësore të visevet të Veriut. Në prodhimet e visevet të tjera, shprehje me këte parafjalë nuk kanë gjetur përdorim, por ndërtohen në vend të kësaj parafjale me parafjalën **për** a me lokucionin **me anë të**.

2. Kjo parafjalë është përdorur rrallë si parashtesë, për të formuar folje: mëshërier, o Zot, se më **ndëpër-kambi nieri** (Bogd. Shk. II. Ligj. I. 16). Me këte parafjalë kemi edhe shprehjet foljore: e **marr nëpër kambë**, e **marr nëpër gojë**.

## 17. Me

A. **Përdorimi**. Kjo parafjalë është përdorur po me këte trajtë prej shkrimtarëve, si në kohë të lashta të gjuhës, ashtu edhe në kohë të pastajme e në të sotmen.

B. **Funksioni e përdorimi**. Kjo parafjalë kallëzon:

I. **Mënyrën** se si çfaqet një veprim konkret a një gjëndje e jashtme. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar: emrash të përgjithshëm, p.sh. i tha **me zë** të ngrirë (N., K. I. 18); lufta u ndes **me rrëmbime, me zë e me kërcëllimë** (N. Hist. Skënder. 115); e ngreh një gjã **me hov** (Mjed. III. 154); i përzu **me grahëm** të madhe (Kënk. e spr. 68).

b) mbiemrash participorë të gjinisë asnianëse të substantivuar; p.sh. hyri **me një të ecur** të shpejtë (Doni II. 64); e hapi derën **me një të shtyrë** (Tokat, 50); **me një të kërcver** doli nga hendeku (Ujët, 10); punon **me të ngutur**; me zi ja mori **me të lutur**; flinte **me të gërhitur**. c) mbiemrash asnjanes të kthyer në ndajfolje mënyre: i foli **me t'egër**; iku **me të shpejtë**; e priti **me të mirë**; i u përgjegj **me t'ashpër**.

2) Me tëjore parafjalore, p.sh. **me vrdhënit** të parë të Hyjit mbet shekulli krijues (Bogd. Shk. I. Ligj. IV. 5); bilbili ja thotë **me zët** të bukurë (N. Gjith. 53).

II. **Mënyrën** se si çfaqet një gjëndje e mbrendëshme ose një tendencë me fjalë afektive ose e një kuptimi të figurtë. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar, p.sh. besojti **me gjithë zembërë** (M. M. 61); helmonenë (motrat) **me fund** (Doz. 23); i foli **me dëshprim** (Çlir. 11); tha **me mëndje** të tij (Doz. 70); puna po ecën **me vull**; punon **me pritesë, e marr me idhëni** (një punë); rronte **me shpresë**; rrinte **me frikë e me marak**; sot u-gdhi **me krye**; zemra i rrihte **me gëzim**.

b) Tëjore parafjalore, p.sh. ecë, **me paqt** (Buz. Luka VII. 50); me gjellunë **me fëdigët e me djersët** shekullit (Budi, Pasq. 81); thoshte **me mëndjet' e tij** (Doz. 68); nuk do të bëjë gjë **me kokët të tij** (Sami Shqip. 70); (Zogu) **me mëndjzët** të ti thotë (N. Lulet e Ver. 10); e donte **me shpirtit**.

**Vërejtje.** Folja **vesh** gjëndet e ndërtuar tek auktorët me parafjalët **në e me**, p.sh. një nieri ënveshunë **me petëka** të bukura (Buz. Matë, XI, 8) edhe: ënveshunë **ëndë petëka** ën lëkurëshit (Buz. Matë VII. 15); i hy-pi pelës veshur **ndë robat** e arta (M. M. 67); veshur **me një kapotë** ushtari a **me një shapkë të vjetër** (Doni, IX, 131); veshur **në flori** (Ped. 84); është veshë **me të zeza** (Mjed. II. 129); Sipas frymës e natyrës së gjuhës kjo folje duhet ndërtuar me parafjalën **me**.

III. **Cilësinë** e një personi, të një kafshe a të një gjëje. Ndërtohet **me kallëzore të paçquar** a të çquar, p.sh. ahëre do të bënetë një kalë **me krahë** (Doz. 34); ishte i regjur **me punërat** e fshatarësisë (Atan. 21); dokument **me vlerë të madhe** historike; nxënës **me vullnet**; mik **me kokë**; shtëpi **me katër kate**; rrugë e gjerë **me lulishte** për anësh; shtëpi **me diell**; qytet **me rrugë të gjera**; trim **me fletë**; mullar **me kashtë**; fletore **me vija**; pyll **me lisa të gjatë**; punëtor **me durim** në punë.

IV. **Karakteristikën** a shenjën dalluese të një personi, të një gjëje a të një vendi. Ndërtohet **me kallëzore të paçquar** a të çquar, p.sh. një zotëri **me fytyrë të zbetë, me mollëzat e faqevet të hedhura, me ballë të gjerë e me sy të thellë** (Atan. 6); plakë e thatë **me kokalla të thata e të forta** (Çlir. 26); vende të ftohëtë **me dëbor' e me akullë** (Sami, Abet. 51); një fytyrë e gjerë **me vetulla e me mustaqe të kuqërreme** (Doni, II. 79); një zonjë **me fytyrë të hequr e të tretur** (Lufta, 12); lundër e gjatë **me katër lopata të shkruara**; kravatë e kuqe **me pika të zeza**.

V. **Marrëdhënie, sjellje, qëndrim.** Ndërtohet **me kallëzore të paçquar** a të çquar, p.sh. shkonjën shumë mirë me atë grua (Ped. 15, 81); zotëro-te punën e ke **me pleqtë** (Atan. 39); Dangllia shkon **me Përmet**; shtasa që ka një fije gjasë **me njeri** është majmuni; kajherë matet edhe **me luã**:

dhenat e tjera qi kishin punë **me det** banë ankime (Mjed. III. 90, 108, 112; 73); kjo nuk shkon **me atë të veshur**; nuk përzihet fort **me shokët**; ishte mësuar **me atë mjeshtëri**; e ka **me sy të mirë**; është i drejtë **me të gjithë**.

VI. **Shoqërim, bashkim, lidhje, përcjellje.** Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. të kini paqë **me gjithë njerëz** (Argjir. Rom. XII. 18); do të bashkonetë **me grua të ti** (Argjir. Efes. V. 31); i nisi mbreti **me njerëz**, **me para shumë**; vunë kurorë **me vajzën e mbretit** (Ped. 26); qe vluarë **me një çupë** mbreti (Doz. 36); qafa bashkon kryet **me trup**; babë e nanë, **me fëmij** bajnë familjen (Mjed. III. 94, 107); rri **me njerëz të mësuar** (Atan. 12); jam i një mendje **me ty**; kuvënduanë **shoq me shoq** (Anonimi, 69); populli është i lidhur ngushtë **me Partinë**; po luante **me shokët**.

2. Tëjore parafjalore, p.sh. shko **me djallit** (Budi, Pasq. 77); të sijtë (engjijtë) **bashkë me shekullit** kjenë krijuem (Bogd. Shk. I. Ligj. IV. 6).

VII. **Kundrëshinë** me ndonjë a me gjëkafshë. Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. u mërij **me mua** (De Rada, Raps. Naz. II. 65); Enea tue lëftuem **me Toskanët** (Shk. I. Ligj. I. 13); unë kam **me u shtimë juve ndë zmir me ata** që nuk janë komp (Kristof. Rom. X. 19); dervishi zuri të hahej **me arinë**; ky kish ndezur **me një ari** që i hante dhentë (Doz. 26); trupat' e qieshmë vinë rreth në hapësirët pa përpjekurë **njëri me jatrinë** (N. Mës. 7); jeta e tij ishte një luftë **me thatësirën** (Kas. 36); zihemi **me gratë** (Atan. 11); kishin shumë kokëçarje **me blerësit** (Ballz. 25); luftoj **me pengesat, me vështirësitë**.

VIII. **Shkakun** për të cilin bëhet një punë a ndodhet gjëkafshë. Ndërtohet me kallëzore të paçquar e të çquar, p.sh. **me qish arësye** e **me qish dëshijr** ashtë baam mkati (Budi, Pasq. 14); **me këto pengesa** nuk shkon puna mbarë; porsa erdhi, zû dhe e bani **me vajë** të vogëlin.

IX. **Kohën**, kur bëhet a ndodhet gjëkafshë, shumë herë edhe kur bashkohet kryefjala me fjalë që kanë një kuptim kohe. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. **me atë fjalë** i shtrëmbuan një dorë; **me vdekël time** ti do të mbretëroç (Ped. 84, 158); uçe heret **me natje** (Kristof. Hist. 17); flet mirë, po e ka **me hënë** (Atan. 40); era kish nisur të fryjë që **me natë**; u-nis **me mëngjes**; herë-herë mbledhjet fillojnë një orë **me vonesë**; ndenjti atje **me muaj**; e priti **me ditë** që të vinte; erdhi **me kohë**; **me përhapjen e filokserës** më 1936 u-prishën krejt vreshtat; **me hyrjen** në fuqi të kësaj ligje, bie nga fuqia ligja e mëparëshme; **me çlirimin** e Shqipërisë nga fashizmi, filloi përparimi e lulëzimi i vendit.

2. Me rrjedhore, p.sh. i duket se jeta mbarohet **me vdekjet të ti** (N. Mës. 15); këte porosi e lâ ai **me gjalljet të vet**.

X. **Kufizimin** e kuptimit të fjalës së përcaktuar. Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar. Psh. Jakobi çalonte **me një kambë** (Kristof. Hist. 26); Angjelini **me shtat** ishte i naltë sa ajo lule (Mjed. III. 45); **me trup** thuajse ja kalonte të shoqit (Çlir. 24); i vogël **me shtat** (Kurti I. 54); **me sy** i ngjan t'et; **me këte numër** revista hyn në vit të dytë të saj; i vogël **me trup** por i madh **me mend**; nuk jam mirë **me shëndet**.

**Verejtje.** Në gjuhë të sotme të shkrimit me parafjalën **me** tregohet edhe një kuptim i afërt me të kufizimit, kuptimi «sa për», «për sa i përket», ashtu sikundër e pamë këte fenomen te parafjalët në (f. 12, IV), **nga**

(f. 31, XIV) dhe **për** (f. 47, XIII); p.sh. ai rreth është prapa **me mbjelljet** e pambukut (= sa për mbjelljet e pambukut); disa kooperativa janë keq **me strehimin** e blektorisë (= për sa i përket strehimit të blegtorisë); ç'do të bëhet **me këte** çështje? po ahëre pse jemi pas **me shirjet** (Bereq. 15); s'u-kujtua të dilte e të shihte se ç'po bëhej **me dhentë**; e pyeti se si shkante **me shëndet**; si veni sot **me punë**?

XI. **Mjetin a veglën**, me të cilën mbarohet një punë. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. një njeri ënveshunë **me petëka** të bukura (Buz. Mat. X. 118); e mveshi **me rroba** të hieshime (M. M. 59); Tyrqitë **me egërsi** të tyre zunë më të bukurit' e vendeve të botës dhe i ropnë e i doqnë (Sami, Shqip. 57); **me duer** të veta punon shpata, **me duer** godit barka (Mjeda, III. 98); këpucët i lidhte **me gjalmë** këkure (Ballz. 22); vizatim i hequr **me kalem** të kuq; të lashtat korren **me drapër** a **me maqinë** posaçe; bëri një udhëtim të gjatë **me kalë**.

b) Me tëjore parafjalore, p.sh. **me kapistrët** e **me frët** shtrëngo fëlqinjëtë e tynë (Buzuku, Ps. 31, 9, XV/2 a); ja fshin (kambët) me kript të saj (Buz. 101/1 b); njerëzit e atjeshmë ngrohenë **me afshit** të vajt të peshkut që djeginë (Sami, Abet. 51); më ra **me shkopt** e më çau kokënë (N. K. II. 15); njeriu duhet të përpiqetë në këtë jetë **me djersët të vet** (N. Mës. 14); luleja **me bukurit** e m'erët dhe bilbili **me zët** të bukurë e dëfren njerinë (N. Gjith. 53); mos t'e marrëmë **me dorët tënë**; t'i fshijmë (duartë e hundëtë) **me mafest** dhe kurrë **me rizët** të trapëzësë (Vr. 79, 174); i pshinte kambët **me futët** (Anonimi, 81).

XII. **Mbrendin'** e një ene, të një përdorje a të një gjëje. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. thes **me miell**; shportë **me fiq**; rrëshik **me voj**; një poç **me verë**; gotë **me ujë**; kosh **me rrush**; kuti **me çokollata**.

XIII. **Lëndën** me të cilën është ndërtuar a punuar gjëkafshë. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. pëlhurë e qëndisurë **me ar** e **me mëndafsh** (Samiu); dallëndyshatë ndërtojnë çerdhetë **me baltë** e **me bar** (Kristof. Abet. 19); e ban shtrofullën **me krandë** e **me dushk** (Mjeda, III. 98, 109); bukë çerjepi **me misër të bardhë** (Çlir. I. 25); mur lyer **me gëlqere**; tavan **me dhoga**; ëmbëlsirë **me mjalhtë**.

XIV. **Pajimin a pronën** e dikujt. Ndërtohet me kallëzore të paçquar, p.sh. ish ahëre zotëni **me ara** e **me ullishta**; nuse **me pajë** të madhe; nëpunës **me rrogë** të vogël; anëtar **me triskë** të Frontit.

XV. **Plotësimin a mbushullimin**, lidhur me fjalë, me kuptim të mirëfilltë a të figurte, që kanë kuptimin e të plotit, si **mbush, ngarkoj, plot**, etj. Ndërtohet me kallëzore të paçquar a të çquar, p.sh. ka një kaikë ngarkuarë **me krip** (Ped. 28); të cilët (kuajt) ishin ngarkuarë **me florinj** (M. M. 60); do të vinë shtatë vjet plot **me të mira** (Kristof. Hist. 30); mallet ishin pushtruarë **me re të zeza** (arbrisht); **me dree** më kish ndëntur zëmren (De Rada, Antol. 67), krhs, na u-mbush barku **me frikë**, ftonjtë kishin zënë **me barrë** atë vjeshtë (Nov. 73); qielli ish mbuluar **me shtëllunga resh**; një kalë ngarkuar **me dru**; e mbuluan **me të puthura** e s'dinin si ta përkëdhelnin më mirë.

Këtu hyn edhe mbiemri **i pasur**, që në gjuhë të të shkruarit po përdoret me parafjalën **në**, sipas gjuhëve të huaja. Sipas natyrës së shqipes duhet përdorur me parafjalën **me**, ose **nga**, ose **për**: Shqipëria është një vend i pasur **me minerale** ose **nga mineralet** ose **për minerale** dhe jo: **në minerale**.

**Verejtje 1.** Përveç funksioneve të sipërpërmendura, me parafjalën **me** janë zhvilluar në gjuhë edhe funksione të tjera: a) funksioni i më-

**nyrës e i konditës**, p.sh. e bëj **me fjalë, me kuvend, me kusht, zë me qera**; b) **i këmbimit**, p.sh. ndërruanë të vërtetën **me gënjeshtërë** (Kristof.); ndërroj misër **me gështenja**; c) **i qëllimit**, p.sh. dërgonej djalën **me qe** (Ped. 158); e dërgonte **me lopë**; ç) **i sasisë a i çmimit**; p.sh. në këte kurs kanë kaluar **me qindra punëtorë**; aty kishte **me dhjetra vajza e djelm** që prashitnin misrin; kamatë **me dhjetë** për qind; **me katër mijë lekë** bleu një radio.

2. Si e pamë te parafjala në që mungon (f. 14, IX); kështu edhe parafjala **me herë-herë** nuk bashkohet me regjimin e saj, p.sh. rrodhi **vrab** trimi (De Rada, Antol. 51) në vend të rrodhi me vrab; vrab ati im ndërgoi... (Kënk' e spr. e B. 28); çika **prush** kacin' e mushi (Raps. Mujës Nr. 20, 148); i dha një **prerë florinj** (Ped. 36); bukë **majë mielli**; gjithashtu edhe: një dhomë **plot lagështirë**; n'ato kodra do të ngrihet një park i bukur **plot gjelbërime**; bleu një **shportë fiq**; po binte shi **gjerbë qiejsh** = me gjerbë prej qiejsh.

3. Parafjala **me duke** u bashkuar me mënyrë të pacaktuara të foljes hyn për të formuar disa kategori fjalish:

1) Fjali kohore të pashtjelluara duke u bashkuar me gjinin' asnjane të mbiemrit participor, p.sh. **me të ndënjturë**, erdhi koh' e bukësë; **me të dëgjuarë këto**, të nesërmen na i thërret të tria (Doz. 20, 22); **me të ngarë** misht me dorë, edhe u-ngjall një grua; **me të zdirgjur** djali nga lisi, gjeti atje dy gurë xhevair (Ped. 59, 60); **me të folë** djali, zuri Bilbil gjyzari e këndon; **me të vaturë** mbë të shtatë udhët, daroviti plakën (Ped. 68, 279); **me të ardhurit** ajo, përsëndoshi të kunetërit; **me të zbriturit**, i dërgoi fjalë çupës (M. M. 272, 291), **me të hyrë në fshat**, pyeti një grua; **me të dalë nga stranica**, e ndjen vehten të mpirë (Tokat, 6, 15).

2. Duke formuar paskajoren e një foljeje, që mund të përdoret me vlerë predikative në fjali të ndryshme të varura si: a) kryefjalore a kundrmore: s'guxoshin **me hi** n'uj (Mjeda, I. 77); Lizës i erdhi marre e filloj **me kja** (Mjeda, II. 25); b) përcaktore; c) qëllimore: thnegla del **me kërkue** ushujmin e vet (Mjeda II. 2); u ndal **me kuvendue** bashkë me barinë (Mjeda, III. 111), ç) kushtore: duke u-bashkuar me pjesoren e një foljeje, p.sh. **me ndezë** një shkrepçë në diell, nuk ban dritë; me të hangrë qeni i tërbuem, â rrezik i madh (Mjeda, II. 3, 67); d) kohore; mënyrore, shkajkore, rrjedhore, lejore.

## 18. pa

A. **Përdorimi**. Kjo parafjalë me këte trajtë të vetme është përdorur kështu në gjuhë gjatë gjithë zhvillimit të saj prej shkrimtarëve të çdo kohe.

B. **Funkcioni e ndërtimi**. Kjo parafjalë tregon të paqenët a mungesën e një gjëje. Ndërtohet:

a) Me kallëzore të paçquar, p.sh. përpiqetë e punon, **pa përtim**; hapësira **pa anë**, gjithësija **pa funt**, qiejtë **pa kufi** (N. Mës. 15, 33); s'bënj dot **pa të** (N., K. I. 8); në udhë që vij gjeti një kullë **pa derë** (Ped. 38); u gëzua **pa anë** (M. M. 66); ditët e pazarit i gjenjë atëherë bujqit **pa asnjë reze** shprese, **pa asnjë shenjë** gëzimi (Atan. 10); kishte jetuar **pa tokë, pa bagëti** (Ujët, 17); të mos nisësh **pa mua**.

b) Me tëjore parafjalore p.sh. **pa urdhënit** të parit; **pa urdhënit** tij (Budi, Pasq. 205, 234).

c) Me pjesoren e një foljeje, p.sh. kaçi **pa hipurë** në kalë kurrë, s'mbahej dot (Ped. 52); ranë të flenë **pa ngrënë**, **pa pirë** (M. P. 274); ngrihetë burri ngadalë **pa ndjerë** ajo (M. M. 61); nuk i u-ndëjti **pa folë**.

**Verejtje.** 1. Parafjala **pa** e bashkuar me disa fjalë formon me to shprehje ndajfoljore me kuptim metaforik, p.sh. u trëmp **pa masë**; u gëzua **pa anë** (M. M. 61, 66); **papandehurë**, **papriturë**, **pakuftimas** (Kristof. Fjalor 236).

2. Parafjala **pa** është përdorur edhe si ndajfolje me kuptimin: **pastaj**, p.sh. i fali shpirtinë e zëmrënë, që s'qasinë të këqija, **pa** i fali vetëdijenë q'e gjykon dhe e gëzon (N. Mës. 9); me kuptimin: **prandaj** p.sh. atë kohë Ahmetn' e varfërë e mori malli për shokëtë për mëmënë e për atënë; **pa** më s'përdëllehej dot e derdhte lottë çurkë (N. K. I. 7).

3. Me këte parafjalë, si parashtesë, janë formuar, në gjuhë **popullore** e në të shkrimit, një varg mbiemrash p.sh. i paanë, i pabesë, i pandarë, i pakursyer, i pamirë; e thonë se është i pa të zanë fill e i pa të so-sunë (Bogd. Shk. I. Ligj. III. 21) Shih Bulet. për Shkencat Shoq. 1954, Nr. 4).

\* \* \*

Përveç parafjalëve të para që u-zhvilluan më sipër janë përdorur në gjuhët edhe parafjalë të tjera, të dala prej disa ndajfoljeve dhe prej disa emrave, që janë përdorur së pari si ndajfolje. Këto farë parafjalësh ndërtohen, si të parmet, me rasa, por më tepër me dhanore-rrjedhore.

## I. Parafjalë prej ndajfoljesh

### a) afër, lark a larg:

i kulloste dhentë në një fushë **afër fshatit**; banonte në një shtëpi **afër shkollës**; është **afër mënç**; rrinte i hidhëruar lark shokëvet; vapori qëndroi **larg portit**; qoftë lark nesh.

### b) brënda a mbrenda: jashtë a përjashtë a përjashta:

e mbaroi punën **brënda afatit** të caktuar; **mbrenda tri javëve** u- mbuall një e treta e grurit; duke ecur dualën **jashtë fshatit**; **përjashta qytetit** ishin mbledhur shumicë e madhe për ta pritur.

### c) drejt, kundër, kundrejt:

Shqipëria ecën me hapa të shpejta **drejt fitorevet** të reja; i kanë shlyer me kohë detyrimet **kundrejt shtetit**; ai u-shpreh **kundër atij vendimi**.

### c) mbanë, ndanë, pranë:

ishin ulur **mbanë kasollës** e po bisedonin; qe shtrirë aty **ndanë buri-mit**; duke udhëtuar **vanë** e pushuanë **pranë një pylli** të dëndur.

### d) ndërmjet, nëpërmjet:

dashuria **ndërmjet prindërvet** e **fëmijëvet** duhet të jetë e madhe; shumë probleme ndërkombëtare mund të zgjidhen **nëpërmjet bisedimeve miqësore**.

dh) **përmes, përqark:**

partizanët kaluan **përmes** fshatit duke ndjekur armikun; u ulën dhe ndejtën **përqark** tryezës.

g) **përpara, prapa:**

doli **përpara** gjithë shokëvet; nuk u-tremb **përpara** rrezikut; ecënte me duar **prapa** kurrizit; vate e ndenji **prapa** një shkëmbi.

gj) **përpjetë, poshtë, përposh:**

i u-ngjitën **përpjetë** shkallëvet dhe hynë brënda në shtëpi; **poshtë** shkambit dilte një burim me ujë të ftohtë; **përposh** malit shtrihej një fushë e gjerë.

i) **si, posi a porsi:**

fytyra e tij nisi t'i verdhet si **dyllë**; ishte veshur **si ushtar**; flokët e saj ndritnin **posi ar**; mica ngjitet mbas muresh **porsi hardhicë**.

j) **sipër, përsipër, sypr:**

aeroplani ishte ngritur shumë lart, fluturonte **sipër** revet; **përsipër** fushës ish përhapur një mjergullë e dendur; shqiponja kishte qëndrue **sypr** një mali të naltë.

k) **veç, përveç**

**veç** teje njeri tjetër nuk e mbaron këtë punë; **përveç** shtëpisë së kulturës u-ngrit n'ate fshat edhe një grup teatral.

**Verejtje.** Parafjalët prej ndajfoljevet **tej, përtej, atej a andej, këtej a këndej** ndërtohen me kallëzore ose me rrjedhore, p.sh. punë **tej masës a tej masën; përtej fushës a përtej fushën; atej a andej malit a malin; këtej a këndej lumin a lumit.**

## II. Parafjalë prej emrash a mbiemrash

a) **gjatë, ngjat, a njatë**

ishte plagosur tri herë **gjatë** luftës nacional çlirimtare; të mirëtë do të jenë ndë përheje **njatë Zotit** (Naimi); shkon e mshehet **ngjat shpis së** mbretit (Kurti).

b) **midis**

një rrugë e bukurë gjarpëronte **midis kodrinave** të gjelbëruara; kërkohet miqësia e vëllazërimi **midis gjithë popujve.**

c) **rreth, rrotull**

i çfaqën mendimet e tyre me radhë **rreth** asaj çështje; dheu vjen **rrotull diellit.**

**Verejtje.** Për parafjalë të tjera prej emrash, si **faqe, majë, anës, buzës, etj.** shih ç'është thënë në krye.

### III. Shprehje parafjalore

Shprehjet parafjalore janë grupe fjalësh, që kanë kuptimin e një njësie dhe bëjnë po ate funksion të parafjalëvet. Elementet formuese të tyre janë një parafjalë dhe një emër, të cilit i prin parafjala dhe i vjen pas një nye ose një parafjalë tjetër. Gjuha popullore ka pak shprehje parafjalore por gjuha e shkrimit, sipas gjedhes së gjuhëvet të huaja, ka formuar një varg këso shprehjesh, që në zhvillim e sipër të saj vijinë gjithnjë duke u-shtuar. Të tilla shprehje parafjalore kemi: në mes të; në mje-dis të; në vend të; në kambë të; në bazë të; në dreitim të; në mungesë të; në kundërshtim me; në lidhje me; në marrëveshtje me; në pajtim me; në përshtatje me; në përputhje me; me anë të; me ndihmën e; për punë të; për shkak të; nga shkak i; nga puna e; etj.

#### BIBLIOGRAFI E PËRDORUR

##### 1. Në gjuhë shqipe

- 1) BUZ. = Meshari i Buzukut 1555.
- 2) MATR. KAT. = Catechismo Albanese di Luka Matranga, 1592. Botim prej A. J. Rrotës 1939.
- 3) BUDI DOKTR. = Doctrina Christiana prej P. Budit, Roma 1618.
- 4) BUDI PASQ. = Pasëqyra e të Rrëfyemit prej P. Budit, Roma 1621.
- 5) BOGD. = Cuneus prophetarum prej P. Bogdanit, Edicion i Shkodrës (1940) në krahësim herë-herë edhe me origjinalin.
- 6) DE RADA ANTOL. = Antologia Albanese tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada. Napoli 1896.
- 7) DE RADA MILOSAO = Milosaat prej De Radës, edicion i Namik Resulit. Tiranë 1939.
- 8) DR. = De Rada Rapsodie. Firenze 1866.
- 9) ARGJIR. = Dhiata e re, greqishtë dhe shqiptarçe prej Grigor Argjirokastrit, Korfus 1827.
- 10) KRISTOF. = Dhiata e re, shqip prej K. Kristoforidhit. Kostandinopël, 1872.
- 11) KRISTOF. HIST. = Historia e shënjtësë Shkronjë prej K. Kristoforidhit, Konstandinopël, 1872.
- 12) KRISTOF SHQIP. = Abetare shqip prej K. Kristoforidhit. Kostandinopël, 1872.
- 13) KRISTOF. PS. = Psalteri shqip prej K. Kristoforidhit. Konstandinopël 1872.
- 14) BABI VAK. = Vakinat e ligjs ree prej P. Babit. Shkodër 1882.
- 15) SAMI SHQIP. = Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të jetë prej Sami Frashërit. Bukuresht 1889.
- 16) SAMI ABET. = Abetare e gjuhësë shqip prej Sami Frashërit. Bukuresht 1886.
- 17) N. MËS. = Mësimet prej Naim Frashërit. Bukuresht 1894.
- 18) K. K. I. II. = E këndimit çunavet, cop'e parë dhe e dytë prej Naim Frashërit. Bukuresht 1886.
- 19) N. FLET. E BEKT. = Fletore e Bektashinjet prej Naim Frashërit. Selanik 1910.
- 20) N. GJITH. = Gjithësija prej Naim Frashërit. Bukuresht 1895.
- 21) N. HIST. SKËND. = Histori e Skënderbeut prej Naim Frashërit botim prej K. Cipos. Tiranë 1953.
- 22) N. LULET = Iulet e Verës prej Naim Frashërit, botim prej Shaban Demirajt. Tiranë 1956.

23. VR. = Mirëvetija prej Jani Vretos. Bukuresht 1886.
24. M. M. = Përrallat e Mitkos në fund të gramatikës shqipe të G. Meyerit. Leipzig 1888.
25. M. P. = Bleta shqiptare e Mitkos prej Dr. Pekmezit. Vienë 1924.
26. T' NNOLL. = T'Nnollunat shënjtë. Shkodër 1901.
27. KËNK. E SPR. = Kënka e sprasme e Balës prej Gabriele Dara-s. Catan-zaro 1906.
28. FJALA = Fjala e t'in Zoti. Palermo 1913.
29. MJEDA = këndime për shkolla të para II. III. prej Mjedës.
30. VIS. E K. = Visaret e Kombit, vëll. II. Tiranë 1928.
31. KAN. = Kanuni i Lekë Dukagjinit prej Sh. Gjeçovit. Shkodër 1933.
32. KURTI. = Prralla kombtare, Ble I. prej Dhonat Kurtit. Shkodër 1943.
33. KAS. = Kasollja, përkthimi prej Fan N. Nolit. Tiranë 1944.
34. DON KISH. = Don Kishoti i Mançës, përkthimi prej Fan N. Nolit. Tiranë 1956.
35. TOKAT = Tokat e çara, përkthimi prej Sotir Cacit. Tiranë 1948.
36. DONI I, II. = Doni i qetë, I, II, përkthimi prej Sotir Cacit. Tiranë 1949.
37. UJËT = Ujët fle hasmi s'fle prej Fatmir Gjatës. Tiranë 1951.
38. ANON. = Anonimi i Elbasanit, transkriptim i Injac Zamputit, në Buletin t'Institutit të Shkencave Nr. 3-4. Tiranë 1951.
39. ÇLIR. = Çlirimtarët I, prej Dhimitër Shuteriqit. Tiranë 1951.
40. ATA = Ata nuk ishin vetëm prej Sterjo Spases. Tiranë 1951.
41. BEREQ. = Bereqeti prej Zihni Sakos. Tiranë 1951.
42. BUKA = Bukë e bardhë, përkthimi prej Dhimitër Pashkos. Tiranë 1955.
43. BALLZ. = Evgjëni Grande, përkthimi prej Nonda Bulksës. Tiranë 1957.
44. LUFTA = Lufta e Paqa, përkthimi prej Sotir Cacit. Tiranë 1957.
45. STUHI = Stuhi në Gang, përkthimi prej Vedat Kokonës. Tiranë 1957.
46. MIGJENJ = Migjeni, Vepra. Tiranë 1957.
47. UGËL. = Uğëtimet e Guliverit, prej Halit Selfos. Tiranë 1958.
48. NOV. = Novella prej J. Xoxës. Tiranë 1958.
49. BRUSKI = Bruski, përkthimi prej Gjergj e Petro Zhejit. Tiranë 1958.
50. Shkronjëto-re e gjuhës shqipe prej Sami Frashërit f. 131. Bukuresht 1886.
51. A. XANONI. Gramatika shqip f. 155-158. Shkodër 1909.
52. ILIA DILO SHEPERI, Gramatika dhe statistika e gjuhës shqipe f. 123-124. Vlorë 1927.
53. OSMAN MYDERRIZI. Gramatika e re e shqipes f. 275-277. Tiranë 1944.
54. K. CIPO, Gramatika shqipe f. 182-185. Tiranë 1949.

## 2. Në gjuhë të huaj

1. F. BOPP, Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen f. 499-505. Berlin 1854.
2. K. BRUGMANN, Grundris der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen. Zweiter Band, f. 758-930. Strassburg 1897.
3. B. DELBRUCK, Vergleichende Syntax der indogermanischen Sprachen, erster Teil S. 643-774, Strassburg 1893.
4. H. GRASSMANN, Ursprung der Präpositionen im Indogermanischen KZ. XXVIII S. 560.
5. RICHARD KURTH, Der Gebrauch der Präpositionen im Rumänischen. Jahresbericht des Inst. für rumönische Sprache, X.S. 465-639.
6. HANS MORER, Der Ursprung der rumänischen Präpositionen. Jahresbericht des Instit. für rumönische Sprache X.S. 409-464.
7. HERMANN PAUL, Prinzipien der Sprachgeschichte S. 366-368. Halle 1937.
8. GUSTAV MEYER, Kurzgefasste albanesische Grammatik S. 57. 67 Leipzig 1888.
9. WIHTNEY-HADZIDAKIS, Περί τῶν γενικῶν ἀρχῶν τῆς συγκριτικῆς γλωσσικῆς. σ. 420-422, Ἀθήναι 1898
10. VIGGO BRONDAL, Théorie des prépositions, Copenhagen 1950.
11. Γραμματική τῆς Ἀλβανικῆς γλώσσας ὑπό Κ. Χριστοφορίδου ἐν Κωνσταντινουπόλει 1882. σ. 161-164
12. HOLGER PEDERSEN, Albanesische Texte mit Glossar, Leipzig 1895.

13. DOZON, Manuel de la langue chkipe ou albanaise. Paris 1879.  
 15. Ἄθηνά, τόμος 45.  
 14. Α. Τζαριζάνου, Νεοελληνική Σύνταξις, σ. 72—95. Ἀθήναι 1928.  
 16. IORGU IORDAN, Limba romîna, p. 490-50. Bucuresti 1956.  
 17. Gramatica limbii romîne, Academia Republicii Popolare romîne. Vol. I, p. 343-375. Bucaresti 1954.

## R é s u m é

## LES PREPOSITIONS DE L'ALBANAIS

C'est pour la première fois que les prépositions de l'albanais font l'objet d'une étude monographique, leur seul domaine d'étude ayant été circonscrit jusqu'à présent dans les grammaires de l'albanais, dues à divers auteurs. Le regretté prof. Xhuvani analyse, dans cette monographie publiée à titre posthume, 18 prépositions de l'albanais. Dans son introduction, il ébauche un bref aperçu sur l'historique de la définition de la préposition dans la linguistique générale et la linguistique albanaise en particulier, sur l'origine de celle-ci et sur son évolution historique dans les langues indo-européennes, sur le sens lexical de la préposition.

Les prépositions analysées sont les suivantes:

- 1) en;
- 2) ëndë, ndë, në;
- 3) ënbë, ëm, mbë, më;
- 4) te, tek, nde, ndek, ne, nek, tu, tuk, ke;
- 5) ëndaj, ndaj, ndej, nnej;
- 6) ënbii, përbëmbii, mbi, mi, përbëmbi, përmi;
- 7) ënënë, ndënë, ndën, nënë, nën, nen, nan;
- 8) kaa, kâ, kah, kaha, nga, na, ngaha;
- 9) prej, pej, pi;
- 10) ëndër, ndër, ndër, nër;
- 11) ndjerie, ndjerë, deri, ngjera, ngjer, gjerë, njera, njer;
- 12) andyy, andyç;
- 13) mje, mjen, mjet, mjec;
- 14) pas, mbas, mas;
- 15) për;
- 16) ndërpër, ndëpër, nëpër;
- 17) me;
- 18) pa.

A la fin de la monographie sont traitées également les prépositions résultant d'adverbes tels afër, lark, mbrenda, jashtë, etc., ainsi que celles découlant de noms ou d'adjectifs tels gjatë, midis, rreth, rrotull, etc. Y sont traitées brièvement aussi les différentes locutions prépositives telles në mes të, në bazë të, në drejtim të, në lidhje me, për punë të, etc.

La monographie s'appuie sur des sources riches de littérature. L'auteur a utilisé à cette fin l'ancienne littérature albanaise, celle de la Renaissance nationale albanaise, la littérature arbresh, celle de la période de l'indépendance, la presse périodique contemporaine, des oeuvres originales et des traductions parues ces derniers temps.

Chaque préposition a ses nombreuses variantes phonétiques qu'on rencontre dans les parlars dialectaux ou chez les divers écrivains, naturellement à partir des plus anciens. Le traitement de chaque préposition commence par l'usage des variantes phonétiques de celle-ci chez les divers écrivains et les dialectes, pour passer ensuite à un examen détaillé de la fonction et de la construction. On peut suivre ainsi comment sont venues en s'accroissant les fonctions des prépositions en albanais et comment la langue s'est avantagée de diverses constructions prépositives.

Cependant, on a utilisé des fois, et cela en nette contradiction avec la nature de l'albanais, des constructions empruntées aux langues étrangères, au grave préjudice de celles de la langue maternelle. A cette question Xhuvani accorde un soin particulier, et cela pour presque toutes les prépositions.

Au cours de son développement, Xhuvani a fait souvent aussi des comparaisons avec les langues étrangères.

A la fin de chacune, Xhuvani a donné l'étymologie de la préposition et cela en indiquant les différents avis exprimés notamment par Franz Bopp, Holger Pedersen, Norbert Jokl et Marco la Piana.

X

